

Nën kritikën e medias ishte këtë muaj edhe ministri Arben Ahmetaj, i cili u akuzua se e ka shtyrë për vitin 2023 përfundimin e Rrugës së Arbërit. Sipas një liste projektsh prioritare që Ministria e Ekonomisë publikoi, Rruga e Arbrit llogaritej në rreth 205 milionë euro dhe përfundimi i saj parashikohej mes viteve 2016-2023.

Posta e Rrugës Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 1 (117). 1 - 31 Janar 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Adem BUNGURI
Veseli HOXHA
Geri SELENICA
Osman XHILI
Hajri SHEHU
Edmond HASANI
Moisi MURRA
Zaim ELEZI
Beqir Ajet SHEHU
Edison BALLA
Hajri MANDRI
Mevlud BUCI
Renato TOTRAKU
Beqir SINA
Ilmi DERVISHI

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit www.rrugaearberit.com.

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit [<rrugaearberit@gmail.com>](mailto:rrugaearberit@gmail.com)

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:

Raiffeisen Bank
Rruga e Arbrit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferari”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndaloher riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Kryeministri: Po vonojmë firmën për Rrugën e Arbrit në interes të publikut

Kryeministri Edi Rama ka folur për herë të parë për negociatat për rrugën e Arbrit. Gjatë fjalës së tij në takimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar më 26 Janar, ai ka deklaruar se vonesat në firmosjen e marrëveshjes kanë të bëjnë me interesin publik. Duke iu përgjigjur sulmeve që qeveria ka marrë nga opozita dhe një pjesë e shoqërisë civile në lidhje me koncesionet që kjo qeveri ka dhënë gjatë mandatit të saj, kryeministri ka theksuar se “Ne do të vazhdojmë të bëjmë koncesionet publike-private dhe dua t’i siguroj të gjithë sipërmarrësit që ne, jo vetëm nuk tërhiqemi nga këto sulme barbare balte, por do të vazhdojmë vendosmërisht që të ftojme partnerë privatë për të ndërtuar shkollë, për të ndërtuar infrastrukturë sociale, për të ndërtuar rrugë, për të bërë shërbime të tjera”.

“Por kushti ynë, parimi ynë themelor është që të mos ngarkojmë qytetarin”, ka theksuar kryeministri. “Kjo është dhe arsyeja pse, për shembull, ne vazhdojmë edhe sot e gjithë ditën dhe nuk e çojmë deri në firmën përfundimtare, partneritetin publik-privat për rrugën e Arbrit. E duam me gjithë mend ta bëjmë, kemi kaluar në Parlament për negociim dhe në negociim vazhdojmë të insistojmë se nuk duam t’ia lëmë barrën brezit tjetër, por duam të kemi një formulë të arsyeshme. Do ta kishim shumë të thjeshtë ta bënim, sepse ndërkohë e kemi përgjysmuar nga ajo që trashëguam nga paraardhësi ynë, shumë i dashur”.

Në lidhje me negociatat për rrugën e Arbrit, media citoi ministrin e transportit Edmond Haxhinasto në fillim të janarit, i cili ka thënë se “jemi në procesin e vlerësimit përsëri, pasi kompania kineze ka sjellë ndryshime në projekt”. Këto ndryshime, sipas ministrit, reflektohen në vlera të ndryshme nga parashikimet e Autoritetit Rrugor Shqiptar.

“Është e nevojshme të verifikohen propozimet e tyre, të konfirmohen në mënyrë institucionale nga ARRSH dhe konsulentat përkatëse. Kur të fillojmë këtë projekt, ta fillojmë dhe ta mbarojmë me cilësi të lartë”, ka deklaruar Haxhinasto.

Haxhinasto e diskutoi këtë çështje edhe në takimin me ambasadorin Ambasadorin e Maqedonisë në Shqipëri Stojan Karajanov. Në takim u fol për një koordinim më të mirë mes dy vendeve, për projektet e infrastrukturës.

Kryeministri Edi Rama: Ne vazhdojmë edhe sot e gjithë ditën dhe nuk e çojmë deri në firmën përfundimtare, partneritetin publik-privat për rrugën e Arbrit. E duam me gjithë mend ta bëjmë, kemi kaluar në Parlament për negociim dhe në negociim vazhdojmë të insistojmë se nuk duam t’ia lëmë barrën brezit tjetër, por duam të kemi një formulë të arsyeshme.

Ata diskutuan për vendosjen e një standardi të përbashkët për “Rrugën e Arbrit” mes dy vendeve. Por se cilat janë këto standarde mediat nuk e theksojnë, ndërsa një njoftim i tillë nuk gjendet as në faqen e internetit të Ministrisë së Transportit.

Nën kritikën e medias ishte këtë muaj edhe ministri Arben Ahmetaj, i cili u akuzua se e ka shtyrë për vitin 2023 përfundimin e Rrugës së Arbërit. Sipas një liste projektsh prioritare që Ministria e Ekonomisë publikoi, Rruga e Arbrit llogaritej në rreth 205 milionë euro dhe përfundimi i saj parashikohej mes viteve 2016-2023.

Me ardhjen në pushtet të koalicionit PS-LSI në vitin 2013, për rrugën e Arbrit u parashikua zgjidhje dhënie me koncension. Por, megjithë lehtësitë që parlamenti parashikoi në pranverën e vitit të kaluar për negociimin me një kompani kineze, rezultatet nuk kanë qenë të kënaqshme. Disa ekspertë e kanë kritikuar ligjin për faktin se nuk e kanë parashikuar me detaje vazhdimin e punës. “Afati i përcaktuar është 60 ditë, i pamjaftueshëm për ekspertët për të studiuar çështje financiare të studimit, fizibilitetit etj.”, i tha ekonomisti Ervin Minarolli një medie online. Gjithashtu, media qendrore raportoi në fillim të Janarit 2016 se FMN i ka kërkuar qeverisë të vlerësojë riskun që vjen nga koncensionet. FMN ka llogaritur se 2% e prodhimit të brendshëm bruto është kosotoja që llogaritet për rrugën Milet-Morinë dhe rrugën e Arbrit.

Nga ana tjetër qeveria vazhdon ta ndjejë presionin e shoqërisë civile ndaj kësaj çështje. Ndërsa rruga aktuale për Dibër është në gjendjen më të keqe të mundshme në këto dhjetë vitet e fundit, presioni për rrugën e re po rritet. Tashmë, një peticion i nisur online në mars 2013 po vazhdon të përhapet edhe në mediat

e tjera sociale.

“Përveç 2 000 nënshkrimeve në formularë, nisma jonë tani ka edhe mbi 8 000 përkrahës online”, - thotë për gazetën nismëtarë i peticionit, Gëzim Alpion, pedagog në Universitetin e Birminghamit. Ai thekson se “gjatë këtyre tre viteve ne e kemi mbajtur premtimin se peticionin nuk do ta politizojmë, pavarësisht sjelljes së Kryeministrit aktual dhe të ‘besuarve’ të tij dibrane. Se ç’kemi përshtypjen se në prag të zgjedhjeve të 2017-ës, qeveria do të gjejë, ose të paktën do të shtirë se i gjeti, fondet për këtë vepër sa për tu hedhur përsëri hi syve dibranëve me qëllimin e vetëm që të sigurojnë një mandat të dytë. Kur të afrojnë zgjedhjet, ne nuk do të bëjmë dallim ndërmjet deputetëve dibrane të majtë apo të djathtë. Me përjashtim të Tryezës së Rrumbullakës, që Grupi Lobues organizoi në Tiranë në Maj 2014, deri tani kjo gjysmë duzinë parlamentarësh nuk është bërë kurrë bashkë për të ngritur zërin në Kuvend për rrugën e Arbrit. Po që se ndonjë zë i mekët është dëgjuar, kjo është bërë jo në interes të Dibrës dhe dibranëve, por për të dëshmuar besnikërinë ndaj eprorit të tyre partiak”, thekson Alpion.

Segmenti i pafilluar i rrugës së Arbrit ka një gjatësi prej 26.8 km, i parashikuar me një gjerësi 10.5 m, me dy korsitë të asfaltuara, me gjerësi nga 3.75 metra dhe me shpejtësi të projektuar 50-60 km/orë. Në këtë segment parashikohet ndërtimi i 15 urave të mesme dhe të mëdha, me gjatësi totale rreth 1 500 metra linearë, ndërtimi i dy tuneleve, me gjatësi respektive prej 2 600 dhe 560 metra linearë. Gjithashtu, parashikohet ndërtimi i rreth 106 copë tombinove si dhe ndërtimi i katër intersektimeve.

Bujar Karoshi

Peticioni për Rrugën e Arbërit

8000 firma online për Rrugën e Arbërit

Peticioni për Rrugën e Arbërit Community

Timeline About Photos Likes More

Faksimile e faqes në FB për peticionin për Rrugën e Arbrit

Nga Skavica në Katund të Ri: hidrocentralet që po mbajnë peng zhvillimin e rajonit

Nga: **BUJAR KAROSHI**

AKUZAT E PARTISË DEMOKRATIKE: KORUPSION ME SKAVICËN

Skavica është rikthyer këtë fillimi viti në qendër të vëmendjes, pas deklaratave të Partisë Demokratike, përcjellë në publik përmes zonjës Grida Dume. Ajo e akuzoi qeverinë për dhënie me koncesion të Skavicës, bashkimit të shoqërive “Suzer Group” dhe “Nurol Holding”. Qeveria, sipas saj, i kishte dhënë 8 pikë bonus firmës turke dhe kishte fshehur publikimin në fletoren zyrtare të vendimit.

Lajmi që ajo iu referua kishte të bënte me njoftimin në faqen e internetit të shoqërive turke, e cila njoftonte për projektin e Hidrocentralit në Katund të Ri. (<http://suzer.com/web/49-209-1-1/en/sectors/energy-project/katundi-project-albania>)

PUBLIKIMI I SHOQËRISË TURKE

Në kuadrin e investimeve të huaja të huaja të Süzer Group, një marrëveshje e përbashkët është lidhur me Nurol Group që në vitin 2014, për krijimin e një ndërmarrje për ndërtimin e një hidrocentrali në lumin Drin në Peshkopi, në rajonin e Dibrës në Shqipëri që do të prodhojë 300 MW fuqi”, shkruhet në faqen e internetit në shoqërisë turke. Sipas tyre, hidrocentrali prej 70 MW do të ndërtohet në Katund të Ri, me një vlerë investimi prej afro 110 milionë euro. Shoqëria njoftonte se projektit kishte marrë një bonus nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë dhe se vendimi ishte botuar në Fletoren Zyrtare”.

Por ndërsa përfaqësuesja e Partisë Demokratike fliste për Skavicën, Qeveria shqiptare reagoi theksuar se nuk bëhej fjalë për Skavicën, por për një hidrocentral afër kufirit me Maqedoninë.

REAGIMI I QEVERISË SHQIPTARE

Përmes faqes transparenca.al, qeveria, bazuar në referimet e studimeve mbi Drinin e Zi, ka disa opsione, por më i përshtatshmi dhe me më pak kosto mjedisore e sociale rekomandon që mbi këtë lum të ndërtohen 2 hidrocentrale dhe konkretisht hidrocentrali i Skavicës (HEC Skavica) dhe ai i Katundit të Ri (HEC Katund i Ri).

Qeveria sqaron se “ka vlerësuar projektin e specifikuar, paraqitur nga bashkimi i “Suzer Group” dhe “Nurol Holding” për ndërtimin vetëm të “HEC Katund i Ri”, duke miratuar bonusin prej 8 pikësh. Kësisoj, referenca që Partia Demokratike bën për ndërtimin e HEC Skavica është i pavërtetë, pasi Këshilli i Ministrave i ka hapur dritën jeshile procedurave vetëm për ndërtimin e HEC Katund i Ri”.

Gjithashtu, qeveria quan sukses në këtë drejtim që ajo “ka përcaktuar të mos ketë më sanksionim të detyrimit paraprak të shtetit për të garantuar blerjen e energjisë. Kjo nënkupton se investimi për këtë vepër do të jetë plotësisht privat dhe investitori do duhet të marrë përsipër të gjejë tregun për energjinë e prodhuar”. Sipas saj, bashkimi i shoqërive të mësipërme ishin të vetmit që e parashikonin këtë element.

Përsa i përket mospublikimit në kohë në Fletoren zyrtare, qeveria thekson se “vendimi është marrë në 23 Dhjetor 2015, në mbledhjen e pasdites së Këshillit të Ministrave. Është kryer zbardhja e vendimit dhe është transmetuar tek Qendra e Publikimeve Zyrtare, e cila e ka botuar brenda afatit 10 ditor nga dita e dërgimit, edhe pse bëhet fjalë për një periudhë të vitit me disa ditë pushimi për shkak të festave”.

OFERTAT E SHOQËRIVE KINEZE

Geri Selenica, që përfaqëson disa shoqëri kineze të mëdhaja, të cilat dëshirojnë të investojnë në Shqipëri, doli kundër ndërtimit



Foto: www.panoramio.com

të këtij hidrocentrali, duke theksuar se “Katundi i Ri” bie ndesh me interesat strategjike të Shqipërisë në fushën e energjisë.

“Ndërtimi i hidrocentralit në Katundi të Ri e bën absolutisht të pamundur ndërtimin e HEC Skavica e Madhe, duke shkatërruar përfundimisht pasurinë më të madhe ujore kombëtare prej 7 miliardë m3 ujë”.

Në një shkrim të bërë publik në media, Selenica thekson interesat e kompanive kineze për të investuar në Hidrocentralin e Skavicës dhe rrjetin energjetik shqiptar në një shifër prej 3 miliardë Eurosh. Nga ky investim, 1 miliardë Euro do të shkojnë për Skavicën, ndërsa pjesa tjetër për kaskadën mbi Vjosë dhe rregullimin e sistemit të shpërndarjes.

Njëra nga ofertat është ajo e Power China, kompania më e madhe e hidroenergjisë në botë, me 53% të tregut botëror (<http://www.powerchina.cn>), që ka ndërtuar edhe HEC-et e mëdha të Drinit. Oferta e dorëzuar pranë qeverisë shqiptare më datë 30 tetor 2014, parashikon një financim 1 miliard euro dhe do ta ndërtonte Skavicën me një “Leasing Contract” 15 vjeçare. Pasi me çmim mesatar të energjisë 5 €/MWh dhe me prodhim 2 milionë MWh në vit, Skavica do të gjeneronte 100 milionë euro në vit. Pra do të vetëshlyhej nga 12 deri në 15 vite.

Oferta e dytë është ajo e kompanisë së dytë energjetike në Kinë, Ge Zhou Ba (<http://www.cgcc.com.cn>), e cila edhe ajo ka terma shumë të mirë, thekson Selenica.

Oferta e tretë gjatë vitit 2014 është sërish nga një kompani kineze, NORINCO (<http://www.norincogroup.com.cn/cn/index.aspx>), një grup i fuqishëm industrial kinez, i cili ka propozuar

Ndërsa banorët e qarkut të Dibrës prisnin që në janar të merrnin lajme të mira për “Rrugën e Arbrit”, janë të detyruar të marrin lajme vetëm për Skavicën. Herë me frikën e përmbytjeve e herë me pasigurinë e së ardhmes

të gjithë zhvillimin afatgjatë të kaskadës mbi lumin Drin”. Vasili përpiket që ti minimizojë problemet lokale që sjell ndërtimi i Skavicës, duke u përpjekur që në emër të strategjisë kombëtare t’i anashkalojë pasojat lokale. (Për detaje shih opinionin e botuar në faqen 6)

Të njëjtin qëndrim mbajti edhe kryetari i saj në emisionin “Zonë e Lirë” në TV Klan, i cili theksoi se ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës do të shpëtonte përfundimisht Shkodrën nga përmbytjet.

Në lidhje me këto dy deklarata ka një reagim të publicistit Abdurahim Ashiku, i cili në një seri shkrimesh thekson diskriminimin që u bëhet dibranëve, për gjoja interesa kombëtare ose më keq, për të shpëtuar Shkodrën nga përmbytjet. (*Reagimet e tij i gjeni të botuar në këtë numër në faqet 4,7,18*). Ashiku i qëndron mendimit se në Dibër nuk duhet ndërtuar asnjë hidrocentral mbi Drin, pasi qoftë me një, dy apo tre diga, të gjitha versionet përmbytin tokat dhe historinë e saj.

Një qëndrim më të moderuar mban edhe prof. asoc. dr. Vesel Hoxha nga Universiteti Politeknik i Tiranës. “Si njohës i zonës por, pa pretenduar shumë në njohjen e saj, mendoj se mbi lumin e Drinit të Zi duhen të ndërtohen tre hidrocentrale. Hidrocentrali i parë duhet ta ketë digën aty ku janë bërë studimet, në Skavicë, ku matjet topografike flasin për një kuotë absolute rreth shifrës 305 m mbi nivelin e detit. Diga e dytë mendoj se duhet të ngrihet ose ndërtohet në vendin midis Kodrës së Bitrit (me lartësi mbi nivelin e detit 428 m) dhe Kodrës ose Majës së Thekanushit, me kuote absolute 515 m mbi nivelin e detit). Ndërsa diga e tretë mund të ndërtohet mbi Katundin e Ri, aty ku lumi Drini i Zi fillon e ngushtohet”. (*Opinionin e tij e gjeni të ribotuar në faqet 8*)

Ndërsa qeveria shqiptare po mbron versionin me dy diga, njërën në Skavicë dhe tjetrën në Katundin e Ri. Ky studim ka mbështetjen e Bankës Botërore dhe asistencën teknike të kompanisë franceze Sogreah, i ka bërë një vëzhgim të hollësishëm të gjithë zonës që nis nga Skavica e deri në kufi me Maqedoninë. Ekspertë kanë përcaktuar disa pika dhe mbi to janë bërë studimet. Pikat e studimit janë grupuar në dy pjesë. Ata janë Kovashica, Dovalani, Katundi i Ri, Fushë Muhuri, dhe grupi i dytë Ura e Dodës dhe Skavica. Pasi janë marrë në konsideratë të gjithë këto pika ekspertët e kanë vlerësuar se si më të përshtatshmet janë Katundi i Ri dhe Skavica.

Në fshatrat ku parashikohen përmbytje është krijuar që në vitin 2002 një shoqatë, e cila merr përsipër mbrojtjen e interesave të banorëve, pronat e të cilëve përmbytin si me një digë, si me dy diga. Shoqata, e njohur me emrin “Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të pellgut të Drinit të Zi”, në një reagim që u bojkotua nga mediat qendrore, angazhohet të fillojë në protesta të vazhdueshme, deri në mosbindje civile, duke kërkuar anulimin e çdo procesi, pa u konsultuar më parë me banorët. (*Reagimin e tyre lexojeni në faqen 4*)

Ndërsa banorët e qarkut të Dibrës prisnin që në janar të merrnin lajme të mira për “Rrugën e Arbrit”, janë të detyruar të marrin lajme vetëm për Skavicën. Herë me frikën e përmbytjeve e herë me pasigurinë e së ardhmes. Prej më shumë se 20 vitesh investimet pothuajse nuk ekzistojnë, nga frikë e ndërtimit të hidrocentralit që ndërtohet në Kukës e përmbyt Dibrën. Ndaj, në qoftë se qeveria është e angazhuar në një proces transparent, duhet së pari ta fillojë nga terreni, duke biseduar me banorët, të cilët, edhe pasi pronat t’u jenë përmbytur, do të jenë të detyruar të jetojnë pranë liqenit. Ata janë të varfër, por atdhetarë nuk janë më pak se anëtarët e qeverisë apo drejtuesit e opozitës. Ata e duan vendin të zhvilluar, por zhvillim kurrë nuk ka për të pasur po u shkelën të drejtat e tyre.

Peticion i Shoqatës “Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të pellgut të Drinit të Zi” i thotë JO ndërtimit të Skavicës



“Ne jemi pronar të ligjshëm të kësaj toke”

ASKUSH NUK KA TË DREJTË AS TA SHESË, AS TA BLEJË PA VULLNETIN E POPULLIT TË KËSAJ KRAHINË”

Drejtuar: Z. Bujar Nishani, President i Republikës së Shqipërisë. Z. Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë. Z. Damian Gjiknuri, Ministër i Energjetikës i Republikës së Shqipërisë. Deputetëve të Dibrës: Z. Shkëlqim Cani. Z. Sherefedin Shehu, Z. Ulsi Manja, Z. Përparim Spahiu, Z. Roland Keta.

Zotërinj të nderuar!
Kryesia dhe Bordi drejtues i shoqatës “Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi, me mbi 5000 anëtarë, krijuar në vitin 2002 me vendim nr. 436 të gjykatës së Tiranës, të informuar nëpërmjet mediave të informimit publik, morëm vesh se ju i keni dhënë udhë ndërtimit të HEC të Skavicës mbi lumin Drini i Zi.
Ky informacion indinjoi së tepërmi tërë komunitetin e luginës së Drinit të Zi
Ne jemi këtu në trojet tona mijëra vjeçare, që na lanë të parët tanë të mbrojtura prej tyre me gjak e jetë njerëzore për të mos na i grabitur sllavët, turqit dhe pushtuesit të tjerë.
Ju kërkoni të na i merrni pronat tona, të na nxirrni në rrugë të madhe, pa u ulur as në bisedime me ne, si shqiptari me shqiptarin, si vëllai me vëllain. Siç po na rezulton, atë që nuk mundën ta bënin pushtuesit e këtij vendi me armë dhe ushtarë, e paskeni vendosur ta bëni ju zotërinj kaq tinëzisht.
Me veprimtarinë tuaj aspak transparente, kaq në fshehtësi, edhe pse e keni detyrë dhe detyrim ligjor bashkëbisedimin me ne, na keni injoruar dhe shpërfillur, aq sa nuk ka ku të vejë më shumë dhe na bëni të mos u besojmë, se prapa kësaj veprë qëndruaka një prapaskenë e kobshme, që ka në themel të saj korrupsionin, siç është bërë traditë në këtë vend në 25 vite të tranzicionit, ku falen pasuri të mëdha kombëtare në dëmin tonë dhe në favor të kompanive koncensionare të huaja, që nuk kanë arritur të sigurojnë treg atje ku nuk ecën korrupsioni, si dhe në favor të disa pushtetarëve tanë që bëhen bashkaksioner me ta duke shfrytëzuar pasurinë tonë.
Zotërinj të lartpërmendur
Mungesa e transparencës është pabesi ndaj nesh. Edhe në sistemin e diktaturës komuniste, kur shteti ishte pronar, kurse pronari i ligjshëm ishte proletar, më parë u ndërtua Kukësi i Ri, më pas u bë Fierza, kështu edhe për veprat tjera të kësaj natyre. Nuk jemi qiraxhinj, as refugjatë të përkohshëm në këtë vend që ju të na trajtoni si të tillë...
Mbështetur në mendimin e seksioneve, të nëndegëve të shoqatës sonë, sondazheve e bisedave me komunitetin nëpër fshatra, bordit drejtues, me vendimin nr. 45 datë 23.01.2016 njëzëri i themi JO ndërtimit të Skavicës, për

arsyet që sipas nesh janë madhore.
. Ndërtimi i kësaj veprë zhduk identitetin dhe pastërtinë etnike të një krahine të tyre që ka bërë histori.
. Ky projekt është katastrofik për ekonominë tonë, pasi asgjëson qindra biznese të ngritura me aq sakrificë e mundime, pa përmendur mundësitë potenciale për të ardhmen.
. Fshin nga faqja e dheut dhe fundos përgjithmonë vlera të mëdha etnike, kulturore, historike, dhjetëra qendra arkeologjike të virgjëra, që duhet të flasin jo të heshtin përgjithmonë.
Çdo pëllëmbë e kësaj toke, zotërinj, ka një STATUS mbrojtës të shkruar me gjakun e martirëve të këtij vendi, që nga luftërat e Penestëve me romakët e maqedonët, e deri në luftërat me sllavët grabitës të territoreve shqiptare
. Zhduken monumente historike, toponime që lidhen me fortesa, beteja, prona, rrugë të lashta, troje të Kastriotëve të famshëm që kanë bërë emër në shekuj dhe janë pasuri, jo vetëm lokale, por edhe kombëtare.
. Fundosen nën ujë mijëra varre të të parëve tanë.
. Shkel rëndë të drejtën tonë themelore të pronësisë.
. U tjetërsohet prona, jeta, pasuritë, kultura, historia, natyra e këndshme, mijëra banorëve të kësaj krahine pa qenë fajtor para askujt.
. Ne jemi pronar të ligjshëm të kësaj toke. Askush nuk ka të drejtë as ta shesë, as ta blejë pa vullnetin e popullit të kësaj krahine.
. Pa Luginën e Drinit të Zi, nuk mund të ketë Dibër. Ndërtimi i Skavicës, çan shtyllën kurrizore të Dibrës, dhe e ndan në dy pjesë si dikur më 1913, një masakër e re, në kohë moderne.
. Referojuni pak historisë të nderuar zotërinj dhe pikërisht Masakrës së Çidhnës të vitit 1466, kur nga shpata e sulltan Mehmetit të Dytë u shkuan në shpatë minimalisht 8000 gra, fëmijë e pleq të Dibrës të strehuar në fshatin Çidhën e Poshtme. Këtë e dëshmojnë edhe studiues turq të asaj kohe. Si është e mundur që pas 580 vjetësh, prej pasardhësve të tyre të na vijë një masakër tjetër, të na shkulë nga trojet tona si kohë më parë nga marrëveshjet e përbashkëta turko serbe ? Kjo është e pafalshme.
. Kryesia e shoqatës dhe Bordi drejtues i saj, në emër të komunitetit të zonës që përfaqësojmë i themi JO ndërtimit të Skavicës. Protesta jonë do të jetë e përshkallëzuar deri në mosbindje civile.
Për kryesinë e shoqatës
Nazi Drizi, kryetar; Nazmi Skepi, sekretar; Ali Hoxha, nënkryetar; Sadin Përnezha, nënkryetar; Shaban Beqja, kryetar nderi; Osman Begu, anëtar; Murat Koltraka, anëtar.

Skavica, qeveritë dhe populli*

LETËR E HAPUR 5000 ANËTARËVE TË SHOQATËS “PËR MBROJTJEN E PRONAVE DHE TË MJEDISIT TË PELLGÛT TË DRINIT TË ZI”

Usta Selimin, mjeshtër në ndërtim me rrënjë denbabaden, e thërret për t’i ndërtue një shtëpi të re Brahimi....
E ngre shtëpinë nga themelet në çati, e suvaton aq limuet sa veza ia kishte zili, i bën dyer e dritare zdrugu mbi dërrasë armeni zemër nga pishat e Lurës...
Erdh puna të bëheshin llogaritë. Brahimi hap krahët dhe e mat shtëpinë pash e më pash në të gjitha anët.
Brahimi qëlloi gjigand e një pashë e Brahimit ishte sa dy pashë të Selimit. Me pashën e Brahimit usta Selimi nuk i dilte me ble as bukë e kripë...
I nevrikosur usta Selimi tha:
- Ky kryet e Selimit kërkon pashën e Brahimit.

Lexova peticionin tuaj të nderuar anëtarë të shoqatës “Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të pellgut të Drinit të Zi” tek i thoshit JO ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës.
Kam qenë me ju kur me të njëjtat fjalë dhe argumente i drejtoheshit me një letër (05.12.2007) drejtuesve të pushtetit e të shtetit të asaj kohe (Topi, Topalli, Berisha, Ruli, “TGK-Skavica”, deputetëve të qarkut Dibër).
Kam qenë (në mëdyshje) me ju kur më 13.12.2007 u pritët për të marrë përgjigje për peticionin në zyrën e ministrit të ekonomisë dhe energjetikes Genc Ruli ku u dhanë me vete torba mbushur me gurë dhe të kërrusur u përçollën pa u ngritë nga karrigeje.
Kam qenë me ju (më pranë se kurrë) kur në mes të dimrit me parullat “Dibra përmytet”, “Ndal projektin italian”, “Përmbysten 6800 ha tokë”, “Jo hidrocentralit të Skavicës” protestuat me zë të plotë.
Nga ai tubim kam veçuar si një jehonë nga malet e Çidhnës së masakruar barbarisht nga turqit osmanlinj fjalët e një historiani...”Ndërtimi i HEC të Skavicës përmbyt një qytetërim të lashtë dhe të njohur në trevat shqiptare, sjell fshehjen nën ujë të historisë së një treve nga më të lashtat dhe më krenaret, një trevë që ka nxjerrë heroin kombëtar, Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, i cili, nga 26 bëtë fitoresh të mëdha me zë në historinë e Shqipërisë dhe të Evropës kundër dy sulltanëve osmanlinj, 19 i ka zhvilluar me dibranët dhe në tokën dibrane”.
Kam qenë me ju në çdo hap tuajin, nga larg, “syrgjin gjallë e syrgjin vdekur” tretur rrugëve të Athinës. Shqetësimin tuaj dhe të paraardhësve tanë dibranë që flenë në tokën dibrane të vrrarë, të prerë, të djegur e shkretuar nga armiqtë më të egër të kombit tonë, serbosllavët e turqve osmanlinj e kam përcjellë si një vikamë në shumë shkrime si dhe në librin “PO DIBRËS ! JO SKAVICËS !” - thirrje e marrë nga zemrat tuaja atë ditë janari të ftohtë.
Për peticionin e ri të ditëve të fundit drejtuar titullarëve të lartë të shtetit dhe deputetëve që janë ngjitë në karrige të larta me votën tuaj (relativisht) NUK JAM I NJË MENDJE.
Peticioni juaj ra në veshë të shurdhër. Media shqiptare, e shkruar dhe elektronike, me zë e figurë nuk çan kokën për Dibër. E kërkova peticionin tuaj dhe e gjeta në dy rreshta “lajmërim vdekjeje” në një gazetë të përditshme. E gjeta edhe në një

Le të mblidhen 1000 dibranë banorë të Dibrës, votues në zgjedhjet kuvendare të qershorit 2013.
Le të thërresin deputetët që u kanë dhënë votën dhe tu kërkojnë llogari në emër të sovranit.
T’i detyrojnë që të hapin zemrën dhe shpirtin, të bëhen krah për t’i thënë JO SKAVICËS.

gazetë online që del larg e larg, tej Atlantikut. Askund tjetër...
Po të kishte ndodhur ndonjë krim në Dibër të gjitha gazetatat dhe televizionet do ta jepnin lajm të parë... Mbytja e Dibrës, mbytja e një qytetërimi të lashtë për median shqiptare nuk përbën lajm.
Ju keni zërin dhe fuqinë e pesëmijë anëtarëve që u fshihet me fshehtë të hekurt gjithçka, u mbytet e kaluara dhe e ardhmja. Me ju janë edhe mijëra të tjerë që mbytjen fizike tuajën e vlerësojnë me të njëjtën dhimbje.
Peticionet janë karta të largëta, karta të shkruara nga skllëvrit e kapitalit në çerekun e parë të shekullit të 19-të. Lëvizja “Çhartiste” të vetmen gjë që fitoi ishte dyfishimi i prangave jo vetëm në duar e këmbë por edhe në gojë.
Asnjëherë “chartat” nuk kanë fituar gjë përveçse prangave dhe përbuzjes. E bënë një grup intelektualësh dibranë me emër e prestigj një peticion (charte) në përmasa botërore nëpërmjet internetit për “Ndërtimin shpejt dhe me cilësi të Rrugës së Arbërit”.
Cili ishte përfundimi? Kryeministri Rama nuk begenill në t’i takojë. Deputetëve të Dibrës; Cani, Shehu, Manja, Spahiu, Keta, të majtë e të djathtë, u ka ikur zëri edhe në publik, edhe në kuvend.
Një intelektual i njohur, mbrojtës i mjedisit shqiptar, Xhema Mato më shkruante....e.
...Mendoj se intelektualët e zonës së Dibrës duhet të kërkojnë vlerësimin mjedisor që është bërë për këtë projekt (është e drejta e tyre dhe detyrim ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës). Gjithashtu me ligj ata kanë të drejtë ta anulojnë, në se nuk janë dakord dhe argumentojnë ato që ju përmendni me të drejtë.
Kjo është rruga ligjore por si e dini dhe ju, ligjet shpërfillen në këtë drejtim në Shqipëri, kështu që ngel hapi i dytë gjyqi, i cili gjithashtu nuk fitohet kollaj dhe s’e merr përsipër ta bëjë një grup i pa bashkuar, shpesh i pamotivuar në ndërgjegje.
Së fundi është gjyqi publik të cilin ju jeni duke e bërë, por këtu të gjithë ata që janë dakord me ju duhet ta bëjnë dhe unë tashmë rreshtohem pas jush... Mendimi im është dalja në tribuna të gjera publike, dalja në rrugë, protesta masive të dibranëve të bashkuar.
Le të mblidhen 1000 dibranë banorë të Dibrës, votues në zgjedhjet kuvendare të qershorit 2013. Le të thërresin deputetët që u kanë dhënë votën dhe tu kërkojnë llogari në emër të sovranit. T’i detyrojnë që të hapin zemrën dhe shpirtin, të bëhen krah për t’i thënë JO SKAVICËS.
Le të mblidhen 1000 dibranë në Tiranë. Po kaq le të mblidhen edhe në Kamzë, në Durrës e kudo ku janë shpërndarë nga ikja biblike e viteve nëntëdhjetë, ikje dhjetëra herë më e madhe se sa ikja nga pushtuesit serbë në vitin e tmerrshëm 1913 kur Dibërën e prenë si berrin për kurrizi, shembulli unikal sot në botë kur vëllain me vëllain e ndanë për mort e për dasmë.
Shteti ka “PASHËN E BRAHIMIT”. Mos u trembni. “PASHA E SELIMIT”, kur bashkohen krahët është më e forta se kurrë.
Abdurahim Ashiku
Athinë, 29 janar 2016
Titulli është i redaksisë.

■ **Dy janë çështjet aktuale me rëndësi jetike për Dibrën: Rruga e Arbërit dhe HC i Skavicës! E para e shpëton Dibrën, e dyta e përmbyt atë dhe e asgjëson si tërësi gjeografike, historike dhe etno-kulturore mijëravjeçare!.**

Nga Prof. dr. **ADEM BUNGURI**

SKAVICA

Çështja e ndërtimit të HC të Skavicës u publikua në ditët e para të janarit 2016, duke iu referuar vizitës së kryeministrit të vendit në Istanbul në dhjetorin e kaluar. Sipas disa kanaleve televizive bëhet fjalë për një farë marrëveshjeje midis shefit të qeverisë tonë dhe një kompanie turke, që paska marrë përsipër ndërtimin e HC të Skavicës!. Për pasojat e rënda që do të ketë për Dibrën, ndërtimi i HC të Skavicës, ky problem nuk mund dhe nuk duhet të kalohet në heshtje.

Për hirë të së vërtetës, një projekt për ndërtimin e një HC mbi Skavicë, ka qenë hartuar edhe në kohën e komunizmit, përkatësisht në vitet 1983-1984. Sipas ekspertëve të hidro teknikës së asaj periudhe, qeveria Çarçani u tërhoq nga ndërtimi i këtij HC, përballë kostës së madhe të humbjes së tokave më të mira dhe më pjellore të këtij rajoni. Se Dibra është konsideruar gjithnjë si Myzeqeja e Shqipërisë Lindore! Kjo çështje qe rihapur në shkurt 2010 nga qeveria Berisha, dhe shihej në atë kohë si zgjidhje e problemit të përmbytjeve në zonën Shkodër-Lezhë, edhe pse më vonë u gjetën zgjidhje të tjera shumë më racionale. Banorët e Dibrës e kundërshtuan këtë projekt, kundërshti që e kanë shprehur prej kohësh në shtypin periodik disa nga përfaqësuesit e spikatur të publicistikës dibrane si z. A. Hoxha, z. B. Karoshi, z. A. Ashiku, z. Vesel Hoxha, z. M. Koltraka, z. Sh. Skara etj. Për fat të mirë, qeveria demokratike e asaj periudhe u tërhoq nga kjo ndërmarrje me pasoja të padëshirueshme për Dibrën.

Në kushtet e mungesës së plotë të transparençës qeveritare lidhur me këtë problem, dëshëroj t’u kujtoj një ndodhi të para rreth 2000 vjetëve në Romën e lashtë atyre që nuk e kanë lexuar Senekën. Filozofi Seneka (4 para Kr.-65 pas Kr.), në vitet e fundit të jetës së tij ishte këshilltar i diktatorit Neron (54-68 pas Kr.). Kur perandori Neron dogji Romën, i frikësuar në palcë nga vala e hakmarrjes popullore, e pyeti Senekën se ç’mund të bënte për të shpëtuar kokën nga urrejtja e turmës, dhe ky i fundit e këshilllonte perandorin e tij “që t’i gënjente romakët”, pasi “populli beson çdo lloj gënjeshtre që i serviret!”.

Më poshtë po parqesim reagimin tonë të fortë kundër këtij projekti, për arsyt e mëposhtme:

• **Për arsye gjeografike dhe ekologjike**
Skavica përfaqëson një prag të lartë shkëmbor që ngrihet midis fshatrave Qafë-Draj të Reçit të Dibrës në jug dhe Ujmisht të zonës së Lumës së Kukësit në veri, dhe që në kuptimin gjeografik, ndan pellgun e Peshkopisë nga ai Bicaj-Kukës.

Në gjeomorfologjinë e Shqipërisë dhe të Ballkanit perëndimor, lugina e Drinit të Zi, përfaqëson padyshim një nga koridoret më të rëndësishme lumore. Pellgu ujëmbledhës i Drinit të Zi me sipërfaqe 5885km2 përbën bazën e një eko-sistemi mijëvjeçarë. Në shënimet e tij mbi gjendjen në epokën e bronzit, Apolloni i Rodosit e përshkruan Drinin e Zi si” lumin e thellë e të zi, afër enkelejve”. Në rajonin e Dibrës shtrihet rrjedha e mesme e luginës së këtij lumi, me një gjatësi prej 75 km, duke filluar nga gryka e Jabllanicës ku ndahet me Strugën në jug deri në pragun e Skavicës në Qafë Draj në veri. Në këtë luginë lumore, si askund tjetër, alternohen pellgjet dhe pragjet lumorë, në një harmonizim të përsosur

Jo Skavicës!

gjeomorfologjik. Këtu vargmalet lindore e ato perëndimore herë largohen duke të shpalosur para syve fusha të bukur e pjellore, siç ndodh në pellgun e Dibrës dhe në atë të Peshkopisë, dhe herë afrohen dhe të detyrojnë të ngjitesh në qafat kufizuese apo pragjet malorë, siç ndodh në qafën e Qenokut dhe pragun e Dovalanit në jug, apo qafën e Draj-Reçit dhe pragun e Skavicës në veri.

Me luginën e tri gjatësore, ky lum ka krijuar që në lashtësi jo vetem një vend tërheqës për banim, por edhe një arterie të rëndësishme natyrore, që lidh Shqipërinë Lindore me Maqedoninë Perëndimore, Kosovën. si dhe viset fqinje dhe ato më të largëta. Ne rajonin ne shqyrtim, Drini i Zi formon dy pellgjet me te medha te tij, atë të Dibrës (15 x 9 km) me lartësi 400-450 m mbi nivelin e detit dhe atë të Peshkopisë (8 x 6km) me lartesi 300-350m, të ndarë nga pragu i Dovolanit dhe qafa e Qenokut. Falë aluvioneve dhe sedimenteve pjellore te shtreszuara në shekuj, keto pellgje jane mjaft të begatë, dhe përbëjnë zonat më të rëndesishme bujqesore dhe ekonomike të ketij rajoni. Lugina e mesme e Drinit të Zi, është jo vetëm lugina lumore më e bukur dhe më e begatë në Shqipëri, por ndër më të bukurat në botë. Populli i Dibrës nuk do të lejojë përmbytjen e kësaj pasurie të rrallë!

• **Për arsye ekonomike dhe demografike**
Territori i rrethit të Dibrës ka këtë strukturë tokash: fshat lumore me lartesi 300-600m zene 13.7% te siperfaqes, zona kodrinore paramalore me lartesi 600-1000m ze 30% e saj, malet me lartesi 1000-2000m zene 53.5% te territorit, ndersa pjesa tjeter (2.8%) zihet nga malet e larta mbi 2000m. Keto te dhena jane per pjesen e Dibres qe shtrihet ne Republikën e.Shqiperise. Pra tokat më të mira të këtij rajoni, të tipit aluvional, me strukturë pedologjike mjaft pjellore, gjenden anash shtratit të Drinit të Zi, dhe do të asgjësoheshin përgjithmonë nga realizimi i këtij projekti. Ndërtimi i HC të Skavicës do të sillte mjaft pasoja negative social-ekonomike dhe kulturore, por mbi të gjitha ai do të përmbyste përjetësisht një nga zonat më të rëndëishme të Shqipërisë Lindore, siç është zona e Dibrës. Së pari, asgjësimi përfundimtar i pjesës më pjellore të tokës së Dibrës, do t’i hiqte asaj bazën e nevojshme ekonomike që e ka mbajtur popullsinë dibrane aty prej më shumë se 8000 vjetësh. Fusha e Dibrës historikisht ka qenë hambar për Malet e Dibrës, dhe të dy këto njësi të saj kanë qenë përherë në mardhënje komplementësie ekonomike njera me tjetrën. Fusha e Dibrës e furnizonte Malësinë me drithra buke dhe merte prej saj prodhime drusore e blektorale etj. Në vitet më të vështira të krizës së bukës gjatë luftës I botërore, përkatësisht kohën e pushtimit serb(1913-1921) dhe atij austro-hungarez (1916), hambarët e Dibrës nuk u thanë nga drithi, përveçse u dogjën nga hasmi. T’i heqësh Dibrës këtë pjesë organike të saj, ta gjymtosh atë, është sikur t’i presësh gjymtyrët trupit të njeriut. Dhe unë besoj se qeveria do ta rishqyrtojë këtë çështje jetike për Dibrën. Dibra nuk mund të flijohet dhe të sakrifikohet për të shpëtuar të tjerët, edhe pse ajo i ka ndihmuar gjithnjë të tjerët, kur ata kanë pasur nevojë. Në këtë kontekst mjafton të kujtojmë se vetëm dibranët qëndruan përkrah shkodranëve, kur Shkodra ishte rrethuar nga pushtuesit malazez në vitin 1912-1913 !

Së dyti, duhet të kujtojmë se fusha e Dibrës nuk është tokë e krijuar nga tharjet e kënetave apo moçaleve, as me punë angari të të burgosurve politikë. Ajo nuk përfshihet në këto kategori. Ajo është trashëguar brez pas brezi, dhe është blerë e shitur me flori. Kjo është arsyeja që në Dibër nuk u zbatua dhe as që mund të zbatohej ligji bolshevik nr. 7501 i vitit 1991.

Së treti, përmbytja e Dibrës do të provokonte një lëvizje të madhe demografike dhe do të sillte probleme të mëdha sociale për këtë brez dhe për brezat e ardhshëm.

• **Për arsye arkeologjike**

Si arkeolog më duhet të mos heshtë. Si arkeolog kam shkelur në çdo fshat të Dibrës. Si arkeolog i them me bindje JO SKAVICËS! E them këtë pasi nëntoka e Dibrës ruan në gjirin e saj vlera të jashtëzakonshme arkeologjike, të cilat sapo kanë filluar të zbulohen e të studiohen. Në bazë të studimeve të derisotme, rezulton se ky është një ndër rajonet më të përshatshëm gjeografiko-topografik, me kushte jetësore optimale për jetesë, gjë që ka përcaktuar edhe hershmërinë e banimit të tij nga njerëzit që në prehistorinë e largët. Lugina e mesme e Drinit të Zi, territorialisht e lidhur me këtë rajon, përfaqëson zonën ku janë evidentuar gjurmët më të hershme të qytetërimit neolitik në Shqipëri, kronologjikisht të lidhur me gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të VII para Kr. Fshatrat më të hershëm neolitikë të këtij rajoni dhe ndër më të hershmit në Shqipëri janë Burimi, Cetushi, Kronëzat (Fushë-Alie), prej të cilave, dy të fundit përfshihen brenda kuotave të përmbytjes, pasi janë shumë afër bregut të djathtë të Drinit të Zi.

Nëpër këtë luginë kalonte degëzimi verior i Egnatias antike, që bashkonte dy tranversalet më të mëdha tranballkanike, atë Egantia në jug (Ohër) dhe atë Lissis-Naissus në veri (Kukës). Në zonën e përfshirë nga harta e liqenit të HC të Skavicës do të përmbyteshin përgjithmonë, pa u prekur nga arkeologët, një arkiv i vërtetë vlerash dhe artefaktesh arkeologjike, që gjenden në këtë hapësirë. Duke filluar nga Skavica, pra nga veriu, e duke u ulur në drejtim të jugut, mund të përmendim sitet arkeologjikë të rrezi kuara nga përmbytja:

- Zona tumulare e Draj-Reçit (tek Trocet)
- Zona tumulare e Zalldardhës (Qyteti në Majë Meje)
- Vendbanimi prehistorik “Çuku i lekës”(Zall-Dardhë)
- Vendbanimi eneolitik “Kodra e qytetit” (Zall-Sinë)
- Vendbanimi neolitik i Kronëzave (Fushë-Alie)
- Stacioni rugor në “Xhired e Përnezhe” (Fushë-Alie)
- Vendbanimi prehistorik në “Rrokoçeletë Kutës”, Blliçe (Fushë-Alie)
- Vendbanimi prehistorik në “Kodra e Fer-rës” në Blliçe (Fushë-Alie)
- Vendbanimi prehistorik në “Kodra e Pareve” në Blliçe (Fushë-Alie)
- Venbanimi prehistorik i Cetushit
- Vedbanimet prehistorike dhe antike të Kastriotit.
- Vendbanimi prehistorik në “Kodra e Bal-lës” në Muhur
- Vendbanimi eneolitik i Gradecit (Brezh-dan)
- Vedbanimet prehistorike dhe antike të Ushтелензës
- Vendbanimi prehistorik i Selanes
- Kisha mesjetare në Katund të Ri
- Vendbanimi antik dhe mesjetar i Gradecit (Gradec)
- Vendbanimi prehistorik dhe antik i Topo-janit
- Vendbanimi prehistorik “Tuma e Zojcës” (Mazhicë)
- Nekropoli i periudhës romake i Gjoricës së Poshtme
- Nekropoli i periudhës antike i Sofraçanit
- Kalaja ilire e Tuçepit ose Lladomericës etj

Kjo do t’i shkaktonte një dëm të madh shkëcës sonë arkeologjike. Nga ana tjetër ajo do të plotësonte dëmin e krijuar në pjesën lindore të Dibrës, që shtrihet në territorin e FYROM, ku në vitin 1964 u përmbyt përjetësisht fusha e Udovës, më e madhja dhe më pjellorja e pellgut të Dibrës. U krye me atë rast një gërmim i vogël shpëtimi, sa për të thënë, dhe u varrosën nën ujë vlera të pallogaritshme arkeologjike.

• **Për arsye historike**

Është theksuar shumë kohë më parë roli i rëndësishëm i Dibrës dhe kontributi i saj i

veçantë në historinë nacionale, në të gjitha etapat e zhvillimit historik e shoqëror. Përmbytja e saj do të thotë përmbytje e të gjithë kësaj historie. Një moment i lavdishëm i saj është padyshim epopeja Skënderbejane e mesit të shek. XV, dhe luftërat e tij fitimtare, atdheu historik i të cilave, është vetë Dibra, ku Skënderbeu zhvilloi 19 nga 24 betejat e tij. Pikërisht kjo Dibër tani rezikohet nga përmbytja! Me këtë veprim të nxituar, zhduket ose përmbytet përjetësisht një pjesë e territorit hapësinor të kësaj epopeje!

Të ndalemi tek luftërat e Dibrës kundër pushtuesëve serbë të viteve 1912-1921. Ofensiva serbe e tetorit 1913 dhe ajo e vitit 1918, nuk lanë fshat të Dibrës pa djegur dy e tri herë. Pushtuesit serbë me sadizmin e tyre çubrilovicianë dhe taktikën e “tokës së djegur”, kryen në këtë hapësirë masakra nga më të tmer-shmet, që mund të imagjinohen nga mendja njerëzore. Nuk ka pëllëmbë të tokës dibane, që nuk u skuq nga gjaku i bijëve të saj, në mbrojtje të vatanit. Këto janë të dokumentuara në arkivat e kohës, në memorien popullore, por edhe në toponimet e shumta të kësaj periudhe si “vorret e vrame”, “vorret e serbit”, “vorri i gruas”, “vorri i nuses”, “vorret e cullve” etj, që tani duam t’i mbysim e ti fshijmë nga kujtesa historike. Ndërsa shkruaj me nervozizëm këto radhë, më vjen në mendje postulati: “ Hapi i parë në likuidimin e një populli është të fshishë kujtesën e tij historike. Shkatëroni librat e tij, kulturën e tij, historinë e tij. Atëhere vini dikë të shkruaj libra të rinj, të krijojë një kulturë të re, të shpikë një histori të re. Para se të kalojë shumë kohë kombi do të harroj se çfarë është dhe çfarë qe.”

• **Për arsye gjeostrategjike**

Është vështirë të mendohet, por përmbytja e Dibrës të duket si një plan i hartuar jo në Tiranë, por në kancelaritë e vendeve fqinje që dikur donin ta përfshinin Dibrën brenda kufijve të tyre dhe që kërkonin të vinin kufirin e tyre strategjik përgjatë Drinit, ose në vargun e maleve perëndimore të Dibrës. Mjaft të sjellim ndër mend faktin se “Naçertanija” famëkeqe e I. Garashaninit (1844) parashikonte edhe “aneksimin e trojeve shqiptare të Vilajetit të Kosovës si dhe të pjesëve veriore dhe qëndrore të Shqipërisë”. Meqenëse këto plane nuk u realizuan falë luftës, qëndresës heroike dhe gjakut derdhur të këtij populli, atëherë përmbytja e sotme e Dibrës, me ose pa dashje, a nuk duket se i ngjan, qoftë edhe formalisht, këtyre planeve antishqiptare?! Është e tepërt të kujtoj se me këto qëllime të mbrapshta ishte përmbytur nga pushteti sllavo-maqedonas edhe pjesa lindore e Dibrës dmth fusha e madhe e Udovës në Dibrën e Madhe (FYROM) me sipërfaqe 1340ha, me pretekst të ndërtimit të HC të Spilesë!

• **Për arsye klimatike**

Tek arsyet klimatike vetëm do të përmendja prishjen e ekosistemit natyror si dhe faktin se rritja e sipërfaqes së pasqyrës ujore do të rriste menjëherë lagështirën absolute dhe relative të ajrit, e cila do të ndikonte drejtpërdrejtë në ritjen e sëmundjeve reumatizmale dhe artriteve tek popullata aktive për punë, ajo e re dhe e mesme, madje dhe tek fëmijët, që sapo të dilnin në rrugë do të ndesheshin me mjegullën dhe ajrin e lagësht që do të vinte nga pasqyra e liqenit të stërmadh të Skavicës.

• **Për arsye juridike**

Në të gjithë botën e qytetëruar, para se të merren vendime të tilla që ndikojnë drejtpërdrejtë në ekosistemin e një rajoni të dhënë dhe në jetën e mijëra banorëve, organizohen referendumet popullore. Pasi një qeveri e përgjegjshme, punon për interesat themelore të qytetarëve të vet.

Të gjithë e dimë mirë dhe qeveria e din edhe më mirë, se në pikëpamje juridike, sikur qoftë edhe një pronar i vetëm i zonës së përmbytur, të mos jap pëlqimin e tij, HC nuk mund të ndërtohet! Dhe meqë jemi tek binomi qytetarë-qeveri, më vjen në mendje postulati i gazetarit të njohur amerikan Eduard R. Murrow **“A nation of sheep will beget a government of wolves”**. Përkthimin e saj në shqip unë nuk do ta bëj, pasi sot anglishten e njohin pjesa dërmuese e brezit të ri dhe e intelektualëve, dhe ky përkthim praktikisht është i panevojshëm.

Fjala e ministrit të Energjisë dhe Industrisë z.Damian Gjicknuri në seancën parlamentare të datës 28 janar 2016. Botuar me shkurtime.

Ministri Gjicknuri: Po spekulohet qëllimisht mbi Skavicën



Çfarë është Skavica?! Po bëhet një spekulim shumë i madh këto ditë. Qeveria shqiptare ka dhënë bonus për një propozim për Katundin e Ri, që është pjesë e të gjithë skemës së shfrytëzimit të Drinit të Zi por jo Skavica në vetvete si hidrocentral. Është shumë e vërtetë që për projektin e Skavicës ka patur shumë variante, variante edhe para viteve '90. Variante të cilat kishin edhe atë projektin megaloman që shkonte deri tek përmbytja e një pjesë të territorit me Maqedoninë dhe që kërkonte marrëveshje mes shteteve. Kuptohet, ky projekt nuk është fare fizibël dhe nuk bëhet fjalë që në kushtet e sotme të marrësh marrëveshje me vendet fqinje e aq më tepër të marrësh parasysh të gjitha impaktet social-ekonomike apo përmbytjet që ai mund të shkaktojë. Ky projekt u abandonua me kohë edhe nga ata që vet e projektuan dhe për këto ka dokumenta me shkrim.

Qeveria e mëparshme e vitit 2005 por edhe kur erdhe ti në pushtet fillove të kërkosh kompani private për ta bërë këtë projekt. Të kam dëgjuar një ditë në media dhe shqyr që je përballë tani. Kur të thoshte gazetarja: z.Berisha edhe ju i keni dhënë bonus kompanisë private, madje 10 pikë e me vendim qeverie. Jo, thojë ti, nuk i kam dhënë. Kam memorie unë, thojë ti, kam iPad. Ja ku është V.K.M-ja këtu e vitit 2007 me numër 775. Autoriteti kontraktues është Ministria e Ekonomisë dhe e Energjetikës e asaj kohe dhe përmes vendimit miratohet bonusi prej 10 pikësh i kompanisë TKG Skavica.

Po çfarë kishte ky projekt? Meqë thua për të mbrojtur interesat e Drinit, duhet të jemi transparent me shqiptarët. E di çfarë kushtesh kishe vënë aty?! Që të mbushet ky liqen i madh do të donte vite dhe kjo dihet, ta kanë thënë edhe ata nëse je konsultuar. Shiko çfarë kushtesh i ke vënë Fierzës ti në kurriz? I ke vënë që Fierza duhet të operojë për 5 vjet në kuotën 285 metër kur sot Fierza operon dhe deri në kufijtë 296 metër. Është pjesë e kërkesës së propozimit të pakërkuar, të cilit i ke dhënë bonus. Ashtu ke menduar! Të flasin me të vërteta, jo dopio standard këtu. Pra, 285 m Fierza në vit do të thotë minus 70 milion euro energji, vetëm për ti bërë favor projektit tënd privat që i dhe 10 pikë me bonus. Ja ku e ke vendimin e qeverisë, shpresoj kësaj radhe të mos e mohosh. Tek Eni Vasili e mohove duke thënë kam iPad këtu. The nuk është e vërtetë, gënjen ministri. Atëhere, dil këtu e kërko ndjesë për ato që the sepse ja ke dhënë 10 pikë në 2007. Dështove dhe tani do që të gënjeshe edhe me vendimin që ke firmosur vet. Ja ku e ke vendimin, unë po ja tregoj publikut se ti nuk do të dëgjosh. Vendim qeverie i vitit 2007, nr. 775 dhe firmosur nga Sali Berisha. Vendimi yt, autoriteti kontraktues i jep me procedurë bonus 10 pikë për marrëveshjen BOT, për formën e koncesionit kompanisë TKG Skavica. Dështoi, nuk bë as kjo dhe shqyr që nuk u bë. Nuk u bë sepse investitorët nuk gjetën financimin dhe filloi kriza financiare. Të qe për ty, ata e morën dhe ti e di shumë mirë.

Çfarë do të thotë dhënia e një bonusi? Miratimi i skemës, i studimit, zgjidhjes teknike por njëkohësisht edhe impaktit që do të binte mbi kaskadën e Drinit. Ta marrin

■ HEC-i Katundi i Ri për të cilin është dhënë bonus është një HEC që ka një digë të vogël, ka një rezervuar shumë të vogël dhe nuk ndikon në rrjedhën e poshtme të lumit Drin. Do të thotë nuk ka asnjë impakt mbi Fierzën dhe rrit kapacitetin shtesë me 56-57 mega fuqi, me një risk tërësisht privat.

vesh shqiptarët sepse Kaskada e Drinit, në rezervën e Fierzës do të operonte me 11 metër më pak, vetëm për ti bërë hapësirë këtij koncesioni privat. Shqyr që nuk u bë. Qe fat për Shqipërinë sepse ndryshe korporata do të kishte shkuar më keq sesa ajo kolpo që i dhe pastaj me marrëveshjen me CEZ-in ku ule çmimin nga 2.8 në 2.2 lekë duke i dhënë goditjen e dytë vendimtare.

Çfarë bëre pastaj më vonë? Le të flasin me fakte. Unë nuk jam njeri që sajoj, as nuk dua të spekuloj por flas vetëm me dokumente. More konsulent me paratë e Bankës Botërore, shumë mirë u bë. Kishe nevojë për një konsulent për të parë parametrat ndërkombëtarë sesi mund të shfrytëzohej kjo kaskadë. Çfarë thotë konkluzioni i Sogreah, studios e cila u morr me këtë punë? Ka dhënë disa opsione dhe thotë se përfundimisht, zgjidhja më optimale është varianti i shfrytëzimit me dy diga, duke marrë parasysh kostot ekonomike, sociale, elementë të tjerë që kanë të bëjnë me përmbytjen dhe shfrytëzimi më i mirë i Kaskadës. Pra, jo varianti maksimal që vërtet mund të dukej i mirë në një kontekst kohor të caktuar, por do ishte një digë e madhe që mund të përmbyste me mijëra e mijëra hektarë tokë. Mund të zhvendoste mbi 10 mijë qytetarë dhe këtu janë edhe pjesët e studimit. Flitet për një variant i cili është i papërballueshëm nga ana ekonomike dhe ka një impakt jashtëzakonisht të madh social. Këto lloj digash sot nuk inkurajohen në botë. Janë shumë të vështira, i bëjnë vetëm shtete shumë të mëdha ose i bëjnë shtete të cilat, e kam thënë, nuk kanë pronë private, nuk e kanë problem fare zhvendosjen e njerëzve. Ose siç bënte regjimi i Enver Hoxhës, e kishte kollaj ti zhvendoste njerëzit, ti rialokonte diku tjetër sepse toka qe shtetërore. Nuk bëhet më ai projekt dhe këtë thotë studimi. Varianti më i mirë i mundshëm dhe që duhet të merret parasysh nga autoritetet shqiptare është ndërtimi me dy diga. I pari është Katundi i Ri dhe ka një diskutim në lidhje me elementin se deri në çfarë niveli do të shkojë Skavica, 395 metër kuota apo 385 metër? Ne, pikërisht sepse nuk jemi të gatshëm akoma për ta përcaktuar këtë, dhe për të mos penguar zhvillimin e kaskadës, kemi avancuar vetëm me Katundin e Ri.

HEC-i Katundi i Ri për të cilin është dhënë bonus është një HEC që ka një digë të vogël, ka një rezervuar shumë të vogël dhe nuk ndikon në rrjedhën e poshtme të lumit Drin. Do të thotë nuk ka asnjë impakt mbi Fierzën dhe rrit kapacitetin shtesë me 56-57 mega fuqi, me një risk tërësisht privat. Do të thotë se investitori privat, konsurciumi në fjalë ka ndërtim, hidrocentrale, fuqi financiare, ka ardhur i vetmi që e ka marrë përsipër këtë risk. Pra, që të ndërtojë një objekt gjenues të vogël, pa garancinë e blerjes së energjisë elektrike siç i jepje ti më përpara me projektet e tjera.

Po flas teknikisht por të paktën ka edhe njerëz që na kuptojnë. Akoma kemi mëdyshje sesi do të veprojmë me Skavicën, në kuotën

385 apo në kuotën 395?! Kemi kërkuar konsulencë ekstra dhe unë shumë shpejt do të bëj një takim me donatorët, për shkak të përgjigjeve deri diku pozitive që kam pasur nga ata. Do zgjedhim një konsulent për të gjetur skemën më të mirë për pjesën e asaj që quhet Skavicë, e cila në çdo rast, po e them këtu se do të behet në bashkëpunim me KESH-in. Pra, KESH-i do të jetë partner dhe jo që korporata të mbante përsipër eksperimentin korruptiv si ky rasti TKG-së, ku do të operohej me kuota 285 dhe ku çdo gjë tjetër do të shkonte në përfitim të investitorit privat. Këtij të fundit i ke dhënë pikët maksimale që mund të jepte ligji i koncesioneve. Këto janë realitetet e ndryshme.

Nuk ka asgjë këtu për tu spekuluar, bonusi është një procedurë e parashikuar në ligj. Gjithçka ka qenë transparente dhe në përputhje me ligjin. Të dalë dikush këtu dhe të thotë që është shkelur ligji. Ndërkohë, projekti Skavicës nuk është dhënë me koncesion. Projekti Skavicës është akoma në fazë studimore, në atë nivel që thamë se do të jetë më mirë për interesat e kompanisë publike edhe për vet vendin në aspektin rregullator, ashtu sikurse edhe për të shtuar prodhimin e energjisë. Kam përshtypjen se duhet të kërkosh një ndjesë të madhe për ato që ke patur tentativë të bësh dhe për gënjeshttrat që the këtu se nuk kam dhënë bonus. Ti e ke trajtuar njësoj, thjesht dështove.

Së fundi, prapë në vitin 2012 qeveria jote ka marrë edhe një konsulencë tjetër për këtë çështje, nga IFC-ja kësaj radhe. Dokumentet janë në ministri, edhe ti duhet ti kesh sepse e ke zakon që merr nga një kopje letrash kur ikën. Konsulenti këtë të ka thënë: abandoni Skavicën 441 m. Pse? Ja të themi kostot që ka: 10 mijë njerëz duhet të zhvendosen; të përmbytjen 2020 shtëpi; përmbytjen 2600 hektarë tokë. Sipas standardeve të vlerave dhe të dëmeve që shkaktohen nga kjo digë, nga pikëpamja e fizibilitetit ekonomik, nuk ka asnjë kuptim të bësh një digë aq të madhe.

Në kohën e sotme nuk e përballon dot. Kush do ta marrë përsipër atë, mbi të gjitha në proceset liberalizuese të tregut të energjisë?! Energjia po liberalizohet dhe tregu do të jetë tërësisht konkurrense pas disa viteve. Tendenca është që hidrocentralet të jenë private dhe të mos krijosh skema të mirëfillta të centralizuara shtetërore dhe kostot t'ia kalosh publikut për ti përballuar. Kosto paraprake thotë shkon mbi 1 miliard euro. Ky është studimi i IFC dhe konsulentë që janë paguar pikërisht për të na dhënë idenë se si duhet të shfrytëzohej. Sot që po flasim, kemi konsulencë nga BERZH-i edhe për Katundin e Ri, që do të bëhet me një procedurë transparente e sipas ligjit. Kemi kompani konsulence e cila ndjek të gjitha standardet normale të procedurave konkurruese në koncesione. Projektuesi ka marrë bonusin 8 pikë, që nuk është maksimal por është një bonus i pranueshëm. Ka bërë shpenzime dhe ka paraqitur një skemë që merr përsipër edhe riskun e energjisë. Është krejt normale, nëqoftëse ka kompani të tjera le të vijnë dhe të konkurrojnë. Asnjë nuk i pengon dhe patjetër që mund të ketë, kjo është bukuria dhe e drejta e këtij procesi. Me rëndësi është që vepra të zhvillohet, edhe Kaskada të mbrohet në pikëpamjen afatgjatë me interesat publike, por edhe investimet private të vijnë. Me një model të ri krejt ekonomik, model që nuk shkakton më kosto ekstra për qytetarët shqiptarë, ato kosto që ti vazhdimisht ia fshehe.

Për ta mbyllur, Skavica demonstron dështimin dhe inatin tuaj për ato gjëra që po bëhen, një sulm ndaj investitorëve, sulm ndaj të gjithave politikave energjetike. Ka 2 vjet që vazhdohet një sulm sistematik për reformën më të suksesshme dhe që ti përditë po e dëgjon nga çdo institucion ndërkombëtar, energjetika po shkon në një pikë kthese e po rikuperohet. Të kërkoesh ndjesë edhe të japësh një sqarim në lidhje me të pavërtetat që the në emision. Duhet të kesh kurajo, të thuash që më mungoi iPad-i ose më la memoria.

Petrit Vasili: “Skavica si një problem kombëtar e jo lokal”

Motivimi për të shkruar këto radhë ishte mjaft i fortë, pasi u njoha me shqetësimet e specialistëve të energjetikës për problemin, që lidhet me domosdoshmërinë strategjike të ndërtimit të HEC Skavicës shumë më parë se sa ndërtimi i HEC Katundi i ri, që do të dëmtonte sipas mendimit të tyre në mënyrë të pakthyeshme të gjithë zhvillimin afatgjatë të kaskadës mbi lumin Drin.

Në Shqipëri shpesh herë, për fat të keq qëndrimet ndaj zgjidhjeve afatgjata kanë qenë sipërfaqësore, të motivuara nga vlerësime të çastit dhe jo të perspektivës dhe për pasojë vendi është ndeshur më pas me pasojat e tyre negative e të pakthyeshme. Çështja e qëndrimit ndaj sistemit energjetik shqiptar dhe kaskadës së Drinit në veçanti është prova direkte e një qëndrimi të tillë.

Pyetja shtrohet: A do trajtohet kaskada e Drinit si një çështje kombëtare apo si një problem i vogël lokal?

Shqipëria ka fituar edhe me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara me palën jugosllave në atë kohë të drejtën e shfrytëzimit të burimeve energjetike të Drinit të Zi deri në kuotën 485 metër mbi nivelin e detit dhe dihet që marrëveshje të tilla janë mundësi jashtëzakonisht të rëndësishme zhvillimi dhe të drejta të tilla janë të pamundura të fitohen përsëri, pasi ato krijojnë mundësi reale për një shfrytëzim maksimal të potencialeve energjetike të vendit.

Fakti që HEC-et e lumit Drin prodhojnë rreth 90% të energjisë së vendit imponon një qëndrim strategjik, kombëtar dhe afatgjatë dhe detyrimisht edhe projektet energjetike në kaskadën e lumit Drin duhet të jenë të tilla. Konkretisht fjala është për ndërtimin e HEC-Skavicës i cili është argumentuar gjerësisht sipas studimeve shumë të thelluara të viteve më parë, por edhe të atyre më të fundit se është një zgjidhje kyç për të gjithë kaskadën mbi lumin Drin.

Argumentet e specialistëve janë shumë të qarta dhe lehtësojnë dhe vendimarrjen:

Së pari realizimi i një projekti të tillë do bënte rregullimin shumëvjeçar të liqenit të Fierzës pasi aktualisht ai ka një rregullim vjetor dhe për këtë shkak aktualisht luhatjet në liqenin e Fierzës janë shumë të mëdha dhe këtë e konstaton edhe një qytetar i thjeshtë, pra arrin në nivele minimale në muajt e verës dhe arrin në nivele maksimale në disa muajt të tjerë të vitit duke u shoqëruar me shkarkime shumë të mëdha uji, që nuk prodhojnë energji si dhe që shkaktojnë përmbytje masive dhe me pasojë të rënda me të cilat banorët e zonave të gjera janë ndeshur shpesh.

Së dyti, realizimi i një projekti të tillë strategjik do të bënte pra një rregullim shumëvjeçar të kaskadës së Drinit dhe do të optimizonte prodhimin e energjisë në të gjithë kaskadën, pra do të sillte një eficientë ekonomike shumë më të lartë dhe do të evitonte edhe një plagë tepër të rëndë si atë të përmbytjeve.

Argumentet shteruese të specialistëve kërkojnë një reflektim të thellë dhe një konsultim të gjerë, që do të mundësonte vendimarrje afatgjata dhe në doli të ekonomisë së vendit, por edhe të shfrytëzimit maksimal dhe efektiv të risurseve energjetike të vendit, pasi propozimi i ndërtimit të psh. i HEC Katundi i ri me kuota maksimale mjaft më të ulëta deri në 400 metër, do të bënte të pamundur ndërtimin e Kompleksit Hidroenergjetik Skavicë me kuota shfrytëzimi 445 metër dhe kuotë maksimale 485 metër, duke sjellë për pasojë humbje të mëdha në kapacitetet e shfrytëzimit si dhe pamundësinë e rregullimit shumëvjeçar të liqenit të Fierzës me të gjithë pasojat e rënda ekonomiko-sociale që ajo sjell.

Vendime të tilla kaq të rëndësishme dhe me pasoja kaq të mëdha për ekonominë dhe energjetikën si dhe me humbje mundësish të paçmuara kërkojnë vizion, transparencë, debat dhe trajtim si problem realisht kombëtar dhe aspak si një problem lokal, pavarësisht nga çdo qëllim i mirë i momentit.

Vendi ka ende për fat të mirë ekspertë nga më të mirët në Europë, që duhet të përfshihen në këtë debat dhe të dëgjohen nga ne të gjithë.

Ilir Meta kundër Edi Ramës:
Duhet Skavica e madhe!

KRYETARI I LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM
DEKLARON NË EMISIONIN “ZONË E LIRË” SE
“SKAVICA SHPËTON SHKODRËN NGA PËRMBYTJA”.

Nga ADURAHIM ASHIKU

Të premten (29 janar 2016) në mesnatë kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, njëkohësisht kryetar i Lëvizjes Socialiste për Integrim, zoti Ilir Meta, pyetjes së Arian Çanit, drejtues i emisionit “Zonë e lirë”, për hidrocentralin e Skavicës, i përgjigjet me të njëjtat fjalë të ish-kryeministrit Sali Berisha disa vite më parë, kur nga hapja e portave të hidrocentraleve mbi lumin Drin u përmbyt fusha e Shkodrës “Ndërtimi i Skavicës shpëton Shkodrën nga përmbytja”.

Për Berishën dje, kryetar shteti, dhe për Metën sot, kryetar pushteti, që të mos mbytet Shkodra duhet të mbytet Dibra. Që të jetojë Shkodra duhet të vdesë Dibra.

Meta nuk ishte në një mendje me sekretarin e përgjithshëm të partisë së tij Vasili i cili disa ditë më parë shkroi për idenë e një hidrocentrali emërtuar “Katundi i Ri”, ide që doli për herë të parë në faqet e gazetave e televizioneve, ide që nuk ishte lakuar asnjëherë nga kolosët e projektimit të digave dhe ndërtimit të hidrocentrale në kohën e diktaturës. Ilir Meta ishte për Skavicën, mbytjen e tërë Dibrës...

Z. Meta ndonëse foli me kompetencën e “ekonomistit” për leverdinë e ndërtimit të Skavicës, vjedhur në eter nga specialistët e kësaj fushe, harroi qëllimisht të flasë me detyrimin human, me detyrimin njerëzor që të shohë dhe mbrojë mbytjen, shuarjen e një treve të madhe të Shqipërisë, shuarjen njëherë e përgjithmonë të Dibrës, mbytjen në llumin e gjolit të historisë së lashtë e të re të një krahine me emër të madh në mbrojtjen e Shqipërisë nga pushtues të lashtë e të vonë, nga sllavo-serbët, sllavo-bullgarët, sllavo-jugosllavët, myslimano-turqit...

Atë që nuk e bëri Hajredin Pasha në Fushë të Gjoricës më 1844, atë që nuk e bëri Hysni Pasha në Fushë të Dibrës më 1855, atë nuk e bëri dot Serbi në vitet 1913-1922 dhe jugosllavi në kohët e reja, kanë vendosur ta bëjnë politikanët e bashkuar të Shqipërisë “demokratike”.

Partitë politike në Shqipëri; të majta, të djathta, të qendrës, të tokës, të qiellit...janë të gjitha në një linjë për mbytjen e Dibrës. E vetmja që i ndan është paraja e pisët, përfitimi monetar nga mbytja e Dibrës. Çdo mbrëmje në ekranet e vegjël të televizioneve shohim zëra të rinj të partisë në opozitë që flasin për afera të dyshimta, për tendera të fshehura me firma italiane, kineze, turke...për miliona që kanë marrë rugën e xhepave në garën e njohur kush të vjedhë më shumë.

Askush, asnjë politikan i asnjë krahu politik nuk ka dalë të thotë as edhe një fjalë të vetme për zhdukjen e një krahine të tërë nga harta e vendit, për dhjetëra mijëra njerëz që si në vitin 1913, me nga një thes me lecka në krahë u detyruan nga pushtuesi serb të largohen nga qyteti i Dibrës jo më shumë se një muaj pas prerjes makabre që i bëri Konferenca e Londrës Shqipërisë . Asokohe qyteti i Dibrës u zvogëlua me tre herë. Tani Dibra e tërë, Lugina e Drinit të Zi do të detyrojë të ikin me lecka në krah, pa kthyer vështrimin nga varret e të parëve tre herë më shumë.

Askush nga këto politikanë, me pushtet dhe pasuri marramendëse, të luajtshme e të paluajtshme, (pasuri që u rrit në sytë e një brezi të tërë), nuk po shohim të dalë e të thotë se ku do të vendosen këta njerëz, ku do të ndërtohet “Dibra e Re”, ashtu siç u ndërtua “Kukësi i Ri” dhe të tjera.

Pas kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë z. Ilir Meta, prononcimit të tij publik për mbytjen e Dibrës që të shpëtojë Shkodra e vetmja alternativë mbetet ngritja e kartonëve në Kuvend për MBYTJEN E DIBRËS.

Dibranët me një petition firmosur nga drejtuesit e Shoqatës “Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të pellgut të Drinit të Zi” drejtuar njerëzve të pushtetshëm të vendit, folën butë.

Do tu duhet të flasin më fort, shumë më fort. Do të duhet që të shfrytëzojnë të gjitha hapësirat që krijon demokracia e kohës.

Do të duhet ta hedhin çështjen që lidhet me jetën dhe të ardhmen e brezave dibrane në gjyq.


Në fillim në një gjyq të madh publik.

Më pas në një gjyq të madh ligjor.

Më pas në një gjyq të madh ndërkombëtar, gjyqin në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut, gjyqin e Strasburgut.

Ruga ligjore është rruga e madhe, rrugë në të cilën Dibrës nuk do ti mungojnë djemtë e saj të shkolluar për ta çuar dhe për ta mbrojtur në shkallët më të larta të demokracisë së kohës.

Athinë 31 janar 2016



SKAVICA, tradhëti kombëtare

Nga GERI SELENICA

Uji dhe energjia janë dy elementët kryesorë të jetës. Mirëmenaxhimi i tyre është menaxhimi i jetës dhe i kombit.

Marr shkas për këtë analizë nga Vendimi i Qeverisë për dhënien me konçesion një firme private të HEC Katundit të Ri (Skavicës).

Por ç’është HEC Skavica:

- Lumi Drin ka rreth 50 për qind të rezervave ujore të Shqipërisë dhe energjia e prodhuar nga Drini është 3-4 herë më e lirë se ajo e prodhuar në Vjosë dhe shumë më e lirë se lumenjtë e tjerë.
- HEC Skavica është vepra energjitike më strategjike në vend dhe rezervuari ujor më i rëndësishëm i Shqipërisë me rreth 7 miliardë m3 ujë – duke u bërë rezervuari më i madh në Europë.

- Liqeni i Skavicës (sipërfaqe 100 km2, gjatësi 100 km) do të ndryshonte pozitivisht klimën dhe ekosistemin në Shqipëri duhe zhdukur krejtësisht rrezikun e thatësirës, me efekt të ngjashëm me atë të digës së Aswanit në Egjipt.

- HEC Skavica disiplinon përfundimisht problemin e përmbytjeve në ultësirën Shkodër-Lezhë. Për shembull, në 7 janar 2016, Drini kishte prurje rreth 3 000 m3 në sekondë dhe, nëse nuk do të ishte kaskada e Drinit, Shkodra do të përmbytej e tëra.

- HEC Skavica me digë të madhe 485 m të lartë është i vetmi variant zyrtar i aprovuar me vendim qeverie të vitit 1961 dhe i ratifikuar në 2 marrëveshjet e ujrave me Jugosllavinë të vitit 1956 dhe 1961 (që janë ende të vlefshme me Maqedoninë).

- Si pasojë e shpyllëzimeve është përsheptuar mbushja e digave me aluvione. Konkretisht HEC Fierzës i është mbushur 20 për qind e rezervuarit me aluvione dhe jetëgjatësia e tij është rreth 50 vjet. Çfarë e bën të domosdoshme nevojën afat gjatë të një rezervuari më të madh në rrjedhën e sipërme, si HEC Skavica.

Krejt për arsye korruptive nga qeveria e vitit 2003, në pamundësi që një investitor privat (TGK) të bënte HEC Skavicën zyrtare, konsideroi edhe 2 variante më të vogla, por që zyrtarisht nuk u aprovuan kurrë:

1. Varianti maksimal është ende në fuqi me digë 220 m, me lartësi liqeni në 485 m, me kapacitet 390 MW dhe prodhim 2 miliardë MWh/vit, me rezervuar ujor 7 miliardë m3 ujë.

2. Varianti i mesëm është deri në kufirin me Maqedoninë në lartësinë 445 m dhe do të krijonte një rezervuar ujor 3 miliardë m3 (43 përqind të variantit të madh).

3. Varianti minimal (i aprovuar së fundmi nga qeveria) është me 2 HEC-e të vegjël me rezervuarë ujorë në total 5 herë më pak se varianti maksimal.

Problemi kryesor i këtij vendimi të qeverisë nuk është korrupsioni, por rrugëzgjidhja inxhinierike. HEC Skavica nuk është një HEC normal (pasi fuqia e tij gjeneruese është më e vogël se e Fierzës dhe Komanit), por është një rezervuar ujor strategjik kombëtar, 3 herë më i madh se Fierza ose 2 herë më shumë se e gjithë kaskada e Drinit.

Problemet inxhinierike e menaxheriale që krijon HEC Katundi i Ri janë:

1. Ndërtimi i tij e bën absolutisht të pamundur ndërtimin e HEC Skavica e Madhe, duke shkatërrur përfundimisht pasurinë më të madhe ujore kombëtare prej 7 miliardë m3 ujë.

Varianti i HEC	Lart. diges	Fuqia	Prodhimi	Volumi ujit të liqenit	
Skavica Maksimal	485m	390MW	2 mlrd MWh	7 mlrd m3	100%
Skavica i Mesëm	445m			3 mlrd m3	43%
Skavica Minimal	Katund ri	57MW	200 mln MWh	400 mln m3	6%
Diferenca Maks-Min		333MW	1,8 mlrd MWh	6,5 mlrd m3	91%
Fierza		500 MW	1,5 mlrd MWh	2,3 mlrd m3	33%
Koman		600 MW	2 mlrd MWh	450 mln m3	6%
Vau i Dejes		250 MW	1 mlrd MWh	500 mln m3	7%
Ashta		53 MW	240 mln MWh		1%
Kaskada e Drinit SOT		1403 MW	4,7 mlrd MWh	3,3 mlrd m3	47%
Kaskada e Drinit TOTAL		1800 MW	6,7 mlrd MWh	10,3 mlrd m3	313%

2. Fuqia e instaluar në HEC Katundi i Ri (57 MW) e kthen Drinin e Zi në një përrua, duke shkaktuar humbje të mëdha energjitike (200 milionë euro në vit).

3. Për të rritur efikasitetin energjitike, kaskada e Drinit kërkon një menaxhim të integruar nga një operator (KESH), çka rrit efikasitetin energjitike të të gjithë kaskadës me 10 për qind.

4. Duke qenë se HEC Skavica është një rezervuar ujor dhe jo një HEC i zakonshëm nuk mund t’i jepet një konçesionari, i cili ka interes të prodhojë energji, ndërsa KESH ka interes të ruajë energji. Dmth kanë dy qëllime krejt të kundërta.

Pra ky model është kundër interesit publik. Për këtë arsye janë tërhequr investitorët më të fuqishëm në Europë (ENEL, RWE dhe EVN).

5. Faktikisht është dhënë HEC Ashta me konçesion. Por dhënia me konçesion edhe e hidrocentralit të sipërm të kaskadës e fut KESH-in në një sanduic midis dy privatëve dhe e bën shumë të pa menaxhueshme kaskadën e Drinit. Interesi publik e do që Skavica të jetë vetëm pronë e KESH-it.

6. Në se do të binim dakord që do të bëheshin 2 ose 3 HEC-e të vogla, Katundi i Ri është vendi më i mirë për të ndërtuar HEC dhe e ul shumë interesin potencial për HEC-et e tjera të vogla mbi Drinin e Zi. Pra faktikisht në vend të HEC Skavicës së Madhe mbi Drinin e Zi do të mbetej vetëm HEC Katundi i Ri.

7. VKM Nr. 1068, datë 23.12.2015 ka shkëlqë juridike, pasi qeveria duhet të shfuqizojë VKM-në e vjetër, pastaj të marrë një vendim të ri me të njëjtin objekt.

8. Qeveria nuk ka bërë dëgjesa publike me popullsinë e Dibrës dhe nuk ka vlerësuar seriozisht ndikimin social e mjedisor të gjithë varianteve, sipas standarteve ndërkombëtare. Në fakt, Skavica e madhe përmbyt 10 për qind të Dibrës dhe popullsia është e terrorizuar nga kjo mundësi. Por me një vizion të përpunuar me ekspertë nga më të mirët në botë, një liqen i madh do ta bënte Dibrën Zvicër.

9. “Procedura e juridike” e dhënies me konçesion një firme “mike” të një aseti publik është më se e mirënjohur në Shqipëri. Qeveria po e çon në ekstrem traditën korruptive të qeverive pararendëse, por për mua kjo është dytësore në këtë rast.

Unë jam në dijeni që qeveria shqiptare ka marrë propozime (bile ka firmosur Letra Mirëkuptimi) për ndërtimin e Skavicës së Madhe si pronë e KESH nga tre kompanitë më të mëdha në Kinë dhe në botë (PowerChina, GeZhouBa dhe Norinco), që i propozuan qeverisë shqiptare (KESH-it) financimin 100 për qind të Skavicës së Madhe (1 miliardë euro), me një kredi të butë 35 vjeçare, 7 vjet periudhë mospagimi dhe në vazhdim 2 përqind në vit interes. Por qeveria edhe pas më shumë se një viti nuk i ka kthyer asnjë përgjigje propozimeve kineze.

Disa ministra ma kanë thënë hapur që Rama ja ka premtuar Skavicën turqve. Pra, turqit kanë pasur 2 vjet kohë që të përgatisin “propozimin e pakërkuar”, kur asnjë firmë tjetër nuk është lejuar të marrë pjesë. Tani, Ministria e Industrisë dhe Energjitikës mund ta bëjë “tenderin” brenda “ligjit”.

10. KESH është shprehur me shkrim kundër dhënies me konçesion të HEC Katundi i Ri, pasi dëshiron që Skavicën ta ndërtojë e administrojë vetë, por qeveria e ka parë të arsyeshme të mos marrë parasysh pozicionin e KESH, por të AKBN-së (ose më saktë të dy inxhinierëve partiake paeksperiencë).

Nga ana politike, për vetë rëndësinë strategjike, HEC Skavica kërkon një konsensus të plotë midis forcave politike kryesore, pasi flasim për një vendim me efekte shekullore në ekosistem, ekonomi dhe shoqëri.

Edi Rama me “afërën Skavica” s’është thjesht një kryegrabitës i burimeve natyrore, siç është bërë traditë politike këtu, por ai ka kaluar vijën e kuqe të interesit strategjik kombëtar. Strategjikisht shkatërrimi i rezervës më të rëndësishme ujore të Shqipërisë është tradhëtia e madhe kombëtare njësoj si falja e Shën Naumit Jugosllavisë apo tentativa për dhënien e detit Greqisë.

Të ndërtohet duke u bazuar në studime shkencore, në pajtueshmëri të plotë me mjedisin dhe në marrëveshje të plotë me të zotët e shtëpisë (në rastin e veprave të natyrave të tilla), duke i bërë hesapet me hanxhinë, jo pa hanxhinë, siç thotë populli.


Nga: **Prof. asoc. dr. Vesel HOXHA**
Universiteti Politeknik i Tiranës
Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe
Mjedisit

Që në fillim të këtij shkrimi, do të përgjigje-
sha pozitivisht për ndërtimin e tyre në
Lumin e Drinit të Zi. Por, çdo gjë e
rëndësishme e ka pas një "por", bile një "por"
me shumë vlera që në shumë raste është përcak-
tuese për problemet e rëndësishme dhe shumë të
mprehta që mbart. Veç problematikave që lidhen
drejtpërdrejt me lëvizjen ose shpërnguljen e po-
pullatës, kemi të bëjnë edhe me shumë aspekte
të tjera të karakterit të sigurisë, historisë, arke-
ologjisë, bujqësisë, mjedisit, pyjeve, gjeologjisë
etj. etj.. Dhe ajo më e rëndësishmja, e thënë me
pak fjalë, fillon tek bashkëpunimi me komunitetin
e zonës që do të përmbytet, me popullatën, tek
marrëveshja paqësore me to, e kënaqëshme, e
levërdisëshme dhe e sinqertë midis palëve. Pa
një marrëveshje të tillë me të zotët e truallit që
do të përmbytet, nuk mund të ndërtohet as një
dhe as më shumë se një hidrocentrale në zonën
e Dibrës, në luginën e lumit Drini i Zi, pasi nga
kufiri i saj verior e gjerë në kufirin e saj jugor me
ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ajo
ka të zotërit e tokës, të zotërit shekullorë të saj.


Për tu ndërtuar një vepër energetike në rradhë të parë kërkohet transparencë e plotë, për të gjitha detajet e projektit, jo një punë e mbyllur në zyrat qeveritare. Pastaj, mbi këtë bazë transparence, të qartë e të kuptueshme për të gjithë, mund të jepen pozicionimet dhe mendimet konkrete, ndaj vepërës në fjalë. E thënë me fjalë të tjera, duhet diskutuar e duhet pozicionuar mbi bazën e një projekti konkret, për të dhënë mendime konkrete. Si mund të jepen rrugët për zgjidhjen e një problemi të caktuar kur ne nuk e dimë problemin! Unë nuk kam përpara një projekt ku të kem mundësinë të lexoj kuotën e një liqeni që mendohet të krijohej nga diga me lartësi "X" në Skavicë apo diku tjetër!? Mbi këtë bazë të jem në gjendje të them me koepetencë në drejtimin e caktuar për të cilin mund të kontribuoj se ku do të përmblytet e ku nuk do të përmblytet, sa vlera do përmblytet dhe sa jo e kështu me rradhë për të gjitha gjërat. Këtu unë bie ndesh me shumë personalitete që kanë marrë mundimin të shkruajnë për këtë vepër, që në mëndjen time nuk bëhet fjalë për një digë, por për disa të tilla. Shkurt, unë nuk mendoj që mbi lumin në fjalë, Drinin e Zi, të ndërtohet vetëm e ashtuquajtura Skavica. Vetëm me një digë të madhe dhe me këtë të mbyllet ky problem. Kjo do të ishte vertet një fatkeqësi e madhe dhe jashtë logjikës rekomanduese të studimeve komplekse, që janë në pajtueshmëri me mjedisin ose i shkaktojnë atij, dëmin më të vogël të mundshëm. Siç është bërë i njohur që në kohën e monizmit, shumë e shumë vite më parë, emri i hidrocentralit të Skavicës, i planifikuar për tu ndërtuar me një digë të madhe (me tre variante kuotash absolute të digës ose pasqyrës së nivelit të liqenit, që varionin nga 485 m mbi nivelin e detit, 465 m dhe 445 m), jo vetëm do ta përmbyste Dibrën, por në kushtet e sotme nuk nuk besoj se janë as mundësitë financiare të shtetit apo të ndonjë firme private, për ta shpërngulur gjithë atë popullatë të madhe, duke e paguar deri në qindarkën e fundit për pronat e gjithçka tjetër dhe, duke e vendosur aty ku ajo të gjejë jetesën perspektive afatgjate, duke u ndjerë mirë. Vetëm atëherë kur arrihet marrëveshja midis palëve, qeverisë apo firmave private, nga njera anë, dhe shoqatës së pronarëve të tokës në Luginën e Lumit Drini i Zi (ose e thënë ndryshe, popullit që do ti përmblytet prona e do të shpërngulet) nga ana tjetër, hidrocentralet mund të ndërtohen pa problem, aty ku studimet shkencore e japin një verdikt të tillë.

Kam lexuar dhe ndjekur me vëmendje shumë shkrime që janë publikuar në gazetën Rruga e Arbërit dhe në organe të tjera të shtypit periodik për problemën në fjalë. Në vitet 80', ishin në rendin e ditës diskutimet për ndërtimin e H/Ç të Skavicës. Qeveria komuniste e asaj kohe kërkoi të dhëna të plota nga të gjitha institucionet e rrethit të Dibrës dhe atyre të qendrës, për ti grumbulluar, për të vënë në balancë raportet midis humbjeve e fitimit në lidhje me ndërtimin H/Ç të fundit në kaskadën e Lumit Drin në tërësi dhe, degën e tij kryesore, Drini i Zi në veçanti, për të vënë në balancë edhe shumë e shumë probleme të tjera që lindnin nga ndërtimi i hidroçentralit në fjalë. Unë nuk marrë përsipër të them se pse nuk u ndërtua në kohën e monizmit ky hidroçentral, por, një mendim jam i lirë ta jap. Në logjikën


A duhet të ndërtohen **hidrocentrale** në **Lumin e Drinit të Zi**?



Pjesë e planshetit topografik në shkallë 1:25 000 me cilësimin e zonës ku propozohet të ndërtohet diga e parë. Rajoni i Skavicës. (Shigjeta tregon veriun).



Pjesë e planshetit topografik në shkallë 1: 25 000 me cilësimin e zonës ku propozohet të ndërtohet diga e dytë. Rajoni Fushë Çidhën – Kastriot. (Shigjeta tregon veriu)



Pjesë e planshetit topografik në shkallë 1: 25 000 **me cilësimin e zonës** ku propozohet të ndërtohet diga e tretë. Rajoni Katundi i Ri – Selanë. (Shigjeta tregon veriu)

time vjenë natyrshëm mendimi se për shtyrjen e ndërtimit apo të mosndërtimit të tij kanë penguar shumë arsye madhore, pse jo edhe mospërballimi i shpenzimeve e pasojave në lëvizjen e popullatës që do të shkaktonte ndërtimi i këtij H/ Ç, pasi në atë kohë, as që shtruhej problemi i ndërtimit të disa hidrocentraleve në këtë zonë. Fuqitë projektuese inxhinierike ishin përqëndruar në ndërtimin e një dige dhe, po ashtu studimet gjeologo - inxhinierike u përqëndruan në një dige. Vitet rrodhën shpejt, dhe problemi i ndërtimit të Skavicës doli përseri në rendin e ditës, të paktën rifilluan projektet konkurruese, për tju përgjigjur tenderit që do të hapte qeveria për kërë vepër gjigante sipas meje. Megjithëse tenderi është hapur që në vitin 2008, ai është shtyrë dhe sipas meje do vazhdojë të shtyhet, ku arsyet janë komplekse. Njera prej tyre dhe më kryesorja sipas meje, është mos realizimi i një mirëkuptimi të plotë me popullatën e zonës që do të përmbytët, pavarësisht nga projekti fitues, me një apo me shumë diga, variant të cilin unë e rekomandoj. Për variantin me një digë jam kundër në mënyrë kategorike. Gjashtë kompanitë e interesuara sic janë bërë të ditura nga shtypi i

**Varianti me një
digë do të ishte një
shkatërrim total i
trevës së Dibrës
së Poshtme në
veçanti dhe i gjithë
Dibrës në tërësi.**

kohës vite më parë, TGK Skavica srl, një kompani italiane, "Korea Electric Power Corporation", STATKRAFT nga Norvegjia, konsorciumi VERBUND KELAG GRUP nga Austria dhe "R.W.E" AG nga Gjermania, u futën në tender, por në përfundim nuk u komunikua asgjë se kush fitoi dhe kush humbi!?. Sipas përlogaritjeve, thuhet se ndërtimi i këtij hidrocentrali do të kushtojë rreth 800 milion euro. Mendohet se do të prodhojë pas ndërtimit 1.3 - 1.8 miliardë kilovatorë energji në vit, pra do të thotë se do të nxjerrë 60 - 80 milion euro, duke patur parasyshë çmimet aktuale të energjisë që vendi ynë prodhon.

Po ashtu kemi lexuar dhe kemi degjuar të thuhet se me ndërtimin e këtij hidrocentrali, vendi ynë do të ketë deri 15 % energji elektrike hidrike më shumë se gjendja e sotme.

Unë, jo vetëm që nuk mendoj
kështu por, varianti me një digë
do të ishte një shkatërrim total i trevës së Dibrës së
Poshtme në vecanti dhe i gjithë Dibrës në tërësi.

Po të jepej me konçension hidrocentrali në fjalë, energjia që do prodhohej do të shfrytëzohej për rreth 35- vite nga firma ndërtuese fituese dhe vetëm më pas ai do të kthehej në pronë të Shqipërisë.

Më poshtë do të përpiqemi të japim disa mendime modeste për akset e digave të H/Ç-ve që mund të ndërtohen mbi luginën e lumit Drini i Zi, mbi të cilat duhet të përqëndrohen studimet gjeologjike inxhinierike etj., atje ku ato nuk janë bërë. Janë ato dhe vetëm ato studime që do të thone fjalën përfundimtare, në se akset në fjalë janë garant për digat dhe plotësojnë morinë e kushteve teknike që kërkohen të plotësohen. Si njohës i zonës por, pa pretenduar shumë në njohjen e saj, mendoj se mbi lumin e Drinit te Zi duhen të ndërtohen tre hidrocentrale.

Hydroçentrali i parë duhet ta ketë digën aty ku janë bërë studimet, në Skavicë, ku matjet topografike flasin për një kuotë absolute rreth shifrës 305 m mbi nivelin e detit. Duke patur parasyshë morfologjinë e zonës, qendrat e banuara dhe shumë e shumë faktor

të tjerë sugjeroj dhe mendoj se diga duhet të ketë një lartësi të tillë që kuota maksimale e liqenit të mos i kaloj 365 m, maksimumi 370 m mbi nivelin e detit, duke mos e përmbytur ose duke e përmbytur shumë pak, në periferitë e tij, fshatin Fushë Alie. Më konkretisht, Ura e sotme e Lushës e ka kuotën përafërsisht 368 m. Pra liqeni i ardhëshëm që formohet nga diga e Skavicës, ose diga e pare (këtu nuk kam parasyshë vendin e Skavicës klasike por me plus-minus 1 apo 2 km nga kjo digë e caktuar vite me parë), do ta ketë pasqyrën e ujit, për mbushje maksimale, përafërsisht të barabartë me kuotën absolute të Urës së Lushës.

Diga tjetër mendoj se duhet të ngrihet ose ndërtohet në vendin midis Kodrës së Bitrit (me lartësi mbi nivelin e detit 428 m) dhe Kodrës ose Majës së Thekanushit (shiko planshetin topografik me shkallë 1: 25 000, që shënon emrin maja e Armaishtit, me kuote absolute 515 m mbi nivelin e detit). Përafërsisht, aksi i digës mund të përputhet me tubacionet e ujit të kanaleve vaditëse që kalojnë aty. Diga do të këtë një lartësi të tillë, ku pasqyra e liqenit të ardhshëm të ketë kuotë maksimale absolute mbi nivelin e detit rreth 398 -400 m. E thënë me fjalë të tjera, Ura e Muhurrit nuk do të përmbytet, pra pasqyra e liqenit të ardhshëm në kuotë maksimale do të jetë poshtë urës në fjalë, duke e marrë atë afërsisht me kuotë absolute 402 m (disa matje japin kuotë 404 m). Ky liqen do të shkaktoj një përmbytje minimale në tokë buke, shtëpi banimi etj.. Po të pranohim variantin me një digë, qoftë dhe variantin me kuotë më të vogël, pra 445 m mbi nivelin e detit, pasqyra e ujit të liqenit do të ishte 45 m vertikalisht mbi Urën e Muhurrit, ose e thënë ndryshe, 72 m poshtë Majës së Gjaricës. Imagjinoni zonën e përmbytur dhe, kur bëhet fjalë për kuotën minimale!? Po për kuotën maksimale prej 485 m, ku pasqyra e liqenit të ardhshëm do të ishte 32 m poshtë majës së Gjaricës me kuotë absolute afërsisht 517 m mbi nivelin e detit (disa harta e japin 515. 5 m)!?

Që të dyja këto diga ndërtohen, e para në formacione mesozoike dhe e dyta në paleozoike (të formuara me shumë se 250 milion vjetë më parë) të përshatëshme për vepra të tilla, ndonëse fjalën përfundimtare do ta thonë studimet e imtësuar gjeologo-inxhinierike e hidrogeologjike etj., që ndërmirren në përputhje me variantet e propozuara dhe që janë të detyrueshme për ndërtimin e veprave hidroenergjetike. Po ashtu do të rekomandoja ndërtimin e një dige tjetër mbi Katundin e Ri, aty ku lumi Drini i Zi fillon e ngushtohet (shiko planshetin topografik në shkallë 1: 25 000). Aty ku formacionet gjeologjike të karakterit kryesisht flishor të moshës mesozoike (të formuara me shume se 100 milion vjetë më parë), ku janë dominuese formacionet gjeologjike të karakterit karbonatiko - argjilor, mendoj se e lejojnë ndërtimin e një dige me një lartësi të tillë ku, pasqyra e liqenit që do të krijohet prej saj, për një mbushje maksimale të digës, të jetë rreth 440 m mbi nivelin e detit (kuaotë absolute). Nuk jam në gjendje të nënvizojë me saktësi kuotën e Urës së Topojanit, por mund të them se duhet të jetë poshtë kuotës absolute prej 450 m mbi nivelin e detit. Për të qenë më i kuptueshëm dhe për ta patur më të lehtë banorët e zonës për tu orientuar, nënvizoj disa kuota orientuese në terren si: Vendi ku takohet përroi i Vesharsit (rezultat i bashkimit të përroi të Melanit me atë të Pjeçës) me Lumin Drini i Zi, ka kuota absolute 399 m; Perroi në perëndim të Kodrës së Cuculit me kuota 710. 6 m mbi nivelin e detit, e takon Lumin Drini i Zi në kuotën 404 m mbi nivelin e detit.

Deputetët tanë, para se të shtypin butonin për të dhënë votën, të vënë në lëvizje potencialin intelektual dhe përvojën politike në lidhje me veprën në fjalë. Që vendi të zhvillohet, diku duhet të ndërtohet, qoftë ky ndërtim për vehte, për fisin, për lagjen, për fshatin apo qytetin, për krahinën, qarkun apo për gjithë vendin. Problemi qëndron në atë që: Të ndërtohet duke u bazuar në studime shkencore, në pajtueshmëri të plotë me mjedisin dhe në marrëveshje të plotë e të hapur me të zotët e shtëpisë (në rastin e veprave të natyrave të tilla), duke i bërë hesapet me hanxhinë, jo pa hanxhinë, siç thotë populli.

Anekdota e muajit

Ishte një fshatar që po punonte tokën me parmendë. Dy që të lodhur tërhiqnin parmendën dhe gruaja që i shkonte pas duke hedhur farën e misrit... Lodhej fshatari dhe lodhej edhe gruaja e tij. “Mos u mërzit oj grua, i tha një moment fshatari: do lodhemi pak sa ta shtajm n’dhë çat firansh farë, ene mbrapa do të jetë ma e kollajt puna...

- Po mor burr, po, i tha gruaja. Por majsri ene duhet prashajt disa herë, qeh kimik duhet me i hedh rrajn e m’rrajn, pa duhet ujit...

- Po, moj grue, po, ka punë, - e ndërpreu burri, - por masi ta hedhim kët farë, do Zoti e bin, pa mbrama do ta kemi ma lehtë. Do ta prashajtim bashkë, do lodhemi pak kur ta ujisim, herë në mes të vapës e herë në mes të natës. Pastaj do ta presim, e misrin do ta shesim dhe kashtën do të ushqejmë lopën, e kështu do fitojmë e do jetojmë edhe ne si gjithë katundi...

Aty afër, kur burri po mbante me gajret gruan e tij, kalon një burrë me traktor:

- Puna e mbarë!

- Mbarë paç, ia ktheu fshatari.

- A bën me të pyetë për diçka?, - i tha fshatarit.

- Fol, i tha fshatari!

Traktoristi e pyeti se sa do fitonte kur ta shiste misrin? Fshatari i bëri llogaritë: kaq fara, kaq uji për vaditje, kaq plehrat e në fund, kur ta shiste të gjithën do të fitonte 100 mijë lekë për dylm.

Traktoristi ia ktheu:

- Kam unë një mënyrë që ti të fitosh më shumë... Po ta punosh tokën me traktor, me traktor ti hedhësh edhe farën, me traktor ti bësh edhe prashitjen e parë, me traktor të çosh edhe misrin në pazar, ti do të fitosh 200 mijë lekë. Edhe gruan e mban si zonjë në shtëpi! Por për këtë, duhet të më japësh mua 50 mijë lekë, dhe ti çon në shtëpi 150 mijë lekë? Si thua, a biem dakord! Kështu edhe ti fiton më shumë, edhe unë bëj një punë?

- Vallahi, i tha fshatari, nuk bahet çajo punë! Të marrësh ti 50 mijë lekë prej meje nuk ka ba vaki! Dhe ia lëshoi një thupër qeve të luanin vendit!

- Jepi kamve, oj grue, se na zuni nata! Duen mileti me na ba budalla, me fitue e me rrue në kurrizin tonë, dhe ia futi edhe një thupër të fortë kaut më të dobët që nuk donte me luft kamt...

(Rishkruar sipas një versioni të treguar nga ministri i Financave, Shkëlqim Cani, në Parlamentin shqiptar më 28 janar 2016)

Ç’kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Janari nga ngriu. Borë e madhe dhe temperatura të ftohta u regjistruan këtë muaj. Dhe gjithë i ftohti erdhi pas përmbytjeve, që si kudo, edhe në Dibër kanë filluar të ketë pasoja. Drutë në pyje i kemi prerë, edhe muret mbrojtëse i kemi vjedhur për të ndërtuar kalldrëmin para shtëpisë, kështu që rrebeshi i shiut mes arave do shkojë.

Në Kala të Dodës 25 familja janë pa rrugë. Rrebeshet jo vetëm që u morën rrugën, por kanë hapur edhe një kanal të madh. Ata kërkojnë ndihmën e qeverisë, se qeveria është bërë si OJQ jofitimprurëse: shpërndan veç ndihma dhe hedh firma për koncensione...

Katundi i Ri e tundi publikun këtë fillim viti. Një hidrocentral do ndërtohet, kështu që me këtë rast u mor vesh se edhe ku bie Katundi. Se shkencëtarët, specialistët, politikanët dhe projektuesit e Shqipërisë moderne e dinin që Katundi i Ri ishte Katund pranë Skavicës...

Meqë ra fjala te Skavica, debati u rihap. Ca e duan të madhe, ca e duan të vogël, ca e duan me dy diga, e ca me një digë, ca e duan të përmytë gjithë Dibrën deri në Maqedoni e ca e duan të mos përmytë fare asnjë pëllëmbë tokë. Ca e duan të mbytet për inat të Edit e ca e duan të përmytet kur në pushtet të vijë Salu. Sa të merremi vesh ne se si e duam, qeveria po i firmos kontratat. Në fund të fundit, kush pyet për popullin... Kur nuk pyet për pronat, edhe për popullin s’ka pse të pyes...

Kandidati për kryetar i PS, “Kaubojsi” si i thonë këndej nga Tirana, shkoi në Peshkopi dhe e bëri një xhiro bulevardit. Pa kalë e shalë, si Skënderbeu në shëtitore. Dhe konstatoi se “deputetët e Dibrës duan një dru të mirë”, dhe se “zgjedhjet në një organizatë

socialiste u bënë në frymë demokratike dhe në fund i pinë edhe kafen...”

19 persona u akuzuan për mashtrim me pensionet në Dibër. Të gjithë mbi 54 vjeç. Dhe emrat e tyre ishin të rrallë: një germë emri e një germë mbiemri. Se po të shënohej emri i plotë, nuk dihej si dilnin: kushërinj deputetësh apo zyrtarësh të lartë. Dhe ta mendosh që nuk kishin bërë asgjë, veç kanë falsifikuar disa letra dhe kanë rritur moshën, sa për një pension të vogël, që të paguajnë dritat dhe ujin. Se në Shqipëri po vodhe pensionin të nxjerrin erzín, ama po vodhe miliona të bëjnë deputet.

Në Dibër “Kobra” kontrolloi një shtëpi. Dhe gjeti dy arme dhe ca fishekë. Pastaj policia arrestoi një 60 vjeçar. Ama, po të kishte kontrolluar “Kobra” edhe një një fshat më larg, do kishte kafshuar edhe një 50-vjeçar, dhe me këtë rast do kishte shpëtuar një vajzë të re. Por, me sa duket, e ka lënë për herë tjetër, pasi “gjarpri” ti bëjë edhe 2-3 vepra të tjera turpi.

Ata që janë pasuruar me pasuritë e galerive të Bulqizës vazhdojnë të ndjehen në rrezik. Ka rënë çmimi i kromit në 100 USD toni. Kështu që vazhdojnë t’i bëjnë presion qeverisë, që t’u ulë taksat dhe t’u krijojë lehtësira për biznesin. Dhe qeveria, me siguri do t’ua realizojë kërkesat, se ato biznese mbajnë popullin me bukë. Se ndryshe ata falimentojnë dhe qeverisë i shtohet puna, duhet të mbajë me bukë e ujë edhe biznesmenët edhe popullin...

Dibranët e New York-ut u bënë zgjedhje për shoqatën. Është hera e parë që dëgjojnë për zgjedhje në një organizatë. Gjithmonë kam kuptuar “vjedhje” kur dëgjojnë fjalën zgjedhje, ose nënkuptime të saj si: pushim, pezullim, largim apo shkarkim. Nga New Yorku mësova se paska edhe zgjedhje për zgjedhje...



Nuk ka dibran që nuk e njeh Dalipin dhe karron e tij ambulante, me të cilën në mes të qytetit mban familjen me bukë! Nga ora 5 e mëngjesit deri në orën 12 të natës, së bashku me gruan në çdo stinë e kohë! Shembull sakrifice, për të cilin e nderoj fort!

Foto dhe komenti: ©**Edmond Hasani**

Esse

Dibranët ndryshojnë qëndrim: në vend të rrugës na sillni varka...

Unë nuk i kuptoj dibranët që nuk po e kuptojnë apo nuk duan ta kuptojnë “dashurinë” e madhe të qeverisë së tyre për Dibrën dhe trashëgiminë e saj historike e kulturore! “Dashuria” e qeverisë është kaq e madhe, sa që kërkon përmbytjen e përvetshme të vetë Dibrës dhe të historisë së saj! Në emër të kësaj “dashurie” kërkohet të ndryshohet deri edhe harta gjeografike e Shqipërisë Lindore, ku vendin e tokave më pjellore të Dibrës do t’a zë liqeni i HC të Skavicës! Në emër të kësaj “dashurie” po shtyhet për në kalendat greke edhe ndërtimi i “Rrugës së Arbërit”! Pse do thoni ju? Sepse qeveria plasi nga marrazi që t’i bëj “alpinët” dibranë të mësohen me turizmin liqenor! Ajo po kërkon ta bëj Dibrën një Zvicër të vogël! Ku është problemi këtu?!

Por dibranët nuk duan që nuk duan të kuptojnë këtë qëndrim dashamirës të qeverisë ndaj Dibrës! Ata duket se e kanë kuptuar gabim ose nuk e kanë kuptuar edhe thelbin e mosndërtimit të “Rrugës së Arbërit”! Disa thonë se fajin për këtë e kishte qeveria e Kinës! Disa të tjerë thonë, se edhe po të mos e kishte qeveria kineze, pra kushdo që ta kishte fajin, kjo rrugë tashmë nuk u duhej, pasi, në vend të udhëtimeve të lodhshme nëpër lugina, qafa e gryka malesh, shumë shpejt, në saj të “dashurisë” qeveritare, dibranët do të lundronin nëpër liqen?!

Edhe pse mjaft idilike, njerëzit e thjeshtë nuk duan që nuk duan të kuptojnë se qeveria po punon me zell të madh, për të bërë të mundur, që dibranët punëtorë dhe të mençur, të shkojnë tek njeri tjetri me varka! Të shkojnë në punë me varka! Të dalin në pazar me varka! Të dalin shëtitje me varka! Të shkojnë edhe në dasëm me varka! Po, po! Shumë shpejt do të vijë dita që dibranët edhe dasmat t’i bënin me varka! Imagjinoni, krushqit me dhëndërin dhe nusen të hipur nëpër varka! Dhe tani e tutje dhëndurët dibranë, në vend të patentës së veturës do të duhej të

marrin edhe patentën e drejtimit të varkës! Meqë çdo dhëndër i ri është drejtuesi i një familjeje të re, ai duhej të ishte i përgatitur si për sfidat e lundrimit ashtu dhe për dallgët e jetës! Dhe mendjengushtë do ta kuptojnë më në fund se kështu do të lulëzojë biznesi i varkave dhe motoskafëve! Se kështu jeta e popullit do të përmirësohet!

Por s’keni parë gjë akoma! Shumë shpejt do të vijë dita, që më të kamurit e dibranëve, do të blejnë edhe ndonjë motoskaf, madje ta nisin atë direkt nga bodrumi i vilës së ndërtuar ngjitur me liqenin imagjinar. Atëhere nuk do të jetë më në modë ndërtimi i garazheve të veturave në katin përdhes të vilave, por çdo vilë duhej pikësisht të ndërtohej buzë liqenit dhe të kishte si pjesë organike të saj, garazhin e motoskafit! Pse çfarë kishin më tepër stambollinjët e kamur, që dalin për çdo ditë në Bosfor me motoskafët modernë direkt nga bodrumi i vilave të tyre!

Nën shembullin e stambollinjëve, edhe në Dibrën liqenore do të lulëzonte biznesi i kafeneve dhe çajtove në lokalet e shumtë në të dy brigjet e liqenit të Skavicës! Dibranët do të duhet ta kuptojnë se në fund të fundit, nuk ka ndonjë ndryshim të madh në do ta pije kafën apo çajin në Bosfor, në Uskudar, në Dollma Bahçe, Top Kapi apo në lokalet e brigjeve të liqenit të Skavicës! Por dibranët nuk duan që nuk duan të kuptojnë se qeveria është duke punuar për “të mirën” e tyre, që t’i “akulturojë” dibranët “alpinë”, të vështirë për t’u “akulturoar”! Pastaj, a nuk e kanë krahasuar vetë dibranët Dibrën me Stambollin?!

Asnjë qeveri deri më sot nuk ka mundur t’ia përafrojë Dibrën Stambollit, dmth që Dibra t’i përngjasoj Stambollit edhe gjeografikisht, pra të ndahet në mes nga një liqen i stërmadh! Ani pse dibranët nuk duan që nuk duan t’a kuptojnë qeverinë e tyre!

A.B.

Mendohet se familja e madhe e Agollëve, në Kërçisht të Dibrës, të ketë si të parë sheh Murat Begun, këtu e pesëqind vjet të shkuara. Themi familje e madhe, jo nga numri i personave që e përbënin atë, por për nga veprat, kontributet, historinë që la pas dhe historinë që po bën akoma.

Agollët, katër brezat e një familje të madhe

Nga OSMAN XHILI

Mendohet se familja e madhe e Agollëve, në Kërçisht të Dibrës, të ketë si të parë sheh Murat Begun, këtu e pesëqind vjet të shkuara. Themi familje e madhe, jo nga numri i personave që e përbënin atë, por për nga veprat, kontributet, historinë që la pas dhe historinë që po bën akoma.

Sheh Murat Begu, tregohet se ishte komandant i garnizonit turk dhe ndërtoi xhaminë e Allajbegisë. I vdes gruaja e parë dhe martohet me një tjetër. Djali i tij, Aliu, ngatërrohet me njerikën dhe babai i tij e sjell në Kërçisht, ku blen një çiflik, që dhe sot e kësaj dite është pronë e kësaj familje. Shumë gjenerata kanë kaluar që atëherë, shumë emra të shquar, por ne do të fiksohemi te Maliq Kërçishta, pasi që nga kjo pikë ka më tepër dritë e ngjarjet kthjellohen më mirë.

Maliq Kërçishta nuk ishte i shkolluar, por kishte dhunti të lindura. I edukuar me ndjenja kombëtare, ai shquhet për atdhedashuri, për urrejtje ndaj pushtuesve, sidomos ndaj atij serb. Ndoshta një vetëdije e brendshme i thoshte se ky vend, ky popull, për të ecur përpara duhej të shkollohej dhe në fillim të shekullit të kaluar, ai hapi mitepin në Kërçisht që vazhdoi për një çerek shekulli.

Njëherë tjetër i kapën burrat e fshatit dhe i futën në xhami për ti ekzekutuar.

Të vdekur se të vdekur jemi, u thotë Maliq Kërçishta shokëve, a bëjmë besa-besë?

Kërkon ta thirrin komandantin serb për ti thënë diçka dhe e vret me revolen që e kishte mbajtur fshehur. Të tjerët u larguan kush mundi e ku mundën. 12 veta mbetën të vdekur, por ndryshe të gjithë do të kishin pasur këtë fat.

Ai vdiq në vitin 1922, në moshë 55 vjeçare, i lodhur nga luftat, por simbol i qëndresës dhe i rezistencës. Vetë kulla e tij është djegur 12 herë, aq sa muaj ka viti ose aq herë sa erdhi serbi në këtë fshat e në këtë zonë.

ALI MALIQI, NJË NDËR ANTIKOMUNISTËT E PARË

Ai ishte vetëm 14 vjeç kur i vdiq babai, kurse vëllai i tij Ferriku 10 vjeç. Njësoj i zgjuar si i jati, po aq i vendosur, po aq atdhetar. Antifashist, siç kishte qenë i ati, antiserb. Më vonë, antikomunist. Ai kishte studiuar në mitepin që ngriti babai, sa për të kuptuar se komunizmi kishte si qëllim të shkatërronte dhe njerëzimin. Feja për kombin ishte si kulmi për çatinë.

Jeta e Aliut qe një ferr i vërtetë. Në fillim provoi burgun fashist në Ventotene, në Itali, nga më famëkeqët e kohës. Shumë pak zgjati liria për të pas daljes nga burgu fashist. Komunistët do ta vinin në shënjestër si të padëshiruar. Dënohet me vdekje, më pas me 101 vite burg, që përfundimisht reduktohet në 25 vjet.

Njohës i tre gjuhëve të huaja, arabisht, turqisht dhe italisht, shpejt Aliu njihet e miqësohet me ajkën e intelektualëve të burgut. Bashkë me hafuz Krajën dhe hafuz Durgutin përkthejnë Kuranin në shqip, lexojnë e përkthejnë libra të ndryshëm, duke i diskutuar ata me bashkëvuajtës të tjerë.

Gati 30 vjet bëri burg Ali Maliqi, një absurditet, një jetë njerëzore e shpërfytyruar.



Dy Kullat e familjes. Foto e vitit 1935.

Koka e Premtimit (Agollit) është plot ide. Ai është i vendosur që ti zbresë nga koka në tokë, ti bëjë të prekshme për vete e për të tjerët. Stërnipi i Maliq Kërçishtës, kërkon pak ndihmë, sa për të vënë në lëvizje makinën e mbushur me projekte e ajo nuk do të ketë më të ndalur.

I vetmi faj i tij ishte të qenit antifashist, antikomunist, besimtar, atdhetar dhe përhapës i dijes. Në vitin 1935 mitepin që pati çelur babai i tij, e ktheu në shkollën e parë shqipe të zonës, ku mësonin fëmijët e pesë fshatrave. Për këtë, ministri i arsimit të asaj kohe, dr. Nush Bushati, i dërgon Aliut një letër falenderimi.

Ja pra, ky ishte “faji” i Ali Maliqit. Kishte dashur të shkollojë e të arsimojë banorët e zonës së tij. Prandaj endej burgjeve pa ditur, pa ditur nëse do të dilte ndonjë ditë. Jo! Ai nuk shihte dritë në fund të tunelit. Një ëndërr e zezë i thoshte se nuk do të dilte kurrë nga burgu. Nuk do të shihte kurrë më gruan, fëmijët, familjen, tokën që aq shumë e dëshoi, që aq shumë i dha.

Ishte viti 1967. Ali Maliqi kishte kryer 24 vjet e nëntë muaj burgim. Vetëm tre muaj i kishin mbetur për të dalë. Teksa punonin në fabrikën e çimentos në Elbasan, dikush e shtyn nga skela dhe e rrëzon poshtë. Një vdekje misterioze që regjimi kishte përgatitur me kujdes. Nuk dihej përse. Ndoshta dinte më shumë gjëra se sa duhej të dinte, ndoshta...

Komandanti i burgut u thotë fëmijëve të tij që më mirë të mos e trazojnë më tej këtë

histori. Vetëm Zoti e di të vërtetën. Vetëm ai e ka fuqinë për të shpërblyer këtë njeri që aq shumë u përpoq për popullin e tij.

AVNIU, AGIMI DHE JASHARI: TRE VËLLEZËRIT QË MBAJTËN GJALLË EMRIN E BABAIT

Ata janë tre djem të Aliut, tre vëllezër. Tani janë dy, pasi i madhi, Avniu, u nda nga jeta para pak kohe. Ishin fare të rinj kur tentuan të largohen nga Shqipëria për në Jugosllavinë e asaj kohe e më pas në Perëndim. Ata e mendonin se këtu nuk kishin të ardhme. Herët a vonë do të përfundonin në burg si babai i tyre. Ndaj ata tentuan, por nuk e realizuan dot. Vetëm një javë zgjati aventura e tyre në tokën e huaj. I plasën dyerve të burgjeve, i lidhën dy nga dy dhe i shëtitën rrugëve, ditë të pazarit. Në duar prangat që shtrëngonin fort. Në veshë fjalët e tellallit nga prapa. Ej, popull, shihni kriminelët, shihni ata që tradhëtuan atdheun!

Jehona e atyre fjalëve vjen nga thellësia e viteve. Ishte viti i largët 1956 dhe Agimi, vëllai i mesit, ishte vetëm 17 vjeç, me tre vite

gjimnaz të mbaruar. U dënuan me burgim dhe internim, që po ti mbledhësh, familja Agolli ka 104 vite gjithsej.

Donin ta shkatërronin familjen e madhe të Agollëve. I’a prenë trungjet. Donin t’ia shkulnin dhe rrënjët. Por falë Zotit ajo mbijetoi. Nuk ishte rastësi që të parët e tyre bënë xhaminë. Nuk ishte rastësi që Maliq Kërçishta çeli mitepin në zonë. I biri, Aliu e ktheu në shkollë dhe kjo nuk qe rastësi. Nëntë filiza të shëndoshë kanë dalë nga trangu i kësaj familje. Tre fëmijët e Avni Agollit, tre të Agimit dhe tre të Jasharit, më të voglit, që të gjithë me shkolla të larta. Ata punojnë në Vlorë, në Tiranë, në Turqi, në Angli, apo në Amerikën e largët. Që të gjithë me familjet e tyre të mrekullueshme e me profesione serioze.

Sërish ka diçka që nuk shkon. Kulla e Ali Maliqit e djegur 12 herë dhe po kaq herë rindërtuar, qëndron në vetmi. Sa burra ka pritur e përcjellë, sa miq e armiq në të njejtën kohë. Sa beslidhje janë bërë në të. Po të kishin gojë cepat e mureve do ti tregonin të gjitha. Kulla qëndron hijerëndë, por e trishtuar.

Kërkon bijtë e saj të zhurmojnë në të, pret fëmijët e posalindur të qajnë e të qeshin në të. I vetmi që jeton në të është vëllai i mesit, Agimi. E përse qëndron i vetëm kur mund të jetojë pleqërinë e mbetur shumë rehat në Vlorë, në Tiranë, apo në Turqi te djali i vogël, doktor Elidori? Lutjet e fëmijëve nuk e shkulnin dot nga kulla ku ai u lind dhe kaloi fëmijërinë. Ndoshta aty dëshiron ti mbyllë dhe sytë. Por deri atëherë, ka dhe shumë punë për të bërë.

Premtimi sapo ka lënë pas një vit bujqësor, që në njëfarë mënyre, mund të quhet i suksesshëm. Por prapë ndihet i pakënaqur.

Maliq Kërçishta hapi mitepin e parë në Kërçisht në fillim të shek. XX, që vazhdoi për një 25 vite me radhë

Gati 30 vjet bëri burg Ali Maliqi, një absurditet, një jetë njerëzore e shpërfytyruar. I vetmi faj i tij ishte të qënit antifashist, antikomunist, besimtar, atdhetar dhe përhapës i dijes.

Vuri një tufë delesh, mbolli 100 dynym pemtore me lloje të ndryshme që janë në lulëzim e fruta. Pak nga pak po gjallërohet çifligu i tyre e po merr jetë.

Jeta vazhdon për familjen Agolli si një serial që ka shfaqur disa pjesë e shumë të tjera do ti japë më vonë. Megjithëse Agim Agolli në gjimnaz shquhej më shumë për matematikë se sa për gjuhë e letërsi, vitet e burgut i dhanë një farë delli poetik, aq sa për të përshkruar në vargje historinë e jetës së tij, vuajtjet, torturat, mallin.

PREMTIMI, FERMERI I SUKSESSHËM

Premtim Agolli sapo ka mbaruar vjeljet në fermën e tij. Pati nisur herët me qershinë, më pas me kumbullën, me dardhën, e së fundmi me mollën, ku në përfundim grumbulloi e shiti rreth 400 kuintal fruta. Shumë vite pati punuar e jetuar në Vlorë, bashkë me familjen dhe pati menduar se po ti linte një menaxher të mirë pemtores 10 hektarëshe, gjërat do të shkonin si në vaj. Do të komunikonte në telefon, do të linte porositë e duhura për krasitje e spërkatje, e ndoshta njëherë në muaj do të shkonte në Dibër, të qëndronte për tre katër ditë.

Por gjithnjë e më shpesh filloi ta kaplonte një ndjesi e veçantë. Në ditën e fundit, në



Ali Maliqi dhe Ferik Maliqi

Djemtë e Ali Maliqit ishin fare të rinj kur tentuan të largoheshin nga Shqipëria. Ata e mendonin se këtu nuk kishin të ardhme.

Herët a vonë do të përfundonin në burg si babai i tyre. Ndaj ata tentuan, por nuk e realizuan dot.

orët e fundit, ndjente një mall për gjithçka që po linte pas. I dukej se kulla gati njëshekullore përlotej, se pemët e qortonin pse i linte vetëm, kurse babai, Agimi, qëndronte stoik në vendimin e tij. Aty në këmbë, duke u ndarë me babain, para nisjes për në Vlorë, ku banonte me familjen, Premtimi bëri një premtim, që nuk do ta linte babain vetëm, se nuk do ta linte vatanin në mëshirë të fatit.

Ai sapo ka lënë pas një vit bujqësor, që në njëfarë mënyre, mund të quhet i suksesshëm. Por prapë ndihet i pakënaqur. Duhet akoma më shumë. Ai ka disa vite eksperiencë dhe e di ku çalojnë problemet, e di çfarë duhet bërë mirë e çfarë duhet përmirësuar. Fermës së tij të madhe, i duhet një zëtor me pompë spërkatëse, me frezë dhe me triçe, që copë-

ton dhe i kthen në pleh, dhe degët e krasitura të pemëve. Dardha për fermerin përbën një kapitull në vete. Janë 24 dynymë të mbjellë me këtë kulturë. Janë mbjellë rrallë dhe duhet shtuar numri i tyre, nga 1400 rrënjë minimalja, deri në 2400 rrënjë, gjë që duhet realizuar sa më shpejt. Në të njëjtën kohë, duhet futur sistemi mbështetës, me shtylla dhe tela, pasi shumë dardha u thyen këtë vit, nën peshën e kokrrave të mëdha, të llojit Santa Maria.

Sipër blloqeve me pemë gjenden dy burime, që dhe ato janë pronë e tij. Dëshira e tij është që të ndërtojë një depo uji, apo një rezervuar me të paktën 200 metra kub. Dy specialistët izraelitë, që vizituan fermën e tij, i thanë se po të përdorej skema e vaditjes me pika, që ata do ti propozonin, kjo sasi uji ishte krejt e mjaftë. Një depo uji e izoluar do të garantonte moskontaminimin e tij nga bakterje e mikroorganizma të ndryshme. Aty do të mund të fuste dhe plehrat kristalore, duke i shpërndarë lehtësisht në pemtore dhe duke kursyer një pjesë të mirë të punës me krahë. Po, dhe skema e vaditjes duhet ndryshuar. Duhet shkurtuar dhe rreshtat, nga 44 pemë që i ka aktualisht, duhet bërë me 22 pemë.

Arroret, janë një tjetër objektiv i rëndësishëm i pemtores së tij. Aktualisht, ka dy hektarë të zënë me këtë kulturë, por punët nuk kanë shkuar si duhet. Ka pasur disa difekte në zënien e fidanave, por ka problem dhe me vaditjen.

Në teknologjinë primitive, arrën e llogarisin si të panevojë për vaditje apo shërbime të tjera. Ky mentalitet duhet hequr sa më parë dhe këtë po bën Premtimi në mendjen e tij dhe në pemëtoren e tij. Duhet vaditur, duhet plehëruar, duhet spërkatur, të paktën kundër krimbit, gjë që pak është aplikuar deri tani. Ai mendon të shtojë dhe dy hektarë të tjerë me arrorë e lajthi, ku fidanët janë gati të porositur nga Turqia, me 5 euro copa.

Mendja e Premtimit punon me kapacitet maksimal. Aty përzihen qershitë, mollët, dardhët hektarët, fidanat, kunjtalët, metër

Premtim Agolli sapo ka mbaruar vjeljet në fermën e tij. Pati nisur herët me qershinë, më pas me kumbullën, me dardhën, e së fundmi me mollën, ku në përfundim grumbulloi e shiti rreth 400 kuintal fruta.

kubet e ujit, por, natyrisht, të gjitha këto të konvertuara me para. Vërtet ai i vlerëson plehrat kristalorë, por pa hequr dorë nga plehërimi organik. Pranë shtëpisë, e ka një stallë për lopë. Gjithë ajo sipërfaqe toke, mund të afrojë rezerva jo të vogla me tagjira e bazë ushqimore. Ashtu do të ecin të dy krahët në sinkron, bujqësia dhe blektoria. Agimi ka pasur dhe një tufë me dhen. I hoqi se nuk kishte një çoban të mirë, por zemra i qan për ti vënë përsëri. A nuk është pa kuptim të kesh më se 100 hektarë bjeshkë dhe asnjë kokë dele? A nuk kërkon gjithë ai masiv kullosor këmborën e dhenvë, blegërimën e tyre, vrapimin e qengjave, për ta bërë akoma më të plotë romancën?

E si të mos mjaftonin të gjithë këto angazhime, shqetësime, andralla e telashe, Premtimi hedh shikimin në një tjetër objektiv, turizmin. Dhjetra hektarët në fushë me pemë, misër, grurë, zabeli i Fishtit prej 18 hektarësh me gështenjë, lis e dushk, si dhe bjeshka prej 107 hektarësh me pamje marramendëse dhe me burime uji, e bëjnë të gjithën, një panoramë tërheqëse për turistë të huaj e vendës. Ai, që tani ka vendosur në kokën e tij një stallë kuajsh, që do tu shërbejë turistëve për gara e lëvizje të ndryshme. Më pas, njerëzit e lodhur, por të kënaqur, do të drekojnë e darkojnë në një restorant, që do të marrë furnizimin tërësisht nga ferma e tij, që nga sallata e domatja, deri te qingji e peshku. Më pas një gjumë i lehtë e plot ëndërra të këndshme në dhjetë bujtina druri, që do ta bëjnë të paharrueshëm qëndrimin këtu. E nesërmja do të ketë të tjera objektiva për vizitorët e huaj. Vizitë në kalanë 2400 vjeçare të Grazhdanit, vizitë në kishat e Kërçishtit të sipërm, apo vizitë në fshatin e Allejbegisë, për të parë xhaminë 500 vjeçare, si dhe vendbanimin gjashtë mijë vjeçar në Livadhin e Madh. Dhe nëse nuk janë të lodhur, ka akoma surpriza. Mjafton të hypin në një teleferik që ndodhet fare pranë, e ai të shpie në bjeshkën njëqind hektarëshe të Aliut, që kundërmon nga miliona lule të panumërta, e gurgullima e ujit të ngjan me një simfoni të kompozitorëve të mëdhenj. Kur ky teleferik u projektua dhe ishte gati të vihej në punë që para gjysmë shekulli, pse vallë genka i pamundur, sot në kohën e mrekullive të mëdha të shkencës e teknikës? Po përse vetëm të huajt duan të shijojnë mrekulli të tilla, kur dhe ne vendësit të lodhur nga punët e ditës dhe të javës, do të dëshironim një argëtim të tillë, bashkë me gratë dhe fëmijët.

Të gjitha këto janë ide, janë mendime në kokën e Premtimit, por ai është i vendosur që ti zbrësë nga koka në tokë, ti bëjë të prekshme për vete e për të tjerët. Aristoteli tha: më jepni një pikëmbështetje, ta ngrej gjithë botën. Premtimi, stërnipi i Maliq Kërçishtës, kërkon pak ndihmë, sa për të vënë në lëvizje makinën e mbushur me projekte e ajo nuk do të ketë më të ndalur.



Agim Agolli



“Gurit të varrit ia rrëfej” prezantohet mes studentësh

Gurit të varrit ia rrëfej është romani i ri i shkrimtarit Agron Tufa, i cili po vazhdon të prezantohet në mjediset letrare. Romani i botuar në nëntorin e vitit të kaluar dhe trajton temën tabu të fatit të femrave të bukura në diktaturë, përdhunimin që zbret deri në nënvetëdijen e personalitetit. Libri u prezantua më 21 janar 2016 në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, ndërsa më datë 29, në një mjedis studentësh dhe dashamirësish të letërsisë u bisedua në mjediset e “At home Snackbar” pranë qytetit Studenti.

“Përdhunimet e femrave të bukura në diktaturë është një realitet i bazuar dhe jo i fantazuar, që bazohet në disa dhjetëra qindra biseda të regjistruara në Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojeve të Komunizmit”, thotë shkrimtari. “Rrëfimet e femrave që kanë kaluar këtë kalvar janë të

papërbalueshme psikikisht. Ato të bëjnë të ngrish gur; si është e mundur të kenë ndodhur këto. Por nga njëri rrëfim në tjetrin, shihet se kanë një universale të përbashkët të gjitha këto histori reale. Kupton se ka qenë si një procedurë, edhe kolegët e mi që merren me këtë sferë kanë zbuluar të njëjtën gjë. Këtyre femrave u është rezervuar një fat i trishtë, një fat i zi me qëllim që ato të thyhen. Nuk po flas vetëm për atë pjesë të tyre që quheshin si klasa të përmbysura, të deklasuarat që i takonte fati të lindnin të bukura, etj., të cilat se s’bën do të implikoheshin ose do t’u krijonin një diagramë të posaçme për t’i nënshtruar, por edhe për femra të tjera që shkëlqenin me një hijeshi dhe dhunti që u kishte dhënë natyra”.

Libri të rrëmben me historitë e ndërthurura dhe të bën të mendosh më thellë për pasojat e diktaturës, që për fat të keq, nuk është bërë sa duhet, qoftë sa për ta denoncuar.

“Krenaria”, një libër për krenarinë e Katër Grykëve

Më 16 janar, në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar u prezantua libri “Krenaria” e Hysen Dervishit. Veprimtaria u moderua Defrim Methasani, me një pjesëmarrje të gjerë, duke qenë të pranishëm personalitete të artit dhe të kulturës, politikanë, shkrimtarë, poetë e gazetarë jo vetëm dibranë por edhe nga gjithë Shqipëria.

I pranishëm ishte deputeti Sherefedin Shehu, mjeshtri i madh Bujar Kapexhiu, biznesmeni Faik Bruçi, i cili bëri të mundshëm edhe botimin e këtij libri. Ishin të pranishëm disa shoqata kulturore atdhetare si shoqata “Devolli”, me praninë e kryetarit Guri Seferi dhe poetes Eli Kanina; shoqata “Labëria”, shoqata e “pensionistëve të përgjithshëm të Shqipërisë”. Me një sfond një dokumentar me pamje nga Katër Grykët e Dibrës. I pari që foli për librin ishte poeti dhe publicisti Sakip Cami, njëherësh dhe redaktor i librit. Ai vuri në dukje disa nga momentet pikante historike të trevës dhe njerëzve të saj në përpjekjet kombëtare për liri e drejtësi deri në ditët tona. Me interes u prit dhe diskutimi i shkrimtarit dhe gazetarit Halil Rama ku u ndalua në disa nga vlerat e librit “Krenaria” të Hysen Dervishit.

Diskutim me pasion e krenari për vendlindjen dhe librin “Krenaria” foli zoti Besim Ndrejoni. Përveç vlerave të librit foli edhe për shkrimtarin Hysen Dervishi i cili do vazhdojë të botojë edhe librin e dytë. Gjatë takimit përshëndeti deputeti deputeti Sherefedin Shehu, studiuesi Mevlud Buci, Bujar Kapexhiu, Nuredin Hoxha, Guri Seferi etj.

Më të bukur takimin e bënë këngëtarët Lirie Rasha, artiste e merituar, Dritan Jashari dhe Indrit Jushi, të cilët i dhanë gjallëri këtij aktiviteti.

Gjatë përshëndetjes të autorit Hysen Dervishi podiumi “u pushtua” nga nipërit dhe mbesat me buqeta lulesh, djali



dhe vajza, dhëndri dhe bashkëshortja e Hysenit, të cilët e kanë motivuar dhe ndihmuar në botimin e tij.

Ilmi Dervishi

Dibra në dokumentar

Në Pallatin e Kulturës në Peshkopi më 30 Janar 2016 u prezantua dokumentari: “Rrugëtimi, një histori e vërtetë”. Dokumentari i realizuar nga gazetarja e RTSH Mira Shkurti me regji të Ylli Pepos (Artist i Merituar) flet për punën dhe veprimtarinë e dibranëve në Tiranë e New York.

Mira Shkurti ka përgatitur disa dokumentarë me në qendër dibranët jashtë Dibrës. Një vit më parë në Tiranë u prezantua seria e parë e këtij dokumentari, ndërsa në nëntor një seri tjetër është prezantuar në Tiranë me jetën e Dibranëve në New York dhe Tiranë.

Dokumentari i shfaqur në Peshkopi i paraprin edhe një serie tjetër të jetës së dibranëve në Dibër, e cila parashikohet të mbyllet deri nga vjeshta e këtij viti.

Dokumentarin mund ta ndiqni në Televizionin Publik Shqiptar të mërkurën dhe të premten më datë 3 dhe 5 shkurt në mbrëmje.

“Shekspiri dhe Kanuni”, një libër me studime nga Xhafer Martini

Shekspiri dhe Kanuni

Është libri më i ri me studime i Xhafer Martin. Libri trajton tema e motive shekspiriane që kanë pika takimi me kanunin shqiptar. Fisnikëria, vrasja, nxitja e gjakut, roli i fantazmave, lajmëtari, sjellja ndaj mikut, qëndrimi ndaj nënës, e drejta e strehimit, beja dhe funksionet e saj, dëbimi nga vendlindja, dasma, mort, vetëvrasja etj., motive nga vepra shekspiriane janë parë krahasim me fenomene të tilla në Kanunin Shqiptar, duke treguar kështu, se pavarësisht largësisë, komunikimi i kulturave ka ekzistuar prej shekujsh.

Libri është botuar nga Botimet Enja dhe gjendet në librari. Kushton 1000 lekë.


‘Poeti dibran vlerësohet në Korçë

Paradise of Love titullohej konkursi i organizuar nga Klubi Letrar “Bota Sot në Korçë. Nën drejtimin e shkrimtarit Ali bregu, klubi shpalli fituesit në janar 2016, mes të cilëve renditet edhe poeti Ilmi Dervishi me vjershën “Pyet zemrën”. Konkursi u organizua përmes rrjeteve sociale dhe çmimet u shpërndanë sipas vlerësimeve që jepnin lexuesit, duke e bërë konkursin original në llojin e tij

“Përtej ëndrrës” nga Urime Straka

Përtej ëndrrës është vëllimi i dytë poetik i poetes së re Urime Straka. Libri u lexua dhe u diskutua në një mjedis miqsh dhe dashamirësish të letërsisë më 15 janar në mjediset e At Home Snackbar në Qytetin Studenti në Tiranë.

“Uni lirik shfaqet ndjeshëm, ku stili dhe tematika, të cilat trajtohen, janë të spikatura dhe dallohen qartë në vargje, shkruan në hyrjen e librit redaktorja Violeta Neziri. “ Urimja lufton me ndjenjat dhe pasqyron ndjesitë e saj që përtërihen e fuqizohen nga pjesa në pjesë. Figuracioni është i thjeshtë, i goditur, për të përcjellë më qartë idetë dhe mesazhet”.



Nga BEQIR SINA

STATEN ISLAND NY: Shoqata Atdhetare Dibra, ditën e diel në mesditë (31 janar) mbajti Kuvendin X-të, të saj, zgjedhor në sallën e Dibra Klub (Besim “TITI” Maqellara) Staten Island, New York, me një pjesëmarrje të madhe dibranësh.

Në këtë Kuvend - i cili ndoshta ka qenë edhe më i organizuari i kësaj shoqate në vitet e fundit, u hap nga Kryetari në ikje, zoti Musa Paçuku, një veprimtar i njohur në çështjen kombëtare, i cili e udhëhoqi me një përkushtim të veçantë këtë shoqatë, gjatë mandatit që ai la pas.

Paçuku, mbasi lexoi raportin në mbledhjen e parë, ku pos mangësive ai vuri në pah edhe disa nga rezultatet më të mira, të punës së SHAD, gjatë mandatit të tij, si kryetar.

Ai i dha një vend të veçantë, dhe meritore atyre dibranëve, që së bashku me të, nuk iu ndanë shoqatës në momente më të vështira, të punës dhe mbarvajtjes së saj.

Duke u dalluar me kontributin e tyre : në protestat para OKB-së, për mos-devijimin e lumit Radika, mbrëmjet tradicionale dibrane, ngritjen e flamurit me rastin e 28 Nëntorit, promovimin i librit të shqiptarëve të Rekës, e të tjera aktivitete me komunitetin shqiptarë.

Kryetari, në largim, përcolli edhe mesazhin dhe frymën e bashkimit në komunitet, dhe në mes komunitetit dibranë dhe shoqatës, i cili tha Paçuku duhet të ketë më tepër bashkëpunim, me më shumë pjesëmarrje të rinjët dhe gjithë komunitetit dibranë në Shtetet e Bashkuara, në veprimtaritë kulturore, sociale dhe promovuese të dibranëve, dhe ato me karakter kombëtar, dhe jo si gjatë dekadës së fundit.

Në këtë Kuvend dibranë në Amerikë, folën edhe të katër kryetarët që e udhëhoqën në vitet e fundit shoqatën dibrane, zoti Lavderim Cami, z.Xheladin Pjçja, z.Ibrahim Kolari dhe z. Ilir Rusi, të cilët thanë se “ka qenë privilegj dhe krenari, që ata udhëhoqën”SHOQATËN ATDHETARE DIBRA”, duke punuar me një përkushtim të veçantë (pa ndonjë interes) për të bërë më të mirën, për komunitetin dibranë në Shtetet e Bashkuara, dhe Dibrën, qytetin që u jep një krenari si emër, tek të gjithë shqiptarët, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Luginën e Preshevës, Çamëri dhe diasporë” thanë ata. Por, të katër ish kryetarët e fundit, edhe veprimtarë të tjerë të komunitetit dibranë, anëtar të pandar të shoqatës në SHBA, prej se ajo u themelua, u shprehen edhe pak kritik, për atë përse shoqata vitet e fundit erdhi deri tek dëshpërimi, “lodhja” e dibranëve, dhe dështimi i radhës, sidomos me uljen ndjeshmërisht të interesit, për shoqatën, nga të gjithë dibranët në zonën e Tri-Shteshit,

Kuvendi i X-të, zgjedhor, mbasi u njoh me kandidaturat dhe debatin që u zhvillua me këtë rast, nisi me procedurën për zgjedhjen e kryetarit të ri, si dhe miratoi disa ndryshime mbi organet udhëheqëse të kësaj shoqate, sidomos atë të uljes së numërit të anëtarëve të kryesisë nga 21 në 11 dhe ata të zgjidhen nga Kryetari i ri.

Shoqata Atdhetare Dibra në Nju Jork, mbajti Kuvendin e X zgjedhor



ku thuhet se janë më shumë se 15 mijë dibranë, madje edhe prej tyre që kan bërë edhe ndonjë histori suksesi.

Mbasi kryesia e shoqatës zgjodhi me vota kryesinë permanente për udhëheqjen e Kuvendit, me kryetar Lavderim Cami, anëtar, z Musa Paçuku, Gazmend Kërkuti dhe Fisnik Daci, u miratua programi për zhvillimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e Kryetarit të ri.

Më pastaj, u shpallën dhe u miratuan menjëher tre kandidaturat, Shpend Koleci, Dashi Miftari, dhe Besim Ramadani, dhe, u diskutua nga tre kandidatët, me përgjegjësi, duke iu përgjigjur pyetjeve të, të pranishmeve, se çfarë do të bënin ata me shoqatën. Sidomos, lidhur me shqetësimin e komunitetit dibran për ta rivitalizuar atë, dhe kthyer atë ku e meriton dhe e ka qëllimin shoqata. Gjithashtu, u folë mbi rëndësinë e programit të SHAD-së- Statusit të saj, si dhe për risitë që ata mund të sjellin me ndryshimet që duhen bërë për mbarvajtjen e saj.

Në fillim në emër të Kuvendit të SHAD,

iu dha një respekt i veçantë me një minutë heshtje, luftëtarit të lirisë së Kosovës, ushtarit të UÇK-së, dibranit Fatmir Abdullahi - Begu - krenarisë së kombit “Fatmir Begu” Lavdi !

Kuvendi i X-të, zgjedhor, mbasi u njoh me kandidaturat dhe debatin që u zhvillua me këtë rast, nisi me procedurën për zgjedhjen e kryetarit të ri, si dhe miratoi disa ndryshime mbi organet udhëheqëse të kësaj shoqate, sidomos atë të uljes së numërit të anëtarëve të kryesisë nga 21 në 11 dhe ata të zgjidhen nga Kryetari i ri.

Për kryetar i kësaj shoqate, me shumicë “dërmuese”, u zgjodh një i ri në komunitetin dibran Dashnor (Dashi) Miftari, (afaristë majft i suksesshëm me vëllezërit e tij -) të cilit i pari ia urojë zgjedhjen - ish kryetari zoti Musa Paçuku, dhe dy kandidatët e tjerë, Shpendi Koleci, i cili mori 26 vota dhe Besim Ramadani i cili mori vetëm 6 vota.

Të pranishëm në këtë Kuvend zgjedhor i ishin më shumë se 112 veta si dhe katër kryetarët e fundit, Cami, Pjçja, Kolari dhe Rusi, dhe shumë veprimtar të dalluar të

Jam me të vërtet i emocionuar dhe krenar e i privilegjuar me dhënien e besimit nga ana juaj si kryetar i SHAD, gjë që për mua paraqet një motiv shtesë për punën që që do të jetë fryt i përpjekjeve tona të përbashkëta si komunitet dibran në SHBA. Unë premtoj - që së bashku me ju - çdo dibran do të punoj drejtë, me sinqeritet, përkushtim dhe vetëm në të mirën dhe në shërbimin e komunitetit ...

komunitetit, dhe Klubi i Futbollit Korabi nga Nju Jorku me president Murat Melën.

Zgjedhjet ishin shumë demokratike, transparente(fair pa asnjë kundërshtim dhe dyshim) dhe me një pjesëmarrje me diskutime mjaft konstruktive, të cilat tani patjetër që duhet t’i shërbejnë, gjithësesi, edhe më shumë kryetarit të ri e kryesisë, së Shoqatës më të suksesshme në komunitetin shqiptarë, dhe një ndër më të nderuar në Shtetet e Bashkuara, Shoqatës Atdhetare Dibra në Staten Island - New York.

Për së fundi në mbyllje të Kuvendit të X-të , kryetari i sapo zgjedhur i Shoqatës Atdhetare Dibra , në Staten Island - New York, zoti Dashnor (Dashi) Mifatri, pasi përshëndeti të pranishmit i falënderoi ata për besimin që treguan, dhe, kërkojë që ky besim të vazhdojë edhe më tutje me mbështetjen e tyre, mbas këtij kuvendi.

Mes tjerash ai tha se: “Jam me të vërtet i emocionuar , dhe krenar e i privilegjuar me dhënien e besimit nga ana juaj si kryetar i SHAD, gjë që për mua paraqet një motiv shtese për punën që që do të jetë fryt i përpjekjeve tona të përbashkëta si komunitet dibranë në SHBA. Unë premtoj - që së bashku me ju - çdo dibran do të punoj drejtë, me sinqeritet, përkushtim dhe vetëm në të mirën dhe në shërbimin e komunitetit dibranë, e veçanërisht asaj dibrane, këtu në zonën e Tri-Shteshit, ku ne mbledhemi rreth kësaj shoqate.

Gjithmonë, duke pasur parasysh se kemi një komunitet kaq të madh dhe mjaftë të rendësishëm, me kontributë të veçantë edhe në aspektin kombëtar, ndër vite këtu në SHBA. Mbasi, dibranët, kanë bërë histori suksesi dhe janë, biznesmen, afaristë dhe intelektual të dalluar në komunitet. Komuniteti, ynë, tha Miftari, ka një rini shëmbulllore (fëmijët dibranë të shkolluar, dhe shkëlqyer në shkollat më të mira Amerikane) nga e cila unë besoj që së bashku me ju - dhe çdo njerin me ne, me atë kontributin e tij - do të mund të kryejmë punë të mëdha, që do të jenë në të mirë të të gjithëve, ne komunitetit dibranë dhe Dibrës, qytetit tonë historik, dhe çështjes madhore, asaj të gjithë shqiptarëve - çështjes sonë kombëtare”.



Nga cikli “Në Rodos mes dibranësh e rrëfenjave për vendlindjen”:
Shënime nxjerrë nga zarfi... “Në Rodos, mes dibranësh e rrëfenja me kolosë të lashtë e të rinj...”

emigracion

Dy luznakë mes miteve e bukurive të Rodosit

Nga ABDURAHIM ASHIKU

(Vijon nga numri i kaluar)

Rodosi, ishulli grek vetëm diku te 25-30 kilometra nga Azia, qyteti turk Marmaras, ishulli si “një maj shtize” me një vijë bregdetare 220 kilometra, me burime të pasura të florës dhe faunës, me rajonet e brendshme mbuluar me pyjet e pishave dhe qiparisave, me vila e resorte moderne... nuk mund të kuptohet pa qytetin e vjetër, pa kështjellat e lashta rrethuar me kanale të thellë, pa xhamitë mesjetare, kishat katolike, ortodokse e pagodat hebraike. Një ishull hibrid ku e kaluara kapet me dorë dhe ku e sotmja jetohet me rreth rrotullim koke e vështrimi.

Kësaj radhe, në shoqëri me Njazi Zebin, provojmë të hyjmë në zemër të qytetit të Rodosit në vështrim të së kaluarës dhe në kërkim të mërgimtarëve numri i të cilëve në ishull thonë se i kalon të tridhjetë mijtët. I gjen ato kudo, mjafton të shqiptosh një fjalë shqip dhe ata do të përgjigjen në dialekt çka ta merr mendjen e të çon nga veriu në jug, nga perëndimi në lindje, nga fusha në malet e Shqipërisë sa mendja të shkon e ndalet tek Naimi i madh i penës së mërgimit...

*O malet’ e Shqipërisë e ju o lisat’ e gjatë!
Fushat e gjëra me lule, q’u kam ndër mënt
dit’ e natë!*

*Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt’ e
kulluar!*

*Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pylle të
gjelbëruar!*

*Do të këndonj bagëtinë që mbani ju e
ushqeni,*

*O vendëthit e bekuar, ju mëndjen ma
dëfreni.*

.....

Naimin mund ta kuptosh vetëm kur je varg vendit tënd, kur të merr e të bren malli, kur të dhemb zemra e të qan syri.

...Eci rrugëve e rrugicave shtruar me kalldrëm, ngre sytë sa më këputet qafa duke kundruar minaret e larta të xhamive mesjetare, hyj e dal sokakëve shekullorë, meditoj tërmetin e fuqishëm të vitit 223 para Erës së Re që shkatërroi njërën ndër shtatë mrekullitë e botës antike, Kolosin e Rodosit, otomanët pushtues që nxorën nga deti copat e bronzit si plaçkë lufte, pushtuesit që erdhën njeri duke zburar tjetrin; Grekët, Romakët, Bizantinët,, Osmanët, Italianët...pushtues që nuk shkatërruan asnjë monument kulturoro-artistik për ti zëvendësuar me të tyret por vetëm se shtuan diçka nga vetja. Përgjashtim bëjnë bombardimet Britanike të vitit 1944

...Është nga Luznia. Babën ia quajnë Ali. Kur erdhëm për herë të parë në Rodos banonim në një hotel. Më thanë që këtu asht një person që ka kompani private dhe quhet Njazi Poliçi. Çdo shqiptar që kishte shkuar në Rodos kishte kaluar nëpër duar të Njazi Poliçit edhe në punë, edhe në banim. Ishte një çerdhe e atyre të pamundurve për të qenë të lidhur me punën nëpërmjet Njaziut.



të cilët shkatërruan objekte historike dhe morën shumë jetë...

Një djalë i ri na kthen larg, shumë larg, n ‘atë ultësirë që i qëndron Malit të Luznisë si një sofër e begatë, Katundin e Ri. Më thotë mbiemrin dhe unë kthehem edhe më larg, tash në kohë dhe në linjë gjaku, Konesha. Xhaxhai im Bajrami, ishte nip tek Koneshët e unë Haxhiun, agronomin dhe mësuesin e njohur të shkollës së mesme bujqësore të qytetit të Peshkopisë dhe të motrën, Farien, martuar në Brezhdan, i kisha kushëri, paksa të largët, megjithatë kushëri, shkonim e vinim. E pyes se i kujt është dhe përgjigja më vjen e ngrohtë. Është djali i Munir Koneshës, një intelektual i njohur në Dibër. Është i martuar me një korçare (një traditë e vjetër e dibranëve e lidhur kjo jo aq me klimën sa me paqëtinë shtëpiake) dhe është në biznes me vjehrrin. Kanë një lokal në një ndërtesë antike ku shërbejnë respekt për klientët turistë e vendas me ushqime të traditës shqiptare, korçare dhe dibrane. Nuk mund të rrija pa i bërë një fotografi ndërsa ai dhe vjehrrin na luteshin të hanim një drekë së bashku...

Nuk ua dhamë fjalën. Dhe mirë bëmë. Labirintet e vjetra nga kaluam na e humbëm rrugën e kthimit...

Tek ecnim Njaziut bëri me dorë në

drejtim të një ndërtese të vjetër me themele shekullore. E tregonin këtë gurët ciklopikë në themele, gurë që kishin dalë në dritë falë një ndjesie që këtu është si të kujdesesh për një fëmijë motak, kjo falë ligjit të rreptë ku nuk mund të vazhdosh të gërmosh një centimetër pa ardhur arkeologët. Më pëlqen ky ligj dhe kujdes që tregon respekt dhe kulturë dhe do të desha që me të njëjtën forcë të veproje edhe në vendin tim.

- Këtu punon Njazi Poliçi me brigadën e tij,- më thotë Njazi Zebi duke e vazhduar tregimin...

...Është nga Luznia. Babën ia quajnë Ali. Kur erdhëm për herë të parë në Rodos banonim në një hotel. Më thanë që këtu asht një person që ka kompani private dhe quhet Njazi Poliçi. Çdo shqiptar që kishte shkuar në Rodos kishte kaluar nëpër duar të Njazi Poliçit edhe në punë, edhe në banim. Ishte një çerdhe e atyre të pamundurve për të qenë të lidhur me punën nëpërmjet Njaziut.

Ai humbi të shoqen pas një sëmundje të rëndë. Një bijë nga Kastrioti. Dashurinë për Të tani e ka hedhë mbi fëmijët që po i rrit me kujdesin e një burri njëkohësisht babë e nënë.

Njazi Poliçi sot ka një brigadë me pak punëtorë. Në shumë raste ka pas punë shumë të mëdha. Shemb, shpon mure,

Një djalë i ri na kthen larg, shumë larg, n ‘atë ultësirë që i qëndron Malit të Luznisë si një sofër e begatë, Katundin e Ri. Më thotë mbiemrin dhe unë kthehem edhe më larg, tash në kohë dhe në linjë gjaku, Konesha.

dysHEME, hap penxhere. Bën edhe punime të tjera si mur guri, suvatime, patinime. Ka marrë shumë shqiptarë në punë. Ka një punë në qytetin e vjetër me Vasilin një grek si të gjithë të pasurit kurnac “puno sot ti marrësh lekët pasnesër”. Vasilin i bëri një objekt që është për tu admiruar sepse i bëri kallëpet, betonet, pastroi vendin e uli në themel me nipërit e vet, me njerëz të njohur. Njaziut është njeri që drejton motoçikletën me një dorë duke i përshëndetur rrugës me dorën tjetër njerëzit e shumtë që i ofrojnë nder e respekt. Të gjitha gjyshet e qytetit të vjetër, gra e burra e njohin Njaziun me emrin Trimi Ky është emri njeriut që rri edhe në mes të dimrit lakuriq në mes e lart mbi motor dhe nuk pyet në se bie shi apo bie borë. Është aksidentuar disa herë, ka vra vetëm veten se për të tjerët gjithnjë tregon kujdes.

Njaziut është bamirës jo në kuptimin e nënë Terezës por për atë që ka bërë sa ka pas mundësi për dibranët.

E takova Njaziun tek vendi i punës, nën zhurmën e barominave që gërryenin me formë por edhe me kujdes gurët e kohëve të lashta. I afrova diktofonin për të marrë me vete zërin e tij, bëmat e një njeriu që nuk flet për vete por për të tjerët.

E lamë që të takohemi të nesërmen. Desha ta gërryej më shumë këtë “gur të çmuar” të Luznisë e të Poliçëve të Katundit të Ri.

Nuk u takuam.

Me njerëzit e punës është vështirë të takohesh. I mban lidhur dashuria për punën.

Zërin nuk arrita ta marr me vete. Mora portretin e tij shkrepur e fiksuar në kujtesën e fotoapararit tim sa një paqetë cigareje...

Vijon në një udhëtim njëditor në kontinentin e Azisë...

Rodos maj 2016



Libri vjen si shembëlltyra e traditës sonë më të mirë që vë në ekuilibër harmoninë midis njeriut dhe botës. Ai përbën një mesazh aktual tashmë ku po përjetohet krizë qytetërimi.

“Jetë në veprat e mëdha”, një monografi me vlera estetike

Nga HAJRI MANDRI

Një personazh tipik, Shaban Bitri, në kontekst tipik të vendlindjes-Bllaçe, në realitete spektakolare të Atdheut që kanë imazh veprat e mëdha ndërtuese, në një familje me staturë psikomentele më të lartë se mjedisi, shfaqet portreti i një njeriu që skalitet me fjalë, si një monument skulptural që sfondi e ndriçon nga të gjitha fjalët. Kur lexon këtë monografi ndjen një kënaqësi estetike me prurje të shumëllojshme mesazhesh që godasin subkoshiençën dhe të bën të mendosh: ja kështu, sa bukur jeto-het! Njeriu gjen zgjidhjet vetë në jetë; ulet, ngrihet, gëzohet, hidhërohet, lumturohet dhe stresohet, por ka një pikëarritje, atje tek objektivi i prekshëm, i dukshëm, i mbritshëm i lumturisë: një jetë krijuese, një familje e mrekullueshme. Përvoja është, ja aty, midis brezave, midis njerëzve që e rrethojnë, mjafton të dëgjojë me vëmendje fëmijërore, dhe zgjidhjet, precedentët, vinin të gatshme nga rrëfimet e pleqve dhe prindërve të urtë.

Si në një përrallë përshkruhet karriera e inxhinierit, formimi i tij, lartësimi i tij. Kohërat skalisin sipas moshës ngjyrat e portretit të personazhit, që nga përshkrimi, të ngjan me një personazh artistik dhe në fakt, për ata që e njohin nga afër, është ky, Shabani, intelektual modest që arriti të ndërtojë ide në çdo kohë dhe situatë. Imazhet morale të rrojtjes brenda kodit etnojuridik të krahinës, pastërtia dhe kultura, sedri dhe krenaria formatuan sjelljen fëmijërore dhe adoleshente të tij, duke u mishëruar si vlera të qëndrueshme në terrenin konkret ku jeton, mëson, punon e vepron dhe që pasurohet gjatë jetës. Kjo bën që libri të lexohet pa u ndaluar për shkak të kohezionit të brendshëm të rrëfimit.

Uni i tregimtarit është dhënë në mënyrë mjeshtërore, duke mos stisur asgjë, ashtu reale dhe e qartë, si një fotografim me rezolucion të lartë, jep inxhinierin në pika ndriçimi si shkolla, familja dhe marrëdhënia me të tjerët.

Vështirësitë për Shabanin ishin shkollë, motiv dhe referencë optimizmi, arritjet ishin për të, një realizim i vetëvlerësueshëm. Filozofia e balancës midis asaj që e ke arritur dhe asaj që të mungon dhe mbetet një aspiratë, jepet me detaje jetësore. Urtësia vjen edhe nga sentenca konçize: Ajo që nuk mund të shmanget, pranoje si fat, e mëson babai. Predispozitat intelektuale dhe përkushtimi në procesin e të nxënies, jepen me episode të mrekullueshme dhe në mënyrë kronologjike, duke ndjekur jetën e heroit lirik.

Shabani është një model mendor konstruktivist, e thënë më thjeshtë, di të ndërtojë qëndrime dhe vlera sipas situatës reale. Kjo e bën atë siç thotë populli: të mençur. Kjo duket në alternativat që ai çekon si mesazhe që çdo njeriu i vjen nga konteksti, jeta përreth.

Ka mjaft njerëz që ecin përmes modelit pësim- mësim dhe ndërlikohen në situata të vështira, duke ecur përmes dilemave dhe pendesave, por Shaban Bitri e vështtron kthjellët rrugën e jetës. Nga ky arsyetim kam të drejtë të konkludoj se përbën një nga modelet që të jep kënaqësi si individ, brenda shoqërisë sonë.



Më datë 23 janar, në mjediset e librisë Tirana Times u prezantua libri i ing. Shaban Bitrit, “Jetë në veprat e mëdha”. Në këtë prezantim, organizuar nga Botimet M&B, në bashkëpunim me shoqatat Lidhja e Intelektualëve Dibranë dhe Çidhna dhe Kastriotët merrnin pjesë miq të autorit, anëtarë të dy shoqatave.

Botuesi i librit, Bujar Karoshi, foli për vlerat e librit nga pikëpamja shoqërore si dhe lidhjen që krijon libri mes lexuesit dhe vendlindjes.

Edlira Haxhiymeri, kryetare e LID, duke folur për librin dhe autorin e tij, vuri theksin në zbulimin e vlerave intelektuale të anëtarësisë së shoqatës.

Muhamet Bitri përshëndeti në emër të shoqatës Çidhna dhe Kastriotët.

Prof. Shaban Sinani foli për të vërtetat dhe besueshmërinë që të ngjall ky libër, pa mbivlerësime dhe pa dalë kund “uni” i autorit. Pikërisht, për këtë besueshmëri që përcjell, libri mbart vlera për t’u lexuar jo vetëm nga familjarët dhe miqtë, por edhe nga një rreth më i gjerë lexuesish.

Në këtë prezantim folën edhe prof. Lefter Kashta dhe Kujtim Bejtaj, të cilët e vlerësuan Shabanin jo vetëm për pasionin e tij për të ndërtuar urat, por edhe për ndërtimin e urave më të gjera të komunikimi nga Veriu në Jug.

Familja që krijoi Shabani, ndoshta që edhe fat, por edhe strukturim, është si një kostum i bukur që i rri përshtat. Ajo lartësohet dhe pasuron imazhin e familjeve të mrekullueshme shqiptare, duke qenë edhe tipike, në diversitet kulturor, njehësim vlerash dhe qëndrimesh, unitet konceptesh dhe motivesh. Shabani me mentalitet perëndimor është përgjithësisht modest dhe nuk ka dashur të shfaqë meritat e tij, me besim se shoqëria ka aftësi të rradhisë rendin e vlerave. Por kjo nuk ka ndodhur pasi shpesh edhe Shabani si ekspert ekselent në veprat e mëdha të dritës, kishte mbi vete të paaftët që e drejtonin. Shabani, shoku dhe mik i mrekullueshëm që më ka ndihmuar dhe mbështetur në botimin e librit tim me studime, mbetet i respektuar dhe i nderuar jo vetëm për njerëzit e gjakut të tij, por edhe për të tjerë në një rreth më të gjerë me humanitetin e tij. Njerëz të tillë dhe familje të tilla, përbëjnë modele pozitive për shoqërinë tonë pasi ata zbukurojnë jo vetëm veten, por edhe të tjerët përreth.

Përgjithësisht, Shabani ka përshkuar një

jetë të lumtur dhe njerëzit e lumtur janë gjithmonë në barazpeshë nga e mira. Sekret i lumturisë së tij qëndron në fuqinë e tij për të ndryshuar. Besimi i tij i parapëlqyer se “jeta është e vështirë”, e ndihmoi të përgatisë indikatorë dhe instrumentë të suksesshëm për ta sfiduar atë. Kurrë nuk e shikoi veten si viktimë e jetës, por motivohej pozitivisht duke patur besim tek të tjerët dhe mirësia e njerëzve. Libri sheh një plan për kërkimin e fatit dhe karrierën e intelektualit shqiptar. Njohja e thellë e jetës, në të gjitha dimensionet e saj, sensi për kohën dhe realitetin, autorit i ka mundësuar që në rrëfimin e tij për veten dhe të tjerë, të korrespondojnë në mënyrë të ndërligjshme, vështirësitë e jetës dhe kënaqësitë e saj. Brenda rrymave të ndjeshme shtresore, laminare që përçojnë tension të lehtë psikomoral, të dhurojnë estetishtë kënaqësi, në zhvillim të episodit si raport me personazhin dhe të tjerët që përbëjnë bekgroundin e tij moralo-estetik.

Eleganca e rrëfimit në vetën e parë e bën ngjarjen konfidente dhe tërheqëse. Përshkrimi i situatave delirante shpjegohen në

kushtet e një shoqërie deprimuese që në fakt ishte i imunizuar individ, dhe lumturinë e kërkonte brenda gjatësisë së fijës së perit, si zhuzhakët argëtues të kohës së fëmijërisë.

Libri është një kontribut filozofik në stinën e keqkuptimeve ndaj arritjeve dhe vlerave të jetës sonë.

Nuk ka rëndësi biografia e njeriut, por vepra e tij. Leximi i librit është një shëtitje e ëmbël në udhët e jetës. Libri është një shpallje e bukur përballë realitetit të vrazhdë të kohës që jetojmë, ku mbledhja e forcave morale, tkurrja e humanizmit, respektit ndaj tjetrit, të qenit njeri, gëlimi i ndjenjave hakmarrëse, shpërfillëse, ironizuese e stigmatizuese, mbulojnë të përditshmen tonë shoqërore.

Libri vjen si shembëlltyra e traditës sonë më të mirë që vë në ekuilibër harmoninë midis njeriut dhe botës. Ai përbën një mesazh aktual tashmë ku po përjetohet krizë qytetërimi. Kërkimi presupozon hipoteza të panumrta, e vërteta është një e vetme. Shaban Bitri në libër është i vërtetë, larg një sheqerosje letrare dhe në përputhje me imulset estetike të kohës.

Kongresi i Lushnjës i dha Dibrës dhe Dibranëve lëngun e jetës për t’i rrënjosur thellë e më thellë rrënjët në truallin e qëmotshtëm të Kastriotëve, i dha barutin e thatë për një fitore të madhe historike

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Eshtë dhjetë vjet të shkuara, e përcjellë në një sesion shkencor emigrantësh në Athinë kushtuar Kongresit, e gjykova të vlefshme ta botoj sepse, siç kam theksuar në mbyllje të kumtimit: Kongresi i Lushnjës, është si vera, si vera e kuqe – gjak i shqiptarëve në luftërat për liri e pavarësi, sa më shumë vite të kalojnë aq më shumë vlera merr.

Dhe jo vetëm ai, e tërë historia jonë, histori që na ndjek, na mban gjallë, na bën krenarë edhe pse jemi larg Atdheut...

* * *

“Sa herë që luftojshin malësorët tanë në Lanë të Lurës, ngrihesh e fluturonte mbi ta një shqipe e cila tue u rrotullue gërhiste egërshëm me zanin e saj të ashpër dhe sulej drejt frontit të serbëve. Kjo ngjarje e mrekullueshme ndodhëte përditë sa herë bëhej luftë, Tue e pamë malësorët tanë këtë shqipe që fluturonte përmbi krenat e tyne, pa u drashtë as nga plumbat e anmikut as edhe nga zhurma e luftës, përtriheshin me fuqi morale e e quejshin si shenjë ngadhënjimi fluturimin e saj dhe tue brohoritë “ Besa besë, asht dita jonë “ sulmojshin me tërbim mbi armikun, të cilin e shtyjshin, shtypshin dhe e dërmojshin...”

Janë këto shënimet e Ismail Strazimirit, të njeriut që mori pjesë me armë në dorë në tre luftëra, historikisht të mëdha për tërë Shqipërinë e në veçanti për Dibrën:

Të luftës epokale për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë nga pushtimi shekullor osman.

Të luftës për mbrojtjen e kufijve etnikë të shqiptarizms nga synimet grabitqare të serbëve. Të Luftës së Madhe Antifashiste Nacional - Çlirimtare të shqiptarëve, luftë e cila e radhiti Shqipërinë në krahun e fituesve të mëdhenj.

Patrioti dibran Ismail Strazimiri ra më 16 nëntor të vitit 1943 në Sllovë, karakollin historik të qëndresës së Eles Isufit, ra heroikisht duke luftuar me armë në dorë kundër pushtuesve gjermanë.

Beteja e Lan Lurës, një karakoll në kalanë natyrore të Sinës e të Çidhnës, kala në të cilën u përkundën djepet e të parëve të Gjergj Kastriotit- Skënderbeut, ishte pjesë e betejës historike shqiptare me rrënjë në Kongresin e Lushnjës.

Atje lindi dhe mori dhenë kënga epokale e Djelmënisë Dibrane :

Drin, o lum i gjanë, Plaku i malësisë
A ke me ia lanë Dibrën Serbisë ?
Kurrë nuk durohet kjo robëni
Dibra e Mojsiut asht Shqipëni

Çohi burra, çohi
Gjithë me besa besë
Për Dibrën luftoni
Me të madhen shpresë

Lurë o vend i naltë, vend i trimënisë !
Aty u banë fjalët, besa e lirisë:
Dibra do shpëtue, vend i Kastriotit
Dibrani lirue, si ka qenë motit

Çohi burra, çohi !
Gjithë me besa besë !
Dhe lirinë festoni
Me të madhen shpresë !

Dibra historike, me lufta valë- valë,
Dera e Kastriotit, gjinit tand ka dalë.
Ke pasur kreshnikë, por ke edhe sot,
Ai për Shqipni, gjakun s’kursen dot.

Kur Lushnja mblidhte në Gjirin e saj burra në zë nga e gjithë Shqipëria, Dibra ishte nën pushtimin serb, Dibra shëronte plagët

Dibra dhe Kongresi i Lushnjës



Kongresi i Lushnjes (21-31 janar 1920) akti themelor kushtetues për pavarësinë e plotë të Shqipërisë

e luftërave të pandërprera, mblidhte armë dhe thante barutin për beteja të reja.

Konferenca e Londrës e kishte prerë token e shenjtë shqiptare sipas anatomisë së prerjes së berrave, vijës kurrizore. Qendra gjeografike shqiptare, Verduni shqiptar në qoftë se do të përmendim pikën baraspe-shore të Francës, njërës prej fuqive më të egra shqiptare të kohës, gjendej në anën tjetër të kufirit. Qytetet kryesore në kurrizin tokësor të Shqipërisë, ishin prerë me sëpatën e mendjeve të ndryshkura të krerëve të fuqive të mëdha. Nuk njihet, në asnjë vend të botës, që qytetet, qendrat e krahinave të priten e të lihen në njërën anë të kufirit e fshatrat, trupi i krahinave, të lihej në anën tjetër. Dibra, Prizreni, Gjakova... qytete me histori të përveçme për shqiptarët mbetën nën Serbi, fusha dhe malësia e Dibrës, Prizrenit, Gjakovës...mbetën të gjymtuara nën... Shqipëri.

Një miku im, Myrteza Shehu, familja tetëvetëshe e të cilit në shtator 1913, pas pushkatimit barbar nga serbët të babait të tyre Sheh Hysenit, patriot, shoqërues i Abdyl Frashërit për në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, një ndër udhëheqësit e kryengritjes së madhe popullore dibrane të shtatorit 1913 kundër pushtimit serb dhe ëndrrës së tyre të moçme për të dalë fillimisht në Drin e më tej në Durrës, qe e detyruar të lejë pasuri e katandi dhe të ikte nga qyteti i Dibrës me “rrobat e trupit”, sa herë e takoja më përsëriste refrenin e një poeme të Gjergj Fishtës, poemë të cilën e kishte mësuar në shkollën filllore:

Padrejtësia e Londonit
E la Dibrën jashtë kufinit
S’kemi ndigjue nga asnjeri
Të ketë kufi nëpër vi
Nëpër vi e puren n’puren
Veç ke ti e në Prizeren
U vunë kufijt ven pa ven

Solla paksa, shumë pak, nga klima dibrane që parapriu dhe shoqëroi dhe pasoi Kongresin Historik të Lushnjës.

Dibra ishte nën pushtim. Lugina e Drinit, vargmalet nga Golloborda në Lurë e Arrën të Kukësit përbënin synimin e afërt të Serbisë, tashmë me një pagëzim të ri shovinist, Jugosllavi, kumbarë i së cilës ishte Parisi.

Nga majëmalet e Nëntë Maleve të Dibrës, jugosllavët shihnin detin, shihnin daljen në Durrës dhe Shëngjin, shihnin ëndrrën e tyre

të moçme, daljen në Adriatik, ëndërr të cilën do ta shuante pushka dibrane me barutin e thatë që solli Kuvendi i Madh i Lushnjës.

Në këtë Kuvend apo Kongres, siç ka hyrë në histori morën pjesë tre njerëz në zë në botën dibrane të asaj kohe.

Haki Stërmilli, shkrimtari demokrat, autori i romanit më në zë në vitet ’30-të, romanit “Sikur të isha djalë”, në shënimet e tij “Dibra në prak të historisë”, shënime të përfunduara më 3 prill 1940, fatkeqësisht ende në dorëshkrim shkruan:

“Mu në këtë kohë, kur shqiptari ishte mbushun plot helm dhe vner kundër armiqëve të tij, një tufë patriotësh u mblodhën në Lushnje dhe, tue interpretue vullnetin e popullit, i thirrën botës e i thanë se Shqiptarët do t’a përballojshin me vdekje çdo vendim që mund të nepesh në dam të tanësisë toksore t’Atdheut të tyne dhe se ata nuk premtojshin me ba asnji koçesion mbi kurriz të tyne. Kjo thirrje, që në realitet ishte klithma e zemrave shqiptare të plasuna e të ngufmueme prej dëshprimit, i shtangu anmiqt dhe ua rrudhu guximin, pse para tyne tash kish dalë një mur pengues. Menjiher ranë poshtë thikat e kasapëve, pse Shqiptari i shtrimë për dheu kish hovë dhe ish ngritë në kambë, me fuqi të jashtëzakonëshme.

Ky qe Kongresi i Lushnjës që u hap më 21 Kallnuer 1920 dhe që protestoi kundër traktatit të mfshehtë të Londrës më 1915 dhe kundër kërkesave të padrejta të fqinjve. E rrëzoi qeverin e Durrësit për vepra ilegale e arbitrarë të kryeme prej saj, zgjodhi dërgatën Shqiptare për Paris, redakttoi një statut themeltar, zgjodhi anëtarët e Regjencës dhe ata të Senatit. Të gjitha këta vendime u zbatuen menjëherë dhe kabineti i formuem erdh e zu vend në Tiranë...

...Në Kongresin e Lushnjës më 1920 u vunë themelet e Shtetit të lirë Shqiptar...Dibra në këtë Kongres u përfaqësue prej Ramiz Dacit, Dine Maqellarës e Dine Demës...”

Ramiz Daci lindi në qytetin e Dibrës në vitin 1887. Mbasi mbaroi në Stamboll shkollën ushtarake “Ashiret” vazhdoi karrierën ushtarake me gradën e oficerit. Ishte një ndër përkrahësit e zjarrtë të çështjes shqiptare. Kur u ngrit flamuri i Shqipërisë në Vlorë dhe Shqipëria u shpall e Pavarur, ai ishte aty.

Në janar të vitit 1920 ishte një ndër përfaqësuesit e Dibrës në Kongresin e Lushnjës. Ishte deputeti i parë i Dibrës në qeverinë e re shqiptare. Në vitin 1922 u burgos në

Peshkopi dhe në rrugë drejt Tiranës, u vra tek Ura e Qytetit të Skënderbeut prej mercenarëve të Ahmet Zogut, asokohe ministër i Brendshëm.

Dine Maqellara lindi në vitin 1875 në Maqellarë. Në vitin 1912, bashkë me disa atdhetarë të tjerë doli maleve të Dibrës për të kërkuar me armë në dorë lirinë e shqiptarëve. Ishte kundërshtar i ashpër i Esat Pashë Toptanit. Ishte pjesëmarrës aktiv në të gjitha kryengritjet kundër pushtimit serb. Në janar 1920 përfaqësoi Dibrën në Kongresin e Lushnjës. Vdiq në vitin 1928.

Delegatët e Dibrës në Kongresin e Lushnjës shkonin me krahë të ngrohtë. Në Dibër, në roje të tokës së të parëve, ata kishin lënë një njeri që populli e quante Arusha e Maleve, në krye të forcave kryengritëse shqiptare në Dibër ishte Gjenerali me Shajak, Eles Isuf Ndreu.

Arrasi, një fshat i vogël në grykëderdhjen e Setës në Drinin e Zi, fshat në Trojet e vjetra të Kastriotëve, do të shndërrohej fill pas Kongresit të Lushnjës, në qendrën e Prefekturës së Drinit, prefekturë e cila shtrihej nga Llanga në kufi me Librazhdin në Has në kufi me Gjakovën. Asokohe Peshkopia ishte nën pushtimin serb. Do të shndërrohej edhe në qendrën e Kuvendit të Arrasit, apo e thënë sipas gojës së popullit, në selinë e “Qeverisë së Arrasit”. Më 13 gusht Kuvendi i Arrasit dha kushtrimin popullor “O liri, o vdekje”. Mbi tremijë dibranë erdhën, me armë në dorë për të përshëndetur “Qeverinë e Arrasit”, për t’u vënë nën komandën e më të madhit luftëtar kundër synimeve serbe ndaj Shqipërisë, gjeneralit të pamposhtur popullor, Eles Isuf Ndreut, i sapo emëruar nga Kuvendi si Komandant i Forcave të Armatosura Dibrane.

“Në mëngjesin e 15 gushtit 1920, shkruan Haki Stërmilli, u ndigjue britma “Besë a Besë” e Sufë Xhelilit (nipit të Eles Isufit) dhe krisma e pushkës së tij që u zbraz kundër serbëve të grumbulluem tek Vorret e Shumbatit. Mbasandaj nuk u ndigjue tjetër veçse një gurgullim e vrazhdët prej kismës së pushkëve, të mitrolozëve, të topave, të bombave dhe të gjamëve. Menjiherë u çue Elezi dhe u bërtiti trimave që kish aty: Në Luftë!

Të gjithë sulmuen. Mbrenda pesë minutave lufta kish plasë në të katër anët e Dibrës, qysh prej skajeve të Gollobordës e deri në Kala të Dodës, prej vijës së kufirit 1918 e deri në buzë të kufirit 1913.

Në mbramë, kur po perëndonte dielli, kishte perëndue sundimi serb në tanë qarkun e Dibrës...”

Kongresi i Lushnjës i dha Dibrës dhe Dibranëve lëngun e jetës për t’i rrënjosur thellë e më thellë rrënjët në truallin e qëmotshtëm të Kastriotëve, i dha barutin e thatë për një fitore të madhe historike. Pas tij e më tej, do të kishim për herë të parë një Shqipëri, ndonëse të cunguar e të prerë mizorisht. Kjo copë shqiptare, me përjashtim të Shën Naumit dhe Vermoshit që Zogu ua dha dhuratë serbëve - jugosllavë, nuk do të nënshtrohej më kurrë, as nga pushtimi fashist dhe nazist dhe as nga synimet e Jugosllavisë së Titos për ta aneksuar atë si republikë të shtatë të Jugosllavisë.

Kongresi i Lushnjës, është si vera, si vera e kuqe – gjak i shqiptarëve në luftërat për liri e pavarësi, sa më shumë vite të kalojnë aq më shumë vlera merr.

Shpresoj që nëpërmjet këndvështrimit nga Dibra të kem sjellë disa vlera, nga vlerat shumë të mëdha ende të panjohura që ai ruan në kujtesë dhe dokumente.

Ky libër është gati për botim nga historiani i njohur, Moisi Murra. Ftojme individë, biznesmenë, institucione dhe dashamirës të historisë që të kontribuojnë në botimin e kësaj vepra të rëndësishme dhe voluminoze për historinë e Dibrës.

Dibra, një monografi e plotë e një populli që ka pësuar hemorragjinë më të madhe të qenies së saj kombëtare

Nga MOISI MURRA

Historia e Dibrës është historia e një populli që ka pësuar hemorragjinë më të madhe të qenies së saj kombëtare.

Nuk ka lagje, fshat, kala, fushë e mal që të mos jetë përgjakur në Dibër, që nga lashtësia e thellë e deri në Luftën e Dytë Botërore. Dibra është krahina që ka pësuar hemorragjinë më të rëndë të kombit shqiptar.

Dibranët, ashtu si gjithë të shqiptarët, kanë bërë përpjekje mbinjerëzore për çlirim, liri e pavarësi, kundër pushtimit të gjatë osman, pushtimeve shoviniste të monarkive të Ballkanit dhe të pushtuesve nazifashistë të kohëve moderne.

Nga viti 1444, kur shqiptarët nën udhëheqjen e Skënderbeut nisën dhe fituan betejën e parë kundër turqve osmanë, më 29 qershor 1444, në Torvioll, Fushë të Kastriotit të Dibrës së Poshtme dhe deri në çlirimin e Dibrës nga pushtuesit nazifashistë, më 2 shtator 1944, dibranëve iu është imponuar një luftë në çdo dhjetë vjet. Dhe kjo nuk është pak.

Në këtë truall, dibranët, mundën pashallarët më të zot të Turqisë osmane si: Hajredin Pashën në betejën e Gjoricës, në nëntor të vitit 1844, Hysni Pashën në 1855, Abdi Pashën në 1860, Demir Pashën në 1872, Kadri Pashën në 1881, Mendu Pashën 1894 dhe Sulejman Pashë Kozakun në 1897.

Në këto luftime u shquan luftëtarë e udhëheqës popullorë, që bënë zë jo vetëm si dalazotës të Dibrës, por dhe të viseve të tjera shqiptare, duke shkruar me gjak faqe heroizmi, që, siç thotë Barleti, për dibranët: “Çdo gjë e ke të sigurtë me ta, ata nuk i lajthit kurrë fati, atyre s’u shpëton kurrë fitorja nga duartë, nga që dinë se ç’bëjnë.”^[1] [1] M. Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë,

Nëse është hedh një gur i vogël në themelet e kalasë së madhe të Dibrës martire, merita nuk është e autorit, por e dibranëve të mëdhenj, që i kanë parë dhe matur ngjarjet e kohës që kalonte Dibra dhe gjithë viset shqiptare me fuqinë e mendjes dhe grykën e pushkës.



Oraniku (Shehri i Dibrës) 1878

1982, f. 142.

Edhe pas vdekjes së Gjergj Kastriotit dibranët nuk e ulën flamurin e kryengritjeve popullore. Më 1560 viset malore në perëndim të Drinit të Zi hidhen në kryengritje, më 1602 dërmuan ekspeditën ndëshkimore turke në Çidhën. Në shkurt të vitit 1833 janë përsëri çidhnakët me flamurin e kryengritjes në duar.

Në korrik të vitit 1835 dibranët ngrihen në një kryengritje dhe marshuan deri në Strugë e Ohër, duke i çliruar përkohësisht këto dy krahina. Gjatë viteve 1836, 1837, 1838 dibranët ishin përfshirë përsëri në kryengritje, por tani me një bashkërendim ndërkrasinor. Ata, nën udhëheqjen e Sheh Mustafa Zerqanit, Mustafa ag Ostrenit, Mustafa Dacit të Dibrës së Madhe, marshuan për Shkodër e në drejtim të jugut deri në Elbasan e Berat.

Me shpalljen e reformave centralizuese të “Hatt-i Sherif i Gjylhanesë” (Dekret i shenjtë i Gjylhanesë), ose siç njihen rëndom reformat e Tanzimatit dhe të “Hati Humajum”, dibranët u pozicionuan vertikalisht në mbrojtje të qenies së tyre, ashtu siç do të pozicionoheshin dhe kundër synimeve agresive, periodike, serbe, bullgare e austro-hungareze, në vitet 1912-1921.

Dibranët u shquan dhe në mbrojtjen e trevave të tjera shqiptare, siç qe lufta për mbrojtjen e Ulqinit, në vitin 1879, për

I bindur se nuk është thënë gjithçka, i bindur se dibranë të tjerë do të vazhdojnë të ngrenë muret e kësaj kalaje, po i parashtror lexuesit këtë punim modest, duke mos pretenduar për ezaurimin e asnjë çështje.

mbrojtjen e Kosovës në 1910, mbrojtjen e Shkodrës 1912-1913, mbrojtjen e Lumës dhe Manastirit 1912. Nga viti 1560 dhe deri në 1921 në Dibër ka lëvizje dhe gjak. Korpusi i ngjarjeve është i madh, i gjerë dhe tronditës. Veç kryengritjeve, në këtë punim bëhet fjalë dhe për organizimin administrativ dhe shoqëror të Dibrës, për Nandë Malet e Dibrës, për oxhaqet, bejlerët dhe agallarët e Dibrës; për qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj çështjes dibrane, për politikën aneksioniste serbe ndaj viseve shqiptare, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, lëvizjen kaçake në Dibër, për luftërat kundër ushtrive serbe, masakrat serbe dhe qëndresën mbinjerëzore të dibranëve etj., etj.

Ky korpus ngjarjesh u bë objekt i librit: “DIBRA”

Nëse është hedh një gur i vogël në theme-

let e kalasë së madhe të Dibrës martire, merita nuk është e autorit, por e dibranëve të mëdhenj, që i kanë parë dhe matur ngjarjet e kohës që kalonte Dibra dhe gjithë viset shqiptare me fuqinë e mendjes dhe grykën e pushkës.

Ka shumë mendimtarë që thonë duhet vështruar vetëm para. Por ka dhe një pjesë tjetër që thonë se duhet kthyer koka dhe prapa. Dibranët kanë arsye ta kthejnë kokën prapa, kudo që të jenë në botë, sepse kanë një histori që shumë vende moderne nuk e kanë.

I bindur se nuk është thënë gjithçka, i bindur se dibranë të tjerë do të vazhdojnë të ngrenë muret e kësaj kalaje, po i parashtror lexuesit këtë punim modest, duke mos pretenduar për ezaurimin e asnjë çështje.

Ka shumë mendimtarë që thonë duhet vështruar vetëm para. Por ka dhe një pjesë tjetër që thonë se duhet kthyer koka dhe prapa. Dibranët kanë arsye ta kthejnë kokën prapa, kudo që të jenë në botë, sepse kanë një histori që shumë vende moderne nuk e kanë.

KONTRIBUO PER GAZETEN

merr kopjen tende

email: rrugaearberit@gmail.com

“është koha për t’u pajtuar...”



Dibrën duan ta mbysin pa i dhënë të drejtën e “fjalës së fundit”. Mbase ky është “ekzekutimi” unikal i denjë për “librin gines”...

Shaqir Tomja, “Hoxha i Madh” dhe mendimtar politikë

Nga **EDISON BALLA**

Shaqir Tomja, i njohur ndryshe si “Hoxha i madh”, u lind në Kovashicë në vitin 1876. “Hoxha i madh” kreu shkollën fillore dhe medresenë në Stamboll, prej nga mori edhe cilësitë dhe dijet që do ta shoqëronin atë sa ishte gjallë. Shaqir Tomja nuk ishte vetëm një hoxhë i zakonshëm. Sipas prof.dr.Bajram Xhafës, në një shkrim të botuar në revistën “Zani i Naltë”, Shaqir Tomja karakterizohej nga njohuri të spikatura që dilnin përtej kuadrit të punës së tij si hoxhë në xhaminë e fshatit. Ai ndiqte me vëmendje zhvillimet e përditshme politike në vend dhe kishte një intuitë shumë të zhvilluar të të menduarit. Të gjithë ata që e njihnin hoxhën tregonin se duhej bërë kujdes me fjalët që i thojë, pasi në të kundërt, ai të “fshikullonte” ose siç thonin dibranët, “ta ndreqte mirë samarin” pastaj. Në muhabetet e përditshme të fshatarëve, jo vetëm në fshat, por në gjithë Dibrën, citoheshin fjalët që thoshte hoxha. Vlen të theksohet se rinia dhe burrërimi i tij përkuan me një periudhë aspak të favorshme për fatet e vendit tonë. Hoxha u lind dhe u rrit në kohën e “krizës lindore”, ku nga njëra anë fuqitë europiane kishin vënë nën trynisi Perandorinë Osmane e nga ana tjetër shtetet ballkanike të sapokrijuara, përkatësisht ai grek e serb, po hartonin planet e tyre dashakeqëse që në koherencë me rënien e perandorisë osmane të mësynin kundër Shqipërisë.

“Hoxha i Madh”, i ndiqte me vëmendje këto zhvillime të rëndësishme politike,por ndryshe nga sa mendonte, se rreziku që i kanosej vendit vinte përtej kufirit nga fuqitë sllave e greke, Paria e Dibrës mendonte se problem më i madh për Shqipërinë ishte Perandoria Osmane.

Për këtë arsye, në maj të vitit 1912, në koherencë edhe me vetëdijen e popullit shqiptarë për pavarësi nga perandoria, organizohet “mbledhja e dheut” e njohur edhe nga historia kombetare, kjo mbledhje drejtohej nga Mersim Dema prej Homeshi dhe me pjesëmarrjen e figurave më në zë të Dibrës dhe jo vetëm. Në këtë mbledhje u mor vendimi se pa u larguar Perandoria Osmane nga “nantë malet e Dibrës” asnjë bujk nuk do të mbillte asnjë kokërr misër. “Hoxha i Madh” i paralajmëroi drejtuesit e krahinave për rrezikun që u kanosej nga largimi i turqve dhe mësymja e fuqive ballkanike të përbërë nga boshti “serbo-grek-bullgaro-malazez”. Si për ta vërtetuar këtë kundërshti, “Hoxha i Madh” ishte i pari që në atë pranverë mori parmendën dhe filloi të punonte tokën e tij, por kur ky lajm shkoi në vesh të drejtuesve të krahinave, ata e kërcënuan se do ti digjnin shtëpinë nëse nuk e linte parmendën. Ai kështu veproi, por me bindjen se largimi i Perandorisë Osmane si mburoje dhe i postave të saj ushtarake do ta linte Shqipërine zbuluar dhe në mëshirë të fatit pa kurrfarë mbrojtje.

Largimi dhe shkatërrimi i postave ushtarake nga Dibra u vlerësua si një arritje e madhe edhe në rang kombëtar, por më e keqja akoma nuk kishte ardhur, pasi fuqitë

ballkanike të bushtit u mobilizuan dhe u vërsulen me urrejtje drejt Shqipërisë, dhe si pikënisje patën Dibrën si pasoje e terrenit gjeografik më të favorshëm. Në të tilla kushte më 28 nëntor 1912 ushtria serbe hyri në Dibër të Madhe ku i vuri zjarrin qytetit dhe vrau e masakroi të rinj e të reja, burra e gra, pleq e fëmijë. Kjo ishte djegia e parë e Dibrës, pasi në 7-vite Dibra vuajti edhe dy djegie të tjera të konsiderueshme.

Pas 1912-ës në një periudhë kohore prej 13-vitesh vendi do të bënte një përpjekje titanike për stabilizim e rimëkëmbje, gjë që për hir të së vërtetës e arriti në mënyrë goxha të suksesshme duhet thënë. Hoxhë Tomja në këtë kohë (1925-1928) punoi si hoxhë e si mësues në Zerqan, e më pas, deri në vitet 1939, në Homesh. Në ati vite objektet e kultit kryenin funksionin e shkollës dhe faltores. Në një periudhë të shkurtër energjitë e shqipëtarëve shpërthyen vrullshëm, shpresat u rritën, por ndërkohë stabiliteti ndërkombëtar lëkundej në shilarës. Vuajtjet për kombin shqipëtar nuk kishin mbaruar këtu, pasi në prill të vitit 1939 forcat fashiste mësynë drejt Shqipërisë. Për të konstruktuar dhe organizuar shqipëtarët në kryengritje kundër pushtuesve u krijua një forcë e re politike e dalë nga populli. Kjo ishte “Partia Komuniste” me lidhje të ngushta ideologjike me Moskën. “Hoxha i Madh” këto zhvillime politike i ndiqte me skepticizëm, pasi siç thoshte ai, nuk mund të presësh asgjë të mirë nga rusët e serbët.

Organizimi dhe mobilizimi nga ana e partisë komuniste me forca ushtarake vullnetare, siç shkruante ndër të tjera lord J.Emeri, nuk la jashtë vëmendjes as Dibrën. Haxhi Lleshi, një figurë mjaft e njohur dhe një drejtues i spikatur, u pa si komandanti që mund të koordinonte më mirë situatën politike me atë në terren. Lleshi, në verën e vitit 1944, organizoi një kuvend në Kovashicë me pjesëmarrjen e mëse 300 burrave, ku ndër të tjera në fjalën e tij thoshte se “lufta ka si qëllim të ndërtojë një shoqëri ku njerëzit të jenë të barabartë, të jenë njësoj, ku nuk do të ketë dallime midis tyre. Të gjithë do të shkojnë përpara të kapur dorë për dorë. Prandaj na i jepni djemtë që t’i bashkohen luftës sonë fitimtare që ta shpejtojë fitoren”. Më pas iu drejtua Hoxhës: Si thua ti hoxhë?

Hoxha me intuitën e tij, siç tregohej edhe nga një fshatar i quajtur Ali Jani prej Topojani, prezent në kuvend, i thotë se nuk mund të jemi kurrë të barabartë, pasi ti, kur të fitosh luftën, do shkosh në Tiranë në ndonjë post të lartë, e unë do rri sërish këtu në fshat të bëj punën e hoxhës. Ndërsa ndonjë njeri tjetër, i thjeshtë, që është bujk, do të merret sërish me punën e bujqësisë në tokat e tij.

Thelbin e socializmit, për të cilin bëhej zhurmë e madhe propagandistike, si shoqëri që do të sillte bollëkun, Hoxha e shpjegonte me dy fjalë: “Do të vijë një kohë, kur buka do të hyjë në dollap, dhe njëherë ta jep, njëherë s’ta jep”.

Hoxha e këndonte mevludin gjithmonë në shqip.

“Feja do të shkojë deri në fije të penit për t’u këput dhe pastaj do të ringjallet përsëri”, thoshte ai.



FOTO EDMOND HASANI

Nga **A.ASHIKU**

Në fjalorin toponomastik të HEC-eve del një emër i përveçëm “KATUNDI I RI”. Mendohej ta gjej e megjulla më pengon...

Mjegull mbi Luginën e Drinit të Zi, megjull e dendur nga Gjorica në Skavicë. Nuk është megjulla e zakonshme që zbret nga qielli, është megjulla e zezë e politikës shqiptare që nuk lëviz... Tash afro katër dekada që flitet për një gjol të madh, gjol që do të japë (sipas pushtetarëve) ujë dhe dritë nga njëra anë dhe (sipas qytetarëve) zhbërje e zhdukje të një krahine me zë të përveçëm në historinë e në ekonominë e Shqipërisë. Fjala është për hidrocentralin e Skavicës dhe mbytjen e Dibrës, studiuar e nxjerrë në skenë nga qeveria komuniste por pezulluar për në “kalendat greke” për shkaqe që nuk janë dhënë dhe nuk jepen... Dhe jo se ajo kohë nuk ndërtonte një “Dibër të Re”, siç ndërtoi një “Ulzë të Re”, një “Kukës të Ri”, një Derëzezë të Re” në bregdetin e Semanit. Dibrës i përmbajtej nga HEC-i i Skavicës 65 kilometra katrore tokë dhe 40 mijë banorëve u duhej gjetur troje e strehë...

Fjala është për pazaret e Fatos Nanos, Sali Berishës dhe Edi Ramës zgjuar në vitin 2005 e mbajtur në megjull në vazhdimësi për një dekadë të tërë. Qeveria komuniste e projektoi digën e Skavicës në lartësinë 485 metra me pasqyrë ujore që mbyste jo vetëm tërë Luginën e Drinit të Zi përfshirë edhe Gjoricën e Poshtme dhe Zallin e Shupenzës por edhe bërrakat e disa fshatrave shqiptare në anën tjetër të kufirit shqiptaro-shqiptar nën Maqedoni.

Qeverisë Berisha iu dhëmb “mbytja e bërrakave” tej kufirit shqiptaro-shqiptar nën Maqedoni dhe pas “uljes” së digës së Skavicës në 445 metra (që mbyste Dibrën por jo tokat shqiptare nën Maqedoni) kaloi në një tjetër variant, në idenë e “tre digave”, çka në krahasim me idenë fillestare jo vetëm e mbyste tërë Luginën e Drinit të Zi por, duke marrë inertet në dy pikat e tjera shkatërronte në mënyrën më të pandreqshme natyrën në pikat e ndërtimit të dy digave të reja, digës së Arrasit dhe digës së Luznisë.

Tash e ka fjalën Qeveria Rama, “Rilindja”, siç i thonë me përkëdhelje, e cila në vend që ta rilindë Dibrën me “Rrugën e Arbrit” e zhyt dhe e mbyt atë përgjithmonë me “Katundin e Ri”.

Por çfarë është ky emër dhe ku bie ky katund? Përpara se të hamendësojmë gjeografikisht le tu referohemi fjalëve dhe vendimeve tashmë edhe në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Shqipërisë të nxjerrë nga “mjegulla” që mbulon Luginën e Drinit të Zi.

“Qeveria shqiptare i ka akorduar më 23 dhjetor 2015 një bashkimi kompanish turke, “Suzer Group” dhe “Nurol Holding”, një bonus në masën 8 pikë për ndërtimin e një koncesioni të quajtur Katundi i Ri.

Vendimi i qeverisë nuk u publikua në faqen e saj zyrtare “kryeministria.al”, bashkë me vendimet e tjera të marra në të njëjtën mbledhje...

Vendimi i qeverisë u publikua më 7

janar 2015, në Fletoren Zyrtare pa relacion shoqërues, vetëm duke thënë se jepet bonusi “për ndërtimin e hidrocentralit “Katundi i Ri”, mbi lumin Drini i Zi, në kuotën maksimale të ujit, 445 m.m.n.d, në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë”.

Ende pa u dhënë lajmi nga qeveria shqiptare, kompania turke Suzer publikoi në faqen e saj të internetit lajmin se hidrocentrali i ri do të jetë me kapacitet 57 MW dhe pritet të kushtojë 110 milionë euro.

Kuotën 445 m.m.n.d. (metra mbi nivelin e detit) e gjejmë në variantin numër dy të digës së Skavicës, variant që nuk mbyt tokat në kufi me Maqedoninë por Katundi i Ri, emër i përveçëm fshati në “Malin e Luznisë”, është shumë larg Skavicës.

Në megjullën e hedhur nuk dallohet në se është fjala për një digë të re në ngushticën mbi Katundin e Ri të Luznisë në dy pikat trigonometrike të kodrave të Dohoshishtit dhe Hoteshtit apo për një emërtim të ri të Skavicës !!!Nëse është fjala për digën mbi Katundin e Ri, digë pikërisht pak metra mbi urën e re që lidh Peshkopinë me Luzninë atëherë (shih fotografinë) shteti duhet të japë shpjegime të reja.

Profesor Edmond Pinguli, një ndër projektuesit e Hidrocentraleve të mëdhenj të vendit, disa vite më parë kur u rihodh ideja e ndërtimit të Skavicës flet për një fuqi rreth 350 MW e për një ujëmbledhës me kapacitet rreth 6-6.5 miliard metro kub ujë në një digë 190-220 metro të lartë.

Profesori thotë se pas 23 vjetësh (nga viti 1985) pata rastin të takohem me njërin nga pronarët (Geoteknika të Romës) dhe të diskutojmë për këtë hidrocentral. Projekti parashikonte një digë 160 metra të lartë, salla e turbinave futej 30 metra poshtë, duke realizuar idenë tonë të parë me digë 190 metra të lartë. Ky variant mbyste 62 kilometra katrorë tokë dhe s’postonte 40 mijë banorë... Nga ballafaqimi i të dhënave zyrtare shtetërore ku flitet për një “hidrocentral të ri me kapacitet 57 MW” krahasuar 350 MW që thotë profesor Pinguli del se nuk kemi të bëjmë me Skavicën por me Katundin e Ri të Luznisë, mbase atë që njoh unë matur me hapa viteve të shkuara e që ruaj shumë kujtime.

Opozita e cila dje deklaronte se do ta ndërtonte hidrocentralin e Skavicës, madje edhe me “forcat e veta” është ngritur në këmbë jo për mos ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës dhe mbrojtjen e Dibrës nga gjoli i megjullt por për sloganin e njohur ...afera korruptive.

Në kushtet e mungesës së transparencës, qeveria lë të kuptohet se modeli i shfrytëzimit të pjesës së sipërme të kaskadës së Drinit ka ndryshuar dhe se hidrocentrali nuk do të quhet më Skavicë, por do të quhet Katund i Ri. Mbetet e pasqaruar se si do të funksionojë ky koncesion në kuadër të projektit origjinal si hidrocentral strategjik dhe nuk dihet se sa energji pritet të prodhohet dhe se çfarë efekti do të ketë në pjesën tjetër të kaskadës.

Mjegulla vazhdon të shtohet e ngjyra e saj sa vjen e nxihet si retë në furtunë.

Por le ti hedhim një sy fluturimthi vendndodhjes dhe vend ndërtimit të digës në ngushticën e Katundit të Ri, saktësisht midis dy kodrave prona të Dohoshishtit nga njëra anë e të Hoteshtit nga ana tjetër, kodra me përbërje argjilore që do të jenë bazë e digës së bashku me inertet e tjerë që do të gërryhen duke e shndërruar deltën e gjerë që hapet duke krijuar tokën më pjellore të Dibrës në ultësirën midis fshatrave Katund i Ri, Cetush, Ushtelencë e Brezhdan. Nën ujë, mbytur përgjithnjë i bie të jenë tokat në ultësirën e Drinit të fshatrave Hotesht, Selane, Dohoshisht, Pejke, Dovolan, Topajan, Shupenzë, Gjoricë e Poshtme...

Kulla e Murre, e njohur në histori për kuvendet dhe bëmat në betejat heroike të dibranëve kundër pushtuesve otomanë dhe serbë mbytet, megjithëse atë e kanë shuar në themele indiferenca një çerek shekullorë e viteve të fundit. (Shih fotografinë).

Kalaja e Grazhdanit, e vetmja qendër arkeologjike ku kazma dhe furça e arkeologut ka qenë e pranishme modestish në “bedena” mbetet në breg të liqenit por në thellësi, në katakombet e mundshme mbetet e mbytur.

Gjorica ku është zhvilluar një ndër dy betejat më të mëdha historike të popullit të Dibrës (kundër Hajredin Pashës dhe Hysni Pashës) zhytet duke u mbytur përgjithmonë krenaria dibrane... Unë nuk jam historian, nuk jam arkeolog, nuk jam gjeolog, nuk jam hidrolog... Studioj për të krijuar vizionin tim për probleme të caktuara. Ajo që dua dhe e kërkoj si gazetar dhe si Dibran i kërkoj shtetit tim me të drejtën kushtetuese si qytetar i Shqipërisë t’i mbledhë njerëzit e ditur të Dibrës, intelektualë të fushave të ndryshme, njerëz me emër të përveçëm në studime dhe ndihmesa cilësore për vlerat e Dibrës, madje edhe teologë e njerëz të artit e kulturës dhe tu hapë para syve projektet. Më pas debatin e zhvilluar ta hedhë në publik, të dëgjojë popullin edhe për një pëllëmbë tokë, edhe për një varr familjar. Në qoftë se nuk bindet ta hedhë në votim popullor. Populli pashait të mundur në betejën fitimtare të Gjoricës në vitin 1844 i ka kënduar...

Dibra ka ndërtuar Stambollin në kohë të largëta, ndërtoi veprat më të mëdha, hidrocentralet që nga ai i Selitës e deri tek ato mbi lumin Mat e Drin e Banjë. Vetëm Trebishti ka nxjerrë 11 heronj të punës. “Luanët e tuneleve” lindën dhe u rritën hidrocentraleve dhe veprave të mëdha an e kënd Shqipërisë. Dibra, po qe se bindet e ndërton edhe Skavicën n’dash me një digë, n’dash me dy apo tre diga. Ajo është shkrirë, djegur e përvëlur për Shqipërinë sa asnjë krahinë tjetër e vendit në beteja të mëdha kundër pushtuesve otomanë e serbë dhe Dibrën nuk e ka lëshuar pa gjak...

Dhe tash duan ta mbysin pa i dhënë të drejtën e “fjalës së fundit”.

Mbase ky është “ekzekutimi” unikal i denjë për “librin gines”...

traditë

Nga BEQIR AJET SHEHU

Beteja Legjendë e treqind nuseve me duvak të kuq dëshmohej edhe në ditët e sotme, si ngjarje e vërtetë historike, jo vetëm në kujtesën e banorve të krahinës Kala e Dodës, por edhe në krijimtarinë gojore dhe shkrimet e dhjetra studjuesve të krahinave Lumë e Diber në të gjithë pellgun e Drinit të Zi. Kjo ngjarje e pazakontë, tregohet me të njejtën rrjedhë zhvillimi, si në krijimtarinë gojore popullore edhe në studimet e shkrimet e kryera:

Një pasha turk me origjinë sërbe kishte ardhur në Kala të Dodës e cila ishte një nyje e rëndësishme e rrugëkalimeve nga Prizreni në Dibër e Tiranë dhe nga Shkupi në Gostivar, Mirditë e Shkodër. Rruga e Madhe, e cila kalonte në krahun e djathtë të Drinit të Zi e që vinte nga Prizreni për në Dibër e Tiranë ishte pothuaj nën ruajtjen e kontrollin e gjithëherëshëm të garnizoneve të pushtuesve turqë. Ndërsa rruga që vinte nga Shkupi, Gostivari, dhe nëpërmjet luginës së sipërme të Radikës kalonte në Qafë të Korabit dhe vinte në Kala të Dodës për të vazhduar nëpërmjet luginës së Lumit Mallë e për të dalur në Mirditë, Shkodër e Lezhë, përtej Urës së Dodës mbi Drinin e Zi, asnjëherë nuk është lënë nga malësorët e këtyre zonave, që të vihej nën kontrollin e ruajtjen e garnizoneve turke. Pasha turk me origjinë sërbe, të cilit emri nuk i thuhet, as në krijimtarinë gojore dhe në as në dokumente, për të realizuar vënjen nën kontroll të kësaj rruge dhe Krahinat e Maleve Shkreta të Lurës e Mirditës të cilat nuk u nënshtruan kurrë, sajoj një grackë, që të lidhte një miqësi me banorët e këtyre zonave duke kërkuar që t’i jepnin treqind vajza, nuse për zabitët (oficerët) e tij. Kjo ishte një fyerje e madhe për banorët e këtyre zonave, të cilët të mbledhur në kuvend, me sipërmarrjen e drejtuesit të këtij kuvendi Dogj Doda e Llesh Nikoll Doçi, vendosën t’i përgjigjen me dredhi pashës duke pranuar kërkesën e tij, por me kusht që t’u jepte kohë për gjetjen e 300 vajzave, nuset sipas zakonit do të shoqëroheshin nga 300 burra përcjellës, dhe qitja me armë, kur të dorzoheshin nuset, do të bëhej me fishekë të mbushur vetëm me barut, pa plumba. Pashaj, i pranoj kushtet e malësorve duke menduar se po fuste në dorë edhe “300 të pa fe”, përcjellësit e nuseve, që do të vinin të çarmatosur..

Ditën e dasmës, karvani i dasmorëve me 300 djem të veshur si nuse, nën duvakët e kuq të ngritur mbi tytat e martinave dhe 300 përcjellës të prirë nga Llesh Nikollë Marku arritën në kampin e pashës, në Kalanë e Dodës. Këtë dasëm betejë të pa dëgjuar në analet historike, madje edhe në ato botërore, krijuesi anonim e ka gdhendur në një këngë monument të cilën edhe kronikani më i aftë i betejave do të befasohej me informacionin e plotë deri në detaje dhe emocionet që japin vargjet e kesaj kënge.

Informacion enciklopedik marrim nga kjo “këngë dokument” në fushën e historisë, etnologjisë, toponimisë e onomastikës, por edhe për zakonet e traditat shqiptare, për organizimin tradicional vetëqeverisës të krahinave malore në Dibër e Lumë, për krijimtarinë gojore popullore dhe vlerat e sajë estetike, tepër fine dhe realiste, ku pasqyrohen edhe tiparet psikologjike të banorve të këtyre krahinave.

Në fushën e historisë, informacionin që marrim nga vargjet e kësaj kënge, kanë vlerat e një dokumenti shkencor, nga i cili marrim të verteta historike, për këtë dasëm legjendë,

Kënga e Betejës 300 duvakve, sqaron dhe dokumenton se kush qenë organizatorët dhe luftëtarët e kësaj beteje legjendë dhe kush e udhëhoqi atë.

Një këngë dokument për betejën legjendë “Dasëm me 300 nuse”

■ **Ditën e dasmës, karvani i dasmorëve me 300 djem të veshur si nuse, nën duvakët e kuq të ngritur mbi tytat e martinave dhe 300 përcjellës të prirë nga Llesh Nikollë Marku arritën në kampin e pashës, në Kalanë e Dodës. Këtë dasëm betejë të pa dëgjuar në analet historike, madje edhe në ato botërore, krijuesi anonim e ka gdhendur në një këngë monument të cilën edhe kronikani më i aftë i betejave do të befasohej me informacionin e plotë deri në detaje dhe emocionet që japin vargjet e kesaj kënge.**

sa nuk do ti mernim as nga një kronikë e shkruar ditën e betejës, madje edhe nga kronikani më i aftë, dhe i pa ndikuar.

Në vargjet e kësaj kënge, jepet edhe e vërteta historike se, ideator, organizator dhe komandant i kësaj beteje legjendë ishin Dogj Doda dhe Llesh Nikoll Doçi prej Lure, krahinë e cila në shekullin e XV-të së bashku me fshatrat e Reçit dhe të Kalasë Dodës ishin në zotrimet e Principatës së Dukagjinëve.

Le t’u referohemi disa pjesëve të kësaj kënge ku sqarohen probleme të cilat kanë qenë të paqarta dhe për të cilat është shkruar nga historian, shkrimtar e gazetar por që për vendin dhe kohën kur është zhvilluar kjo betejë, nuk kanë qenë të një mendimi.

-Së pari:-Nëpërmjet kësaj kënge vërtetohet edhe një herë se Dasma e 300 nuseve me duvakë, nuk është një legjendë e sajuar por një ngjarje e vërtetë historike, e cila dëshmohej edhe sot e kësaj dite jo vetëm në kujtesën e dhjetra banorve të këtyre krahinave, por që për të është shkruar edhe nga historian e shkrimtar, si Hazis Ndreu, Xhafer Martini, Nikoll Kola, Ismail Skeja, Shaqir Skarra etj. dhe nga të gjithë pranohet vërtetësia e kësaj beteje legjendë.

-Së dyti-Në këtë këngë, madje në dy rrjeshtat e parë të saj sqarohet, si e vërtetë shterruese, se beteja zhvillohet midis malësorëve shqiptarë, të krahinave Kala e Dodës, Lurës e Reçit të udhëhequr nga Llesh Nikoll Doçi, dhe forcave turke të komanduara nga një pasha turkë me origjinë sërbe, madje djali i mbretit të serbisë.

“Djali i kralit të Sërbisë
Kana ba pash i Turqisë”.

-Së treti –Ka mendime të ndryshme për vendin ku është zhvilluar beteja si nga Shaqir Skarra, që e çon në Çidhën, të tjerë nuk e përcaktojnë, nuk i paragjykoj se e bëjnë me qëllim, por diçka ka, pasi e gjithë gojtaria popullore, regjime, gojdhëna, këngë, si dhe historiani Hazis Ndreu, Xhemal Domi, Ismail Skeja, por edhe në vargjet e këngës që po ju paraqesë, Beteja e 300 duvakve të kuq është zhvilluar në Kala të Dodës.

“N’Kala t’Dodës ka dal pasha
Po kërkoka treçin vasha”.

-Së katërti:-Kënga e Betejës 300 duvakve, sqaron dhe dokumenton se kush qenë organizatorët dhe luftëtarët e kësaj beteje legjendë dhe kush e udhëhoqi atë.

Ç’aj Llesh Doçi e Dogj Doda
Kanë vendos n’kuven nër oda

Me t’pa besin, besë nuk ka

Dasëm t’madhe do t’bajmë n’Kala

Në këto vargje tregohet jo vetëm pozita shoqërore e Llesh Doçit e Dogj Dodës, si

prijës Kuvendesh, por edhe kapaciteti i tyre si mentar e organizator për të marrë përgjegjësinë e organizimit të një beteje të tillë që edhe për shtete ishte një ndërmarrje e vështirë. Në këto vargje duket edhe besimi i kuvendarve tek prijsit e tyre, besim i cili nuk mund të fitohej në çast. Besimi për të vënë nën komandën e tij 600 djem të ri që do të shkonin drejtë vdekjes mund t’i jepej vetëm një prijsi që kishte dhënë prova ndoshta edhe në disa breznë. Ky besim mund t’i jepej atij prijsi që askush nuk do ta shprehte më bukur se vargjet e kësaj kënge: “Ç’aj Llesh Doçi n’kal të zi / Para krushqëve u ka pri / Sa ka hi n’oborr t’ Kalasë / T’koft për hajr dasma or pashë”. Pra besimi ju dha jo vetëm një prijsi trim e organizator por edhe një strategu të mençur i cili pasi hyri me krushqit (600 luftëtarët e tij në Kala) dha kushtimin e fillimit të betejës, vrau pashën me zabitët dhe mori Kalanë, se po të fillonte betejën jashtë mureve të kalasë, me forcat që kishte, nuk mundë të hynte kurr në Kala

Informacion me vlera marrim nga vargjet e kësaj kënge edhe në fushën e etnologjisë dhe organizimin tradicional të malsorëve në kohën e zhvillimit të kësaj beteje.

“Janë mbledhë malet në kuven / Ky bidat s’asht pa n’kët’ven / Më mirë vdek në teh të shpatës / Se t’ japim cucat pashës”. Nga këto katër vargje informohemi për kuvendin i cili ishte institucioni më i lartë vetëadministrues i malësisë, ku lidhej besë dhe merreshin vendime për problemet më të rëndësishme që duhet të zgjidheshin, por njëkohësisht na informon se për malsorët e këtyre krahinave, zakonet e traditat e tyre i kishin të shenjtë dhe për mbrojtjen e tyre nuk kursenin as jetën.

Informacion në fushën e etnologjisë, jepet edhe për veshjet dhe armët që u përdorën, dhe nëpërmjet tyre përcaktojmë me përafërsi edhe kohën kur u zhvillua kjo betejë.

“Ditën e djelë tu dal drita / Treçin djem posi petrira / Veshë si nuse nër dullak / Mbushë martinat gishtin n’çark/Para u prinë Treçin dasmorë / Me bajrak si asht zakon / Vesh n’ tirç e koparane / N’brez topanxhë e jatagane”.

Duke e ditur se armët e zjarrit, martinat e topanxhat, në perandorinë turke filluan të përdoren në gjysmën e parë të shekullit pesëmbëdhjet mund të themi se kjo dasëm betejë u zhvillua rreth viteve 1630, kohë e cila është e përafërt me 13 breznitë pasardhëse të Llesh Nikoll Doçit.

Edhe një dukuri interesante që nuk mund ti shpëtoj syrit të një studjuesi. Duvakun e kuq me kunjë, e përdorin vajzat kur dalin nuse, vetëm në Bajrakun e Lurës, ndërsa

në krahinat tjera të Dibrës e Lumës, duvaku kishte formën e thesit. Ky dallim thuhet se është ruajtur në kujtim të treqind luftëtarëve, të veshur si nuse, për të maskuar fytyrat e tyre dhe armët. Ata vendosën duvakët e kuq në tytat e martinave dhe udhëtuan për në Kala të Dodës ku u zhvillua beteja legjendë të cilën e udhëhoqi kreshniku Llesh Nikoll Doçi.

Kënga e betejës legjendë “Dasëm me 300 nuse”.

Gjali i kralit të sërbisë
Kana ba pashë i turqisë
Nji mallkim ka n’gju ka baba
N’Kala tëDodës mos bift as shtara

N’Kala Dodës ka dal pasha
Po kërkoka treçin vasha
Treçin vasha për zabit
Për mahi e jo për mik.

Ashtë mbledh dheu në kuven
Ki bidat s’ashtë pa n’kët’ ven’
Ma mirë vdek n’teh të shpatës
Se ti japim cucat pashës.

Ç’ai Llesh Doçi e Dogjan Doda
Kanë venos n’kuven nër oda.
Me t’pabesët, besë nuk ka
Dasëm t’madhe do t’bajmë n’Kala.

Ditën e dielë te dal drita
Treçin gjem posi petrira
Vesh si nuse, nër dullak
Mbush martinat, gishtin n’çark

Para u prinë treçin dasmor
Me bajrak si asht zakon
Vesh në tirç e koporane
N’brez topanxha e jatagane

Pasha turk asgan mbi kal
Me prit krushqit paska dal
Rreshton gardën në oborr
Banë donamë me pluma qorr:

Këta zabitët mbi atllarë
Për bri pashës rradh’e rradh’
Salltanet e plot nishana
Presin nuset posi zana

Krejt nizami ka dal n’kodër
Gjamë e madhe, pushk’ e lodër
Shpatën n’dorë, pasha po pret
Krejtë do të vdisni more të shkretë

Ç’ai Llesh Doçi n’kal të zi
Para krushqëve u ka pri
Kur ka hi n’oborr t’kalasë
T’koft për hajr dasma or pashë

Jep kushtimin si vetima
Flak’ topanxha e flak’ martina
Grykë e n’gryke, shpatë e thikë
U pre pasha me gjith zabit.

Kjo këngë e kënduar nga Xhumali Kadri Lusha dhe Hysen Mehmet Terziu, shoqëruar me fejt të gjatë shkupi nga Daut Ali Shehu dhe Jakup Mus Shehu, është mbledhur nga Beqir Ajë Shehu në dasmën e Faik Mehmet Shehut në shtator 1962.

Fajli

Nga **HAJRI SHEHU**

Edhe sot, si para tridhjetë vjetësh, e kam mu përpara syve portretin e nanës Zanë: e hequr në fytyrë, me hundë të drejtë, me mollëza pak të ngritura, me shaminë, bardhë si bora, lidhur poshtë gushës. Kishte një të folur të ëmbël, sikur nxirte tambël prej goje. Kisha shkuar në atë fshat për të mbledhur fjalë e shprehje popullore. Ishte de-tyrë pune. Është shumë e vërtetë, që ajo që nuk është shkruar ende nëpër libra e fjalorë, gjendet e rron në popull. Populli e ka ruajtur dhe e ka kultivuar fjalën shqipe dhe ne veç marrim nga ai, siç marrim një frutë nga dega e pemës.

Me këtë mendje shkova aty ku më patën rekomanduar, te nana Zana. “Ajo di fjalë të vjetra”, - më thanë gjithë siguri. Deri në oborrin e saj më shoqëroi mësuesi i gjuhës së shkollës 8 - vjeçare të fshatit. “Tashti, ja ku e ke nanën Zanë, pyete për çdo gjë se të dëfton sa të mbushësh një bllok të madh”, - tha ai e bëri të largohej. Nana Zanë iu lut të rrinte për një kafe, por ai e kishte të pamundur.

Pasi më pyeti e më kundroi, nana Zana mori xhezven të bënte kafe për mua. Por mua m’u dhimbs për mundimin që do të bënte dhe aty për aty sajova se vuaja nga trysnia e lartë e gjakut e kafja më bënte dëm. Mirëpo nana Zanë ishte e zgjuar, ajo ta blinte fjalën pa e nxjerrë ende nga goja. “Më kanë ardhë para do vjetësh si ti dy burra e një grue, i pastë nana me ymër”, - nisi të fliste. “Bana t’u qes kafe, - vijoi ajo më tej, - më thanë se kishin pi në një vend tjetër. Bana t’u qes nga një bardak tambël, më thanë “ju faleminderit, po nuk ka nevojë” (fjalën “faleminderit” e tha në gjuhën letrare, siç e kishin shqiptuar ata burrat). Po, pak mana?, - u thashë. Manin e kisha në baçe e mund ta shkundnin vetë. Prapë më thanë se s’ishte nevoja. Atëherë, s’m’u ndej pa u thanë: “Kafe, jo; tambël, jo; mana, jo. Po, na kafe e tambël u qesim njerzve, mor u pastë nana; bar e kashtë qeve. Nuk e përmenda fjalën lopë se s’dojsha me e nga gruen; burrat, po; ata e dojshin ngasjen; e kishin hak. S’e di a kam ba gabim, mor bir, - m’u kthye mua, - se miku nuk vrugohet në shtëpi”. Dhe për ta plotësuar më tej mendimin e saj të hollë, shtoi: “Se miku asht si shishja e llambës. Po u thye, bile po u



Pikturë nga © Zaim Elezi

kris shishja, llamba nuk asht ma llambë”. Natyrisht, unë e pashë veten në siklet: romuzi, shpotia ishte për mua; e meritoja plotësisht. Sidoqoftë, ashtu si fshehtas, shkrova në fletoren time kuptimin e figurshëm të fjalës “vrugoj”. Them fshehtas sepse ajo mund të stepej, po të më shihte se mbaja shënime: “Pse po shkruen ky? A mos po thom ndonji gja që s’duhet me e thanë?”.

Pas kësaj njohjeje e bisede të parë, i thashë: Kam ardhur t’ju pyes për fjalë të vjetra, për shembull, për fjalë që kanë të bëjnë me punimin e bulmetit, veshjet, gatesat që bëni ju etj. “Çare (= çfarë) të di nana, do t’ta thotë, - m’u përgjigj me zë të plotë. Ishte, vërtet gatishmëri për të më ndihmuar, por edhe kulturë e sjellje dinjitare. Ajo nuk e bëri “shakanë” e një plaku në një katund tjetër, i cili më pati thënë: “Po ti po s’dite ene (= edhe) si punohet toka, çar shkolle paske ba?!”.

Vërtet, siç më patën thënë, nana Zanë ishte mendare. Ajo e kuptoi fare mirë qëllimin e edhe llojin e punës sime dhe herë pas here do të më thoshte: “A e shkrujte këtë (= këtë)? A don ta shkrujsh ene këtë? (dhe thoshte fjalën). Shkruje ene këtë!” Tashmë, ne ishim, vërtet dy veta që kryenin një punë të përbashkët. Ishim bashkatarë. Dhe, unë çova në Institutin e Gjuhësisë dy fletore të mëdha me fjalët e nanës Zanë. Ky është një kapitull. Kapitulli tjetër është jeta e nanës Zanë. Ajo ka shumë nënkapituj. Do të them vetëm njërin.

Nana Zanë ishte martuar si të gjitha cucat e katundit. Me kalë të bardhë

kishte mbërritur në kurtin e shtëpisë së ardhshme. Ishin shtënë edhe pushkë. (Pushkë shtiheshin kur nusja dukej se hynte në katund). Nusja ishte e bukur, zanë mali, siç kishte emnin, - kishin thënë gratë e vajzat atë ditë. Por jeta, si jeta. Me të mira e me të pamira. Me gëzime e me brenga. Njerëzit thonë: Halli hallit nuk i ngjan. Kështu është, vërtet. Nusja Zanë, gruaja Zanë, nana Zanë kishte pasur halle përmbi halle. Kishte lindur jo pak fëmijë. Fëmijët, njëri pas tjetrit rriteshin si të zbehtë. Shkonin si fëmijët e tjerë të fshatit në shkollë. Luanin si fëmijët e fshatit. Shkonin në kohën e lirë, si fëmijët e tjerë me lopë a me vjeta. Por, kur bëheshin aty tek trembëdhjetëvjeçët, zbehtësia bëhej fatale. Ata nuk e kalonin moshën më tej se trembëdhjetë! I merrte në gjirin e saj ajo toka e zezë. Nana Zanë lind e ajo toka e zezë merr. Tetë fëmijë lindur e asnjë në vatër. Një heroinë e vërtetë. Por një heroinë pa asnjë fitore.

Tani, ajo ishte fillikat vetëm. Më në fund, kishte përcjellë edhe të shoqin – një njeri fjalëmirë e besëmirë.

Po ta dëgjoje nanën Zanë, të rrëqethej mishi. Më mirë që nuk e keni dëgjuar ju. Më mirë që nuk ia keni parë ata lotët që i rrokulliseshin si kokrra breshri deri në mjekër. Ankth nane. Ankth njeriu. Ankth që shtohet për vitet që vinin, kur duhej të ndodhte e kundërta – të shtohet gëzimi për fëmijën që madhohej një vit, dy, tre ... A thue, bre, ky do të bahet?, - ofshante e shpresonte nana Zanë. A thue, bre, ky do të rritet? A thue, bre, do ta shoh nana

dhandër këtë? A thue do ta përcjell nana nuse këtë? A thue ...! A thue ...? A thue...? Por vinte vetëm gjëma. Po, si? Po, përse? Po përse, vallë? Se s’kishte ditur t’i rriste? Jo. Ajo kishte ditur t’ua bënte të gjitha ato që bën një nënë e një amvisë e mirë e më shumë se kaq. Po çfarë, atëherë ...? Ajo s’kishte ditur vetëm një gjë – atë që duhet ta kishte ditur e t’ia kishte thënë shoqëria, - në kuptimin më të gjerë të fjalës: mjeku, por edhe mësuesja, fqinja, dikush që e njihte shkakun a që e vriste mendjen për ta gjetur shkakun, një njeri kushdo, një njeri që e kishte dëgjuar ndodhinë e atyre fëmijëve, një njeri që lindte e rriste vetë fëmijë. Le të ishte edhe larg. Kudo që të ishte. Në fund të fundit, le t’u shkonte ndër mend njerëzve dhe t’i thoshin nanës Zanë qoftë edhe një fjalë dyshimtare a gjysmë fjale dyshimtare, a këshillë, a urdhër, që ajo të travizej, të lëvizte, të shkonte te mjeku, të vërtetë-sonte diçka, të korrigjonte diçka, të gjente rrugën e zgjidhjes. Faji. Faji i madh. Dhe ...? Dhe fëmijët e nanës Zanë s’u bënë dot rreze dielli në mëngjes. Dhe nana Zanë mbeti vetmitare.

Atëherë, kur u kuptua e kur u përshpërit, ishte tepër vonë. Sepse koha është armiku më i egër i njeriut. Koha të mposht, po nuk e mposhte.

Epilog

Nana Zanë nuk la fëmijë, por ka lënë margaritarë në Fjalorin e gjuhës shqipe. Ato janë fjalët e saj e dija e saj. Ato janë për të gjithë ne, siç do të ishin fëmijët e saj - për të, por edhe për ne.

Lura - perla e Europës, testament për vendlindjen

Nga MEVLUD BUCI


Pas ristudimit të librit “Lura – perla e Europës” të publicistit e studiuesit Gëzim Loka secili lexues vihet në meditim, duke analizuar e duke njohur ato ç’ka shkruan e analizon autori. Libra të tillë e themi pa mëdyshje se janë një vlerë e çmuar për vendlindjen, për atdhetarizmin e brezave, janë një testament fisnikërie. Vetë titulli mjaft i spikatur të tërheq si me magnet si i thotë për t’u njohur me materialet ose më mirë me perlat e historisë, të urtësisë, të atdhetarisë, e të bukurisë që ka treva e nderuar e Lurës kreshnike.

Edhe pse për Lurën është shkruar, na janë pasqyruar traditat, natyra, madhështia e forcës dhe e bukurisë së karareve, figura e ngjarje, fise si dhe folklori i pasur, urtësia e brezave, libri i autorit Loka, jo vetëm që i rrok këto tema, por na paraqet plot dukuri të reja, mesazhe, përshkrime, studime me vlerë, analiza, këndvështrime, të cilat dëshmojnë përkushtimin prej krijuesi, ushtaraku e intelektualit misionar e vizionar që lartëson me realizëm, qartësi e mjeshtri prej publicisti, traditat e kryera të vendlindjes, të brezave, të fisit të nderuar. Loka na paraqet shenja të qytetërimit ilir në Lurë, prejardhjen e toponimit “Lurë” dhe të disa fshatrave të Lurës, Lurës si toka e bekuar që priti mbretër e perandorë, vështrimin panoramik, për bukuritë e fjetura të Lurës, florën e faunën unike të saj e plot shkrime e studime si dhe krijimtari zemre, të cilat e bëjnë këtë libër tërheqës, me mjaft të çmuar për lexuesit në përgjithësi e çdo studiues e krijues në veçanti.

“Autori i këtij libri – shkruan midis të tjerash në përcjellje avokat Serxho Mazreku, ka ditur të gërshetojë bukur harmoninë e natyrës luriane me ritet dhe traditat e pasura, historinë me përditshmërinë, shpalosjen e bukurive të virgjëra, me problematikat sociale, që e mbajnë peng mundësimin e një zhvillimi të hovshëm turistik të Lurës... (f. 6).

Përmbajtja e këtij libri, shkrimet e krijimtaria në të na tregojnë thesaret e traditave luriane, na pasqyrojnë thjeshtë e qartë historinë, Lurën si amfiteatër natyral turizmi e sporti, Lurën e mundësive përrallore apo Lura e pamundur, rrugën në nderim të Imzot Nikollë Kaçorri, fletë lavdie në analet e historisë (pavarësisë), Lura në analet e qëndresës legjendare kundër serbëve, martirët e kohës së Nemces, Lura, streha e Fan Nolit dhe uragani i revolucionit demokratik të qershorit vërtet një thesar me vlerë, një arkiv konkret ku shpërfaqet Lura nëpër kohëra, atdhetarizmi i brezave, gjurmët e trimërisë e të mençurisë, rrezatimi i kryeqendër e vëllazërimit.

Autori Gëzim Loka me këtë libër nuk i bën nder vetëm Lurës e brezave të saj, por gjithë Dibrës, kombit dhe traditave të shquara që gjejnë pasqyrim qysh në lashtësi e deri në epokën tonë. “Lura – shkruan autori Loka midis të tjerash në vend të hyrjes, - ka qenë dhe mbetet Itaka ime, Toka e Premtuar, Edeni i fillësës së mallit, dashurisë së parë, dhimbjes filozofike e mbresa jetësore, oda ku dëgjova mençuritë e rralla të dala nga goja e burrave të sertë e krenarë, kuvendet e të cilëve do t’i kishin zili edhe parlamentet e senatet me përvojë



Gëzim Loka
Lura, Perla e Europës
Publicistikë
letraro-historike
ISBN: 978-9928-20-607-7
Çmimi: 500 lekë

■ **“Lura – shkruan autori Loka midis të tjerash në vend të hyrjes, - ka qenë dhe mbetet Itaka ime, Toka e Premtuar, Edeni i fillësës së mallit, dashurisë së parë, dhimbjes plotësimet me bagazhe filozofike e mbresa jetësore, oda ku dëgjova mençuritë e rralla të dala nga goja e burrave të sertë e krenarë, kuvendet e të cilëve do t’i kishin zili edhe parlamentet e senatet me përvojë mijëvjeçare të botës së qytetëruar...”**

mijëvjeçare të botës së qytetëruar...” (f. 7). Autori Loka shkruan me realizëm, trajton e analizon ngjarje, ngre probleme si dhe aludon me qartësi duke bërë që lexuesi e çdo studiues të mësojë gjëra të reja, të njohë ende më shumë Lurën e lurianët, provat në histori, madhështinë e traditave, karareve, vajtimeve, gjurmët e luftërave, arsimit, kulturës e plot të tjera.

“Në gardën e Skënderbeut – shkruan autori Loka, - kishte disa lurianë të cilët kishte një besim të patundur, kryetrimi legjendar çmonte tek lurianët guximin, trimërinë, fjalëmbajtjen dhe krenarinë, cilësi kjo e fundit e dëshmuar dhe nga shumë studiues të huaj dhe që nuk i linte ata të binin në pozitat e tradhtisë e të bukëshkeljes...” (f. 53).

Publicisti e studiuesi Loka ka vëzhguar me syrin e ushtarakët, me mprehtësi e realizëm ngjarjet, problemet, traditat, figurat e historisë, epopetë e luftërave qëndrestare, luftëtarët patriotike dhe atë të epopesë së lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Meritë e veçantë është se Gëzim Loka shkruan të vërtetat, larg ngjyrave partiake e ekstremiste, të cilat siç jemi dëshmitarë kanë

deformuar jo pak historinë. Brezat janë si gurët e latuar e të çmuar të kullave shekullore, ku çdo gurë ka rëndësi në murin e tyre. Shkrimet për Heroin e Popullit Haxhi Lleshi, për Heroin e Popullit Gjok Doçi, shkrimet se çfarë është thënë e shkruar për Lurën, kararet e Lurës, kodi kushtetues i qeverisjes luriane, tre të papriturat e Lurës:

(E papritura e parë, në Lurë, - thotë autori, - sikur takohen toka me qiellin, malet kurorëlarta me horizontin, duke përcjellë një natyrë befasuese..., e papritura e dytë është mikpritja. Të gjithë shqiptarët janë mikpritës, aq sa shkrimtari ynë i shquar Ismail Kadare, me të drejtë thotë se shqiptari ka shpikur dhe i falet një perëndie të re, mikut. Por të jesh mik në Lurë, vërtet e kupton se çfarë vlere ka mikpritja...

E papritura e tretë është dendësia e ngjarjeve dhe figurave historike. Lura nxori nga gjiri i vet një klerik dhe intelektual të rangut të lartë, Dom Nikoll Kaçorrin... në kohën e Luftës së Madhe nxori Gjok Doçin, Hero i Popullit, që u sakrifiku në altarin e shenjtë, të lirisë kombëtare e shoqërore... (f. 116-117). Në librin “Lura – perla e Eu-

ropës”, pasqyrohet vlere e rrallë, kultura e vyer luriane, traditat ku përshkruhen vajtimi e vajtimeoret.

“Vajtimeoret e Lurës, - shkruhet në libër, - nuk janë thjesht disa gra që vajtojnë në ceremonialin e vdekjes, por një lloj institucioni legjitim i shpirtit të pasur lurian, që di të vlerësojë jetën dhe vdekjen, pasi vlerësimi i vdekjes në thelb është vlerësimi i vetë jetës njerëzore (119). Autori Loka me korrektësi, realizëm, e dashuri ka përshkruar arsimin e kulturën, ka gdhendur emra të nderuar mësuesish, drejtorësh, veprimtarë e artistë të talentuar, ka përshkruar me stilin mjeshtëror e origjinal shëmbëllimin e tyre nëpër vite, ka pasqyruar shkrime interesante e me plot ide si “Tre sugjerime për lurianët dhe një për jo lurianët e të huajt”, “Filozofia ime për jetën, për punën, tranzicionin, familjen, pensionin, “Tranzicioni – thikë pas shpine ndaj shqiptarëve”, përbëjnë një tablo të re me vlerë në këtë libër. Intervistat me autorin Gëzim Loka, shkrimi i gazetarit e studiuesit të talentuar Dukagjin Hata kushtuar luftëtarit të lirisë Dulejman Loka, poezitë e krijuara me frymëzim e mjeshtri nga autori Loka, pasqyrimi i fisit Loka, një histori e shkurtër gjer në ditët tona, përshtypjet si Kiço Mustaqi, Kostaq Karolli, Sheme Kosova, Zaho Jaho, Zyhdi Kroj, Sofokli Bushi, Ferit Fixha, Skënder Hasmeta, Ylli Bulku, Vladimir Çuni, Mehmet Bazaj, Ramazan Fida, Ramadan Mishka, të cilët i gdhend autori si pasqyrimi i 60 vjetëve jetë në 40 vite punë dhe 40 vjet ditar ku pasqyrohen mendime e vlerësime të çmuara për komandant, gjeneral e babë Gëzim Lokën, siç e saktësojnë shokët bëjnë që libri “Lura – perla e Europës”, të rrezatojë me bukurinë e natyrës së kësaj treve dhe në anonimi na mëson sesi të ecet përpara, ecet drejt Europës kur lartësojmë e çmojmë traditat e brezave tanë, vendlindjen dhe kombin tonë. Ky libër i autorit të mirënjohur Gëzim Loka është vërtet testament e krenari legjitime për vendlindjen dhe atdhetarinë e brezave. Si thirrje zemre, si këngë shpirti e përgjërimi hyjnor në pjesën e fundit ku autori Loka shpërfaq talentin poetik shkruan:

... Lura ime, Lurë e bukur
Perlë hijeshie, s’të harroj kurrë
Isha fëmijë, me ty u rinova
Dashuria jote më bëri burrë...
("Lura ime" f. 148)

Poeti Loka gdhend vargje zemre e çiltërsie edhe për Lurën e vjetër, Arrë-Mallën, Fushë-Lurën, Gurë-Lurën, Preq-Lurën, Vlashajn, Borie-Lurën, Krej-Lurën, vijon me plot frymëzim poezitë “Gjurmët e një ushtaraku”, “Tim eti” (f. 154), “fëmijëve të mi”, “Tranzicioni”, “Mbesës sime një vjeç e gjysmë Rea”, nipave Nikut e Landit kushërinjë, shokëve dhe Mokrës. Vargje njerëzore, vargje himn për njerëzit, jetën, vlerat, vendlindjen, kohërat e brezat. Libër ku pasqyrohet treva luriane, bota, jeta e drejta e shpirtit, vëllazërimi e bashkëjetesa, urtësia e kararet, luftërat e arsimimi, kultura dhe talenti krijues prej intelektualit, ushtaraku, publicisti e studiuesi pendëdritë, shpirtëdëlirë e ballëdjersitur i mëkuar me dashuri për familjen, fisin, Lurën, Dibrën, kombin dhe llogoret e tokës arbërore. Urime Gëzim Loka, penda të hijeshoftë e rrezatoftë, si vetë bukuritë e mahnitshme të Lurës, si vetë tri të papriturat e kësaj treve hyjnore të kombit tonë!

Homazh për një njeri të madh të publicistikës shqiptare dhe një Dibran me shpirt e me zemër...

Qamil Dervishi, një veprimtar shoqëror që kujtohet me respekt

Populli i fshatit Gërman në rrethin e Matit, në vijimësi shekullore, ka lindur, rritur dhe edukuar bij të tij të mençur, atdhetarë, që gjatë jetës kanë bërë emër, kanë dhënë kontribute të rëndësishme si dhe kanë bërë sakrifica sublimie për interesat e mbarë shoqërisë. Ndër këto bij, bën pjesë edhe Qamil Dervishi.

U lind me 4 prill 1940, në një familje me tradita të atdhetare, punetore, mikpritëse e bujare. Babai, Daliu, dhe e ëma, Fatimja, për rritjen dhe edukimin e Qamilit treguan kujdes të veçantë, si më i madhi i fëmijëve të tyre, Hazizit dhe Nailës për t’iu bërë krah në punë e në jetë. Gjermani, duke qenë pjesë e bajrakut të Rrënxës, kërkonte që bijtë e tij të ishin dhe të sjellshëm e të shëndetshëm, por edhe të zotë në punë, të guximshëm e trima duke iu sjellë në mendjen dhe ndërgjegjen e tyre, ato veti e cilësi të larta, si besnikë, me moral të lartë, të guximshëm e trima, mikpritës e bujarë si dhe njeriu humanë, cilësi që i fitoi edhe Qamili, që në moshë fare të vogël.

Pasi mbaroi mësimet në shkollën fillore e atë shtatëvjeçare në vitin 1953, nisi mësimet në shkollën e mesme pedagogjike në Tiranë, të cilën e përfundoi me rezultate shumë të mira në vitin 1957, ku fitoi profesionin e mësuesit. Fillimisht emërohet mësues në shkollën e mesme të Derjanit dhe më pas vijoi punën në disa shkollë të tjera, si në Xibër Hane e Xibër Murrize, ku më pas mobilizohet ushtarë (1966-1969), kohë dhe detyrë kjo që i shërbeu si një shkollë e dytë, e cila ndikoi fuqishëm në edukimin e tij. Gjatë kësaj kohe në ushtri, i rregjistruar qysh më parë, përfundoi edhe studimet e larta në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi, që e kishte me shumë pasion.

Pas përfundimit të ushtrisë punoi si mësues në disa shkolla të rrethit, si në Karicë, German, Rrethe Baz, Kodërçerre e tjerë. Në vitin 1980 emërohet përgjegjës i Shtëpisë së Kulturës në Komsë, ku punoi deri në vitin 1984. Ai me punën e tij organizuese e drejtuese të veprimtarisë kulturore artistike, në skenat lokale e kombëtare shpalosi vlerat folklorike të zonës së Germanit e më gjërë, ku dhe fitoi vlerësime të larta në nivel kombëtar.

Më pas, për katër vjet, për nevoja të nxjerrjes nga prapambetja emërohet kryetarë i kooperativës bujqësore të Komsisë.

Me dëshirën dhe kërkesën e tij, iu rikthye përsëri profesionit të mësuesit. Si një kuadër me pasion, përveç punës së mësuesisë, një kohë të madhe ia kushtonte leximit të librit, ku prioritet kishte letërsinë letrare e historike. Kjo i dha mundësinë të jetë një njohës i mirë i kësaj fushe dhe u angazhua në punën kërkimore – shkencore, duke marrë pjesë në simpoziume e sesione shkencore me studime të rëndësishme. Është hartuesi i historikut të fshatit të Gërmanit dhe të Komsisë. I lidhur ngushtë me persona me moshë të vjetër, me njohës të mirë të historisë, si me Dikë Gjokën, Hidër Lekën, Hamit Hoxhën, Dem Skejën e tjerë, bëri të mundur pasurimin me fakte të reja historinë e zonës së tij. Shpesh në odat matjane në raste gëzimi, fjala e Qamilit ngjiste shumë dhe i bëhej një rezervim i veçantë në marrjen e fjalës në këto mjedise. Gjatë kohës në punë, për cilësi e rendiment të lartë, për figurë të pastër moralo-politike dhe për kontribute të shumta e të rëndësishme është nderuar me Medaljen “Naim Frashëri” për kontribut me cilësi të lartë në fushën e edukimit të brezit të ri.

Si njeri i thjeshtë e i zgjuar, iu gjendej njerëzve, miqëve e shokëve pranë në gëzim e në hidhërimi duke fituar kështu dashurinë dhe respektin në gjirin e kolektivit ku punonte. Gatishmëria e madhe e tij për të ndihmuar njerëzit në nevojë e bënë këtë kuadër shumë të respektuar nga të gjithë. Origjina



Qamil Dervishi

e tij e familjes ku ishte lindur dhe atje ku ishte nip (tek Hamit dhe Sali Hoxha) i shërbeu Qamilit si një garanci më shumë, për të punuar më shumë dhe më mirë. Ai nuk qe vetëm një kuadër i mirë, por njëherazi ishte dhe një familjarë e prind shembullor. Me bashkëshorten e tij, Lulen, bijë kjo nga një derë e mirë, tek Mustafa Cakoni në Baz, lindën, rritën dhe edukuan 5 fëmijë, Ardianin, Fatosin, Fëllënxën, Albanën dhe Natashën, aktualisht të gjithë janë familjarë, kanë e po tregojnë vlera të larta nga cilësitë e kultivuara ndër vite nga babai i tyre, Qamili në krahinën e Matit dhe jo vetëm.

Vlerësimet e kolegëve të tij të punës e të jetës si Zenel Molla, Isuf Çollaku, Shaqir Gjoka, Sadik Hoxha, Tahir Ruspi, Tahir Doku, Sherif Barçi, Ismail Sadiku, Agim Sula vijnë si një buqetë lulësh midis nesh që e shfaqin Qamil Dervishin me të gjitha cilësitë e njeriut të mirë, të njeriut punëtorë, pasionant dhe i përkushtuar në punën me cilësi e rendiment të lartë të njeriut faktor e aktor me cilësitë e vetitë e kërkuara nga çdo anëtarë i shoqërisë tonë, i paisur gjithnjë dhe me ndjenjën e lartë të humanizmit, pra të njeriut të kompletuar për t’u marrë shembull nga të gjithë. Në tërësi këto vlerësime vijnë si një simbol i veçantë për gjirin e shoqërisë tonë.

Ai ishte dhe njeri i humorit që e mbante gjithmonë atë për çlodhjen e argëtimin e njerëzve.

Në vitin 2000, Qamili doli në pension, por veprimtarinë e tij shoqërore nuk e ndërpreu për asnjë çast. Kudo dhe kurdoherë gjendej në aktivitet me kontribute të rëndësishme, ku e veçanta e tij ishte aftësia dhe pjekuria për kapjen dhe zgjidhjen e problemeve në kohën e duhur në shërbim të komunitetit.

Por jeta e tij do të këputej në mes kur për të familja dhe shoqëria kishte shumë nevojë, sepse në 3 dhjetor të vitit 2003 u nda nga jeta për shkak të një aksidenti të rëndë automobilistik duke lënë në pikëllim të thellë familjen, vëllain, motrën si dhe bijtë dhe bijat e tij, iu nda miqëve, shokëve e dashamirësve të tij. Vlerat e këtij personazhi duhen parë me objektivitet, pasi ato vlejnë shumë si për të sotmen, ashtu edhe për të ardhmen e shoqërisë tonë.

Dhënia e një titulli nderi të lartë, si pikënisje do të ishte për Qamil Dervishin për të treguar jo vetëm dashuri e respekt për të, por dhe për vetë komunitetin e tij, që ai e dëshoi dhe e respekttoi aq shumë.

Renato Totraku

Mësuesi im Luan Dibra...

Unë nuk kam pas fatin të ulem në një sallë leksionesh gazetarie. Vonë, kur unë kisha mbaruar studimet e larta, u hap kursi i gazetarisë që do të bëhej ndër vite një shkollë ku do të dilnin gazetarë që do të jepnin zë të freskët organeve të shtypit të shkruar, atij radiofonik dhe televiziv.

Unë pata fatin që të kaloja një tjetër “shkollë gazetarie”, shkollën e penave të mëdha që në vitet pesëdhjetë-gjashtëdhjetë bënë emër, i dhanë shpirtin gazetarisë shqiptare, emra që sot përmenden duke luajtur prej vendit, duke u ngrit në këmbë e duke u dhënë respekt shpirtëror.


“Zëri i Rinisë” asokohe kishte faqeve të veta emra të tillë si Dhimitër Verli, Liri Lubonja, Zef Gurakuqi, Kliton Gjilani, Vath Kreshi, Agim Cerga, Loni Papa, Luan Dibra, Pirro Tase, e të tjerë që për mua do të ngelen mësuesit e vërtetë të cilët më dhanë “leksione” të gjalla të punës së gazetarit e redaktorit, më dhanë shpirtin e tyre, dashurinë e tyre. Jo vetëm mua por një brezi të tërë të rinjsh të asaj kohe që u ngjitën në pemën degëgjërë të shtypit për tu bërë shkrimtarë, poetë, publicistë me emër. “Faqja letrare” dhe “faqja shkencore” që alernoheshin asokohe herë njëra e herë tjetra të shtunave, ishin faqet më të lexuara jo vetëm nga rinia por edhe të rriturit e kohës.

Shkrimet e mia në vite në “Zërin e Rinisë”, shkrime që nisën në maj të vitit 1957, i mbloodha një ditë, i faqosa në një projekt libri më se dyqind faqe duke kujtuar me mall e dashuri mësuesit e mi.

Para dy vjetësh piva një kafe me Zef Gurakuqin, Zefin e gjatë të cilit asokohe unë i arrija deri pak sipër mesit. Kaluam më se një orë duke gjerbur bashkë me kafën kujtimet e asaj kohe. Ato ditë kishte ikur nga jeta Pirro Tase me të cilin rrjedha e kujtimeve ishte ngjitur deri në katin e pestë të shtëpisë time në Peshkopi kur erdhi bashkë me të shoqen e qeshur. Më pas udhëtoi në Lurë në kërkim të një emri për vajzën që priste të lindte, Luriana...

Nuk i harroja mësuesit e mi. Herë pas here kur nga Dibra e largët zbrisja në Tiranë, u ngjitesha shkallëve të “pallatit të rinisë”, (siç e quanin, sepse atje ishin strehuar gazetarë dhe punonjës të Komitetit Qendror të Rinisë) në rrugën “Myslim Shyri”, për të pirë një kafe e për të biseduar për punën në shtyp. Leksionet vazhdoja ti merrja me dëshirë...

Me Luan Dibrën kisha një



Luan Dibra

lidhje të veçantë. Jo se mbante mbiemrin Dibra dhe kishte mall e dashuri për vendlindjen e të parëve të tij nga kishte marrë përjetësisht mbiemrin, por se në penën e tij kishte jetë dhe shpirti i tij ishte fushë të madhe ku mbillej dhe korrej respekt e dashuri për njerëzit.

Luan Dibra ishte i gjithanshëm, një njeri me kulturë të gjerë, një gazetar i kompletuar në të gjitha drejtimet. Ai ishte gazetar, ishte skenarist, ishte një njeri i kërkuar në median e kohës.

Rruga e tij në publicistikë do të ngjitej nga “Zëri i Rinisë” në Kinostudion “Shqipëria e Re” si redaktor, skenarist dhe realizues filmash dokumentar me hapësirë e përmbajtje të thellë shoqërore e historike Luan Dibra ishte kryeredaktori i parë i revistës “Shkenca dhe jeta”, revistë që në sajë të horizontit të tij të gjithanshëm do të bëhej organi më e dashur për brezin e ri.

Luanin e mbaj mend (dhe do ta mbaj gjithnjë) të qeshur, një njeri në pension që shëtiste bulevardit “Myslim Shyri”, në shoqëri të bashkëshortes së tij. Kështu e kam takuar disa herë kur kaloja kësaj rruge këto vitet e fundit. Një herë më tha se kishte kaluar një infarkt. E kishte mposht dhe ishte mirë. Qeshte duke më përqaftuar.

Në jetë kam pas do kohë me vete aparat fotografik. Nuk e kam përdorë në takime me miqtë e mi të jetës. E ndjej këtë boshllëk. Mendoja se do të jetojmë përgjithmonë e një shkrepje fotografike më dukej sikur më ndante. Në negativët e mi fotografikë më mungon Luani...

Luan Dibra nuk jeton më. Disa ditë më parë në një gazetë interneti mësova se ai iku. Iku për të mbetur në shpirtin tim si një nga mësuesit e mi më të mirë të publicistikës. Iku përmes dhimbjes së familjes, të afërmeve, përmes dhimbjes time.

Luan Dibra iku në mes të janarit 2016 në një moshë 86 vjeç.

Iku me respektin e një nxënësi për mësuesin e tij...

Abdurrahim Ashiku
Janar 2016

Në kujtim të Luan Matit, dentistit të qeshur,
djalë Dibre në mërgim...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Sa herë kthehem nga vendlindja, nga trojet e mija që i qëndrojnë Brezhdanit si ballkon e ku kam dëshirë gjithnjë të fotografoj e të fotografohem, diçka marr. Radhën e fundit, nëntor 2015, mora me vete një shportë me ftonj.

Disa i preva me thikë dhe i ndava thela-thela me djalën dhe gruan larg vendlindjes. Disa ua mora lëkurën dhe zemrën dhe bëra një kavanoz me preve. Tulin e bëra reçel...

Tre kokrra, zverdhur në ngjyrë ari i kam vënë në një kanistër në një qosh të sallonit të ndenjjes për të mbledhë në trup dhe shpirt aromën e vendlindjes...

Vite më parë, kur po largohesha, shkula nga krahuri i djathtë i tunelit të pemëve dhe luleve aq të dashura të nënës sime, lule që kunata i ruante me kujdes, një rrënjë të madhe zambaku. Kishte shumë zambakë midis luleve të tunelit, shumë. E shkula me kujdes që me rrënjët të marrë edhe dheun, truallin që sa herë shkoj më vjen ta ha, ta fus në gjak e ta marr me vete. E mbështolla me një copë të lagur dhe e futa në çantë.

Në Athinë e vura në një vazo. U rrit, u degëzua, çeli lule. Kujdesesha për të si me një fëmijë. Ishte një aromë vendlindje në shtëpinë time në mërgimin e zi...

* * *

...Një zile telefoni...

E kapi Natasha që u gjend më pranë aparatit. Dikush në anën tjetër të telefonit diçka i përcolli, një si lloj brengje e lutjeje...

- Ishte Linda, më tha e ngrysur. E mban mend Luan Matin?

- Po i thashë, djalën e Kizes dhe Samiut, dentistin. Pse?

- Ka ndërruar jetë.

- Më vjen keq, i thashë.

- Ishte e motra, Linda, vazhdoi. Nesër varrosët në varrezat e Zografos. Mu lut që të thuash disa fjalë në varrim.

U ktheva në kujtimet e largëta të jetës sime, kohën kur punoja me babanë e tij, Samiun, ai në komitetin ekzekutiv e unë në lokalitetin e qendrës, muhabetin dhe respektin që përcillte ai njeri babaxhan me të gjithë, por veçanërisht me mua kur mernte e shikonte sa saktë dhe me përgjegjësi i kisha plotësuar dokumentet që lidheshin me punën dhe profesionin tim të agronomit të mesëm.

Luanin e mbaja mend më pak. Nuk kisha pirë ndonjëherë kafe me të. Me vëllezërit e tij, po. Nuk isha vizituar asnjëherë nga ai. Megjithatë bluza e bardhë, e qeshura në marrëdhëniet me njerëzit më erdhi menjëherë në kujtesë.

Mjeku dentist Pandeli Gole, një sarandjot mjeshtër në profesion, shokë kurs në specializim me stomatologun Zenel Zeneli, doktor i shkencave mjekësore, i cili ka afro njëzet vjet që kujdeset për gojën time, një ditë më pyeti në se njihesha me Luan Matin. I thashë se po dhe radhita miqësinë me të atin dhe vëllezërit. Më tha se punon dentist në një lagje në periferi të Athinës. Më foli me respekt për të, më dha edhe numrin e telefonit...

E mora në telefon. Biseduam gjatë. E lamë të takohemi për të gjerbur së bashku kafën e mërgimtarit e për të udhëtuar në vendlindje mes njerëzve.

Nuk qe e thënë. Ai në punë si dentist e unë në punë si kopshtar nuk e gjetëm kohën të takoheshim.

Një zambak Dibre në Athinë



Natasha që mbante vazhdimisht lidhje me Lindën, të motrën, një ditë më tha se Luani ishte sëmurë. Një lloj kanceri që lidhej me gjëndrat e pështymës e kishte mbërthyer në shtrat.

Kërkova adresën dhe e lamë që një ditë të shkojmë ta shohim. Nuk ishte e mundur. Luanin e kishte vënë poshtë jo vetëm sëmundja por edhe humbja e punës. Nuk punonte dhe kur në mërgim nuk punon jeta bëhet e vështirë, për vete dhe për fëmijët. Punonte vetëm e shoqja. I shërbente një grekeje plakë njëzet e katër orë pa ndërprerje. Grekja i lëshoi një dhomë Luanit. E sëmurë nga zemra Ajo do të kujdesej për Luanin si për djalën e saj.

E pashë greken në ceremoninë kishtarë të varrimit, e pashë edhe tek ecte e mbajtur mbi shkop drejt varrezave. I dhashë dorën dhe e përgëzoja kur pimë kafën e lamtumirës.

Për ta takuar së gjalli Luanin nuk mundëm. Nuk deshëm të shqetësonim plakën greke me zemër hambar siç thuhet për njerëz si ajo në vendlindjen time.

...U ula në kompjuter dhe diçka shkrova, diku tek një faqe, një lloj të shkruari midis nekrologjisë dhe meditim.

I dashur Luan !

Po i drejtohem shpirtit tënd, shpirt i cili



edhe na dëgjon, edhe na shikon, edhe na buzëqesh, edhe na përkëdhel me ato duart e tua të buta.

Jemi këtu një grup i vogël dibranësh, është shoqja juaj e jetës, vëllezër, motra, nipër mbesa, njerëz që të deshën dhe të duan. Janë miq grekë me të cilët na lidhi jeta në emigracion, që të deshën aq sa të duam ne.

Janë edhe ata që fizikisht nuk janë këtu, janë larg; në Tiranë, në Dibër, në vise të tjera shqiptare, në emigracionin e zi. Janë me shpirt e me zemër. Loti i tyre, atje ku bije, çan gurin e djeg drurin, është më i fortë, më i nxehtë se loti jonë. Është loti i njerëzve të pa ngushëllueshëm.

I dashur Luan !

Ikja jote po na dhemb shumë. Është një ikje shumë e parakohshme, një ikje në pjekurinë tuaj njerëzore, një ikje në pjekurinë më të lartë profesionale. Dibra do ta mbajë mend kurdoherë humanizmin tuaj të madh, fjalën tuaj të mirë, profesionalizmin tuaj të lartë. Ti ishe njëri ndër mjekët stomatologë më të mirë në Dibër, një njeri prej të cilit mësonin jo vetëm kolegët e rinj por edhe ata me shumë vite pune.

Ti do të na mungosh, i dashur Luan, do të na mungosh të gjithëve por në veçanti do tu mungosh njerëzve që të qëndruan pranë në momentet e fundit të jetë, gruas tuaj

I dashur Luan!

Para dy vjetësh, kur isha në Dibër, nga kopshti i prindërve të mi në Brezhdan, shkula dhe mora me vete disa rrënjë zambaku mbështjellë me pak tokë Dibre. Një rrënjë nga ky zambak e shkula mbrëmë dhe në shenjë nderimi e respekti për ty dhe familjen tuaj, në shenjë respekti për të gjithë njerëzit që kanë ardhë sot për të të përcjellë në banesën e fundit, shqiptarë e grekë, ta mbjell mbi dheun e varrit tënd.

të dashur, djalit dhe vajzës, motrës tënde Lindës, të gjithë njerëzve të gjakut tënd të gjerë, gjak me shumë vëllezër e motra, me shumë nipër e mbesa, gjakut që rrodhi nga damarët e SAMIUT dhe KIZES që i nderonte dhe respektonte e tërë Dibra.

I dashur Luan!

Para dy vjetësh, kur isha në Dibër, nga kopshti i prindërve të mi në Brezhdan, shkula dhe mora me vete disa rrënjë zambaku mbështjellë me pak tokë Dibre. Një rrënjë nga ky zambak e shkula mbrëmë dhe në shenjë nderimi e respekti për ty dhe familjen tuaj, në shenjë respekti për të gjithë njerëzit që kanë ardhë sot për të të përcjellë në banesën e fundit, shqiptarë e grekë, ta mbjell mbi dheun e varrit tënd. Jam i sigurt se kështu dheu i vendit fqinj që hodhëm mbi arkivolin tënd do të bëhet më i lehtë dhe shpirti do të prehet në qetësi.

Lamtumirë i dashur Luan !

Lamtumirë lofka e zemrës !

Athinë, varrezat e Zografos, 3 korrik 2004

* * *

Më ka ndodhur edhe herë të tjera të flas në lamtumira njerëzore. Më ka ndodhë të më mblidhet një komb në fyt e të mos mundem ta nxjerr fjalën të plotë, por ta murmuris. Më ka ndodhë që lotët të derdhen nga liqeni njerëzor thellë syve. Si atë ditë në varrezat e Zografos në Athinë, jo, nuk më ka ndodhë kurrë. Zëri mu mor e lotët e lagën letrën që mbaja në dorë, lagën truallin e varrezave ku qëndroja. Ishte një lot larg vendlindjes, lot malli, lot që të djeg në shpirt.

Nxora nga çanta zambakun. Preka rrënjët dhe dheun e vendlindjes sime, përkëdhela dhe i ngrita lart gjethet e gjelbërta. Thirra vajzën e Luanit, lotët e së cilës kishin mbledhë rrëketë mbi mjekër e ridhnin krrua.

U afrua duke belbëzuar “Ç’njeri je ti që the aq fjalë të bukura për babin tim?”

I kryqëzuam duart mbi dheun e freskët që kishte marrë formë piramideje. Hapëm një gropë dhe vendosëm me kujdes rrënjët e zambakut. I mbuluam...

Dikush na zgjati një shishe me ujë. Vajza e mori dhe e hodhi në rrënjë me kujdesin e njeriut që pret diçka të ndodhë. Uji u tret thellë dheut të freskët...

Atë ditë në varrim mungonte djali. Pa dokumente, një fshesë greke e kishte larguar si të padëshiruar...

Shkrepa disa herë aparatit fotografik. Nga filmi fiksova dhe kam në album një fotografi e në negativ shumë.

Nuk po e përcjell, po e mbaj për vete si kujtim të një dhimbjeje nga dhimbjet e mija të kurbetit.

I kërkova Lindës një fotografi të Luanit në jetë. I kërkova edhe letrën me lotët e derdhur atë ditë në varrezat e Zografos të Athinës. Mbi të nuk ishin vetëm shenjat e lotëve të mi. Ishin edhe të Lindës, edhe të... E skanova dhe e futa në kujtesën elektronike të kompjuterit...

Edhe letrën, edhe fotografinë, bashkë me dhimbjen për një njeri që u tret larg vendlindjes, po i përcjell.

Po i përcjell për të çliruar e qetësuar veten. Gjatë, shumë gjatë e kam mbajtur amanetin...

Po i përcjell për tua kujtuar të gjithë atyre që e njohën dhe e deshën...

Athinë, 16 janar 2016

Letër për lexuesit!

Një pajtim vjetor, si deri më tani kushton 600 lekë. Nëse paguani 1000 lekë, ju mund të merrni kopjen fizike dhe atë elektronike në email.

I nderuar lexues,

Duke Ju uruar një Vit të Mbarë, do të donim t'Ju prezantonim me gazetën "Rruga e Arbërit".

Ju mund të keni pasur rast të takoheni me gazetën edhe herë të tjera më parë. Ne shpresojmë që ajo të jetë e pëlqyeshme për ju!

Gazeta "Rruga e Arbërit" këtë vit mbush dhjetë vjet nga dalja e numrit të saj të parë, dhe çdo muaj përcjell informacione, komente, opinione, reportazhe, recensa dhe rubrika të tjera për artin, kulturën, historinë etj.

Gazeta është një botim i pavarur dhe këtë e ka dëshmuar gjatë këtyre dhjetë viteve me integritet dhe profesionalizëm.

Siç ju mund ta dini, gazeta të vetmet burime financiare ka pajtuesit e rregullt të saj dhe botuesit e gazetës, të cilët mbulojnë shpenzimet mujore. Për vazhdimësinë e botimit të saj, me të njëjtin përkushtim, paanshmëri e profesionalizëm, në Ju ftojmë të pajtoheni, duke e vlerësuar këtë si një kontribut Tuajin të rëndësishëm.

Do ta vlerësonim ndihmën tuaj nëse ndikoni edhe te miqtë, kolegët apo të afërmit, në mënyrë që edhe ata të vepronin njësoj si Ju.

Gazetën në jua sjellim pranë shtëpisë suaj kudo në Tiranë dhe Peshkopi.

Me këtë rast, dëshirojmë t'ju theksojmë se jemi gjithmonë të hapur për sugjerimet tuaja, jo vetëm në trajtimin e tematikave që ne shkruajmë, por edhe për të shkruar mbi veprimtari, individë apo organizata që veprojnë, kontribuojnë apo kanë lidhje me qarkun e Dibrës.

Gjithashtu, gazeta ofron faqet e saj për njoftime apo reklama të ndryshme. Pajtuesve në gazetë ju jepet mundësia të bëjnë njoftime falas gjatë vitit. Ne ofrojmë zbritje të konsiderueshme për ata që bëjnë reklama apo njoftime me



Bëj pajtimin tënd ose dhuro për gazetë me



përmes emailit

<rrugaearbërit@gmail.com>

Një kontribut vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë. **REKLAMA E PARË ËSHTË FALAS!**



Merr versionin PDF ose kopjen print duke kontribuar vetëm me 50 lekë/muaj

Gazetën Rruga e Arbërit mund ta gjeni edhe në internet në adresën www.rrugaearbërit.com, tashmë me disajn të ri. Faqja në web është kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit" dhe lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër nga z. Agim Deva.

Kërkohen korrespondentë/menaxherë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Gazeta "Rruga e Arbërit" kërkon korrespondentë dhe menaxherë zyrtarë për PESHKOPINË dhe DIBRËN E MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të shkruajnë email në adresën <rrugaearbërit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Redaksia

qëllime promovimi.

Një pajtim vjetor, si deri më tani kushton 600 lekë. Nëse paguani 1000 lekë, ju mund të merrni kopjen fizike dhe atë elektronike në email. Ju lutem, mos paguani nëse nuk pajiseni me një faturë.

Për më shumë informacion,

ju lutem mos hezitoni të na shkruani në email <rrugaearbërit@gmail.com> ose të na telefononi në numrin 068 65 08 441.

Për pajtime telefononi ose shkruani mesazh në WhatsApp dhe Viber në numrin: 068 46 63 270.

**600 lekë
në vit**